



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 328 Akti**

**Nr. 303 Vendimi**  
**Tiranë, më 5.10.2020**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Roland Ilia</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Etleda Çiftja</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier, në datat 1.10.2020 dhe 5.10.2020, në Pallatin e Koncerteve, kati i dytë, salla 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Silvana Pani**, me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Përmet.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin Silvana Pani, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Silvana Pani, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Përmet, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Znj. Silvana Pani, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 12.11.2019, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Roland Ilia dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, (në vijim KLD), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.
4. Me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 6.3.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot, datë 13.11.2019, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, (në vijim ILDKPKI) ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani.
5. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, DSIK-ja ka vënë në dispozicion raportin mbi kontrollin e figures për subjektin e rivlerësimi, znj. Silvana Pani, nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. \*\*\* , datë 16.1.2020, të KDZH-së.
6. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2018, Prokuroria e Përgjithshme ka vënë në dispozicion raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani.
7. Me vendimin nr. 1, datë 20.11.2019, trupi gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Silvana Pani, duke u bazuar në të tri kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin Roland Ilia. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
8. Në datën 6.12.2019, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije dhe e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti nuk u shpreh mbi gjendje konflikti interesi me ndonjë prej anëtarëve të trupit gjykues.
9. Me vendimin nr. 2, datë 4.9.2020, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Silvana Pani, dhe vendimarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit, të bazohet në të tri kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollit të figurës; dhe vlerësimin profesional, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

**10.** Në datën 8.9.2020 përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 21.9.2020; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

**11.** Në datën 9.9.2020 përmes postës elektronike, subjekti konfirmoi marrjen e njoftimit mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe kërkoi zgjatje të afatit të paraqitjes së prapësimeve, kryesisht për paraqitjen në formën e kërkuar nga ligji të dokumentacionit nga SHBA dhe përgatitjes së një analize të hollësishme financiare, si dhe dokumenteve të tjera shkresore.

**12.** Në datën 10.9.2020, Komisioni njoftoi subjektin, përmes postës elektronike, për shtyrjen e afatit të paraqitjes së parashtrimeve në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ, deri në datën 29.9.2020.

**13.** Në datën 29.9.2020, subjekti rivlerësimit, me anë të postës elektronike, dërgoi shpjegimet dhe provat e saj në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, po në këtë datë, Komisioni njoftoi subjektin me anë të postës elektronike mbi zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 1.10.2020, ora 10:00.

## **II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI**

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

#### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

Subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi 1974 dhe ka dorëzuar deklaratat e interesave private, ndër vite (në vijim DPV), për periudhën 2003 - 2016. Në datën 27.1.2017, subjekti ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ILDKPKI-ja ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, sipas neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016 dhe me aktin nr. \*\*\* prot., datë 6.3.2018, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *ka mosdeklarime ndër vite të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

#### **A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjekteve të rivlerësimit, referuar vendimit Nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizoi një proces të mirëfilltë kontrolli dhe

rivlerësimi të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit, znj. Silvana Pani, i cili nuk është bazuar dhe as është detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja.

Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka hetuar të gjitha faktet dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, duke kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit Silvana Pani dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaratimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të rreme; si dhe, (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklaratimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Hetimi administrativ sipas neneve 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84 /2016, është kryer në lidhje me:

**Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, si vijojnë:**

1. Apartament me sipërfaqe ndërtimi 74.7 m<sup>2</sup>, sipërfaqe trualli në bashkëpronësi 17.2 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e përbashkët ndërtimi 7.86 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ballkoni 14.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, Përmet, e regjistruar në hipotekë me. \*\*\*, datë 23.1.2016. Vlera: 27.000 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit. Pjesa takuese nuk është deklaruar.

Në lidhje me këtë pasuri ILDKPKI-ja ka konstatuar: (1) mosdeklarim në DPV-në e vitit 2011 të apartamentit të banimit me sip 74.7 m<sup>2</sup> të ndodhur në Përmet, në vlerën 27 000 euro, likuidimin e pagesave në shumën 19.500 euro+500.000 lekë (sipas kontratës së shitjes datë 31.12.2015), burimin e krijimit dhe detyrimin financiar të mbetur shoqërisë së ndërtimit; (2) mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për shlyerjen e pagesave të apartamentit në vitin 2011 në shumën 19.500 euro+500.000 lekë; (3) deklarim i pasaktë në DPV-në e vitit 2015, i shlyerjes së apartamentit në shumën 15.500 euro, pasi sipas kontratës së shitjes datë 31.12.2015, në këtë periudhë subjekti ka likuiduar 2.300 euro + 68.000 lekë; (4) është i paqartë deklarimi në DPV-në e vitit 2016 dhe transferimi në “Raiffeisen Bank” i shumës 1.600.000 lekë, me përshkrimin detyrim i debitorit A. P. për apartamentin e ndërtuar nga shoqëria “V.” sh.p.k., pasi apartamenti, sipas kontratës së shitjes, datë 31.12.2015, rezulton i likuiduar deri në vitin 2015.

## Hetimi i kryer nga Komisioni dhe rivlerësimi i pasurisë

Për statusin aktual të kësaj pasurie: ASHK-ja Gjirokastër<sup>1</sup> informoi se znj. Silvana P. Pani (S.) ka në bashkëpronësi me bashkëshortin apartament me sip. 74.70 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, Përmet; OSHEE-ja<sup>2</sup> konfirmoi në emër të bashkëshortit të subjektit z. A. P., kontratën e furnizimit me Nr. \*\*\* në instancën Gjirokastër, për të cilën ka informacion mbi pagesat që prej gushtit të vitit 2013<sup>3</sup>.

**1.1** Në lidhje me origjinën dhe procedurat ligjore të fitimit të pronësisë, nuk u konstatuan problematika, pasi nga aktet<sup>4</sup> në dosje, rezultoi se:

- Me kontratë porosie të datës 7.4.2011, porositësi A. P. ka porositur nga sipërmarrësi shoqëria “V.” sh.p.k., pasurinë apartament 2+1, kati i 3-të, me sip. 76 m<sup>2</sup> dhe ambiente të përbashkëta 8.17 m<sup>2</sup>, në çmimin 30.000 euro.
- Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore datë 3.8.2015 të ZVRPP-së Përmet, pasuria nr. \*\*\*, me sip. 74.7 m<sup>2</sup>, ishte e regjistruar në emër të shoqërisë “V.” sh.p.k.
- Me kontratë shitblerje nr. 2731/1012/1, datë 31.12.2015, shtetasit A. P. dhe Silvana Pani kanë blerë pasurinë me nr. 9/145+1-6 nga shoqëria “V.” sh.p.k., me ortake të vetme dhe përfaqësuese ligjore, znj. E. A. M., në çmimin prej 27.000 euro.
- DPPPP-ja<sup>5</sup> ka informuar mbi raportime nga noteri për transaksion në shumën 27.000 euro për shitjen e pasurisë nr. 9/145+1-6, te shtetasit Silvana e A. P.
- Sipas vërtetimit, datë 18.1.2016, të ZVRPP-së Përmet, pasuria nr. \*\*\*, me sip. 74.7 m<sup>2</sup>, dhe sipërfaqe ballkoni 14.8 m<sup>2</sup>, rezulton e regjistruar në emër të shtetasve A. P. dhe Silvana Pani.

**1.2** Në lidhje me trajtimin e mundshëm preferencial për shkak të ushtrimit të funksionit, nuk rezultuan të dhëna pasi:

- Subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, në cilësinë e prokurores nuk rezultoi të këtë trajtuar çështje ku palë pjesëmarrëse në proces të kenë qenë shtetasja E. M. apo shoqëria “V.” sh.p.k.<sup>6</sup>.
- Referuar udhëzimit nr. 4, datë 30.9.2015 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja, për vitin 2015”, çmimi në tregun e lirë në Përmet, ka qënë 36.867 lekë/m<sup>2</sup>. Sipas këtij çmimi, apartamenti do të kushtonte 89.50 m<sup>2</sup> (sipërfaqe e brendshme 74.7 m<sup>2</sup>, dhe sipërfaqe ballkoni 14.8 m<sup>2</sup>) x 36 867 lekë = 3.299.597 lekë, ndërkohë që ka kushtuar 27.000 euro ose 3.716.550 lekë, pra, në vlerën 416.953 lekë më shumë.

**1.3** Në lidhje me mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes, u konstatua se:

**1.3.1** Kontrata e porosisë e lidhur në datën 7.4.2011, parashikon se porositësi merr përsipër ndërtimin e apartamentit me sip. 76 m<sup>2</sup> dhe ambiente të përbashkëta 8.17 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 30.000 euro, i cili do të likuidohej me tri këste: (i) kësti i parë 10.000 euro me lidhjen e kontratës; (ii) kësti i dytë 5.000 euro brenda datës 30.5.2011; (iii) kësti i tretë 10.000 euro

<sup>1</sup>Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15. 1.2020, nga ASHK-ja Përmet, në dosjen e Komisionit.

<sup>2</sup>Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.1.2020, nga OSHEE-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>3</sup> Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2020, nga FSHU-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>4</sup>Shihni aktet në Aneksin 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentet e dërguara nga noteri M. L. në dosjen e Komisionit.

<sup>5</sup>Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2019, nga DPPPP-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>6</sup> Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, dhe shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., M/P, datë 4.5.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, në dosjen e Komisionit.

brenda datës 30.12.2011; (iv) diferenca (5.000 euro) do të paguhet nëpërmjet rakordimit midis palëve me dorëzimin e dokumentacionit të pronësisë.

**1.3.2** Kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 31.12.2015, parashikon se çmimi i shitjes së pasurisë është 27.000 euro dhe pagesat janë kryer nga pala blerëse, bashkëshorti subjektit të rivleresimit, në “Raiffeisen Bank” dega Përmet në dhjetë këste të paguara si vijon: (1) në datën 19.4.2011 është paguar shuma 10.000 euro; (2) në datën 2.5.2011 është paguar shuma 5.000 euro; (3) në datën 20.6.2011 është paguar shuma 200.000 lekë; (4) në datën 26.7.2011 është paguar shuma 300.000 lekë; (5) në datën 1.9.2011, nr. veprimi \*\*\*, është paguar shuma prej 2.000 euro; (6) në datën 3.11.2011, nr. veprimi \*\*\* është paguar shuma tjetër prej 1.000 euro; (7) në datën 30.12.2011, nr. veprimi \*\*\*, në llogari të palës shitëse \*\*\*, shuma prej 1.500 euro; (8) në datën 17.12.2012, nr. veprimi \*\*\* është paguar shuma prej 150.000 lekësh; (9) në datën 29.12.2015 me nr. veprimi \*\*\* është paguar shuma prej 2.300 euro; dhe (10) në datën 29.12.2015, me nr. veprimi \*\*\* është paguar shuma prej 68.000 lekësh.

Me kërkesë të Komisionit, shoqëria “V.” sh.p.k., konfirmoi të gjitha këto pagesa të kryera në rrugë bankare, vërtetuar me dokumente shkresorë që provojnë transfertat bankare dhe statement bankar<sup>7</sup>. Shuma e paguar si çmim për blerjen e pasurisë është në total 27.000 euro ose 3.731.445 lekë, nga e cila, në vitin 2011, janë likuiduar 19.500 euro dhe 500.000 lekë; në vitin 2012, janë likuiduar 150.000 lekë dhe në vitin 2015, janë likuiduar 2.300 euro dhe 68.000 lekë.

Nga krahasimi i dy kontratave të sipërpërmedura, vërehet se : (1) ka mospërputhje në çmimin e shitjes, pasi në kontratën e porosisë çmimi i parashikuar është 30.000 euro, ndërsa në kontratën e shitjes çmimi është përcaktuar 27.000 euro; si dhe (2) ka mospërputhje të pagesave të kësteve sipas kontratës së shitjes me parashikimin në kontratën e porosisë.

**1.4** Nga verifikimi DPV-ve dhe krahasimi i tyre me aktet shkresore të administruara, si më sipër, u konstatua se:

**1.4.1** Në DPV-në e vitit 2011 nuk është deklaruar porositja e apartamentit të banimit dhe pagesat e kryera për shlyerjen e shumave 19.500 euro + 500.000 lekë, sipas parashikimit të kontratës së shitjes, burimi i tyre, si dhe detyrimi financiar ndaj shoqërisë “V.” sh.p.k., sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

**1.4.2** Në DPV-në e vitit 2012 është deklaruar: *“Pagim kësti për blerje apartamenti 2+1 në Përmet me sip 98 m<sup>2</sup>, në shumën 10.000 euro dhe 200.000 lekë”*, pa u deklaruar burimi dhe as detyrim financiar ndaj shoqërisë “V.” sh.p.k., sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar. Ka mospërputhje me kontratën e shitjes, sipas të cilës gjatë vitit 2012 është likuiduar shuma prej 150.000 lekësh.

**1.4.3** Në DPV-në e vitit 2014 nuk është deklaruar pagim këstesh, fakt që përputhet me kontratën e shitjes, si dhe nuk është deklaruar detyrim financiar ndaj shoqërisë “V.” sh.p.k., sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

**1.4.4** Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka kryer këto deklarime:

---

<sup>7</sup> Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2020, nga shoqëria “V.” sh.p.k. në dosjen e Komisionit.

a) *Apartament me sipërfaqe ndërtimi 74.7 m<sup>2</sup>, Përmet. Shlyer detyrimi në shumën 15.500 euro. Vlera (totale): 27.000 euro.* Ky deklarin vijon në kundërshtim me kontratën e shitjes sipas të cilës, e gjithë shuma e çmimit të shitjes është paguar brenda vitit 2015. Pasi u pyet subjekti, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 nuk ka dhënë sqarime mbi këtë mospërputhje, por ka deklaruar se: *“Çmimi sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, është 3.731.445 lekë ose 27.000 euro, nga të cilat 15.500 euro deri në vitin 2015 dhe 11.500 euro (11.500×139.13=1.600.000 lekë) në vitin 2016”* (deklaruar për këtë vit si në pikën më poshtë). Ndërsa pranon se deri në vitin 2015, ishte paguar vetëm shuma prej 15.500 euro, subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në për vitin 2015 ndonjë detyrim të pashlyer ndaj shoqërisë ndërtimore. Në këtë mënyrë, znj. Silvana Pani, edhe gjatë procesit të rivlerësimit, ka kryer deklarime që vijnë në kundërshtim me parashikimin e likuidimit të çmimit në kontratën e shitjes, sipas së cilës i gjithë çmimi është likuiduar brenda vitit 2015.

b) *“Pakësime nga depozita në ‘Raiffesen Bank’ të cilat janë shpenzuar për blerje orendish për apartamentin e lartpërmendur dhe pagimi i një kësti të apartamentit, në vlerën 1.269.662 lekë”.* Pasi u pyet nga Komisioni se çfarë përfaqësonte kjo shumë, subjekti, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se: *“... shuma prej 1.269.662 lekësh e deklaruar në DPV-në për vitin 2015 përbëhet nga 900.000 lekë për blerje orendish dhe pajisje për shtëpinë: 350.000 lekë (dy dhoma gjumi, një bufë dhe një minibar) 150.000 (një frigorifer, furrë + pjanurë, aspirator dhe lavastovile) 350.000 (salloni me tavolinën e ngrenies së bashku me karriget), 50.000 (ndriçimi i sallonit), si dhe 302.662 lekë (2.300 euro×131.592 lekë) dhe 67.000 lekë janë këste pagese për firmën ndërtuese. Siç duket, shpenzimet e deklaruara në këtë DPV për mobilimin janë në shumën 900.000 lekë, ndërsa në pyetësorin standard shpenzime mobilimi janë deklaruar në shumën 1.200.000 lekë (850.000 lekë mobilim + 350.000 për kondicionimin e ambienteve). Në analizën financiare shuma e shpenzuar për mobilim është llogaritur në vlerën prej 1.250.000 lekësh.*

c) *“Pagesë kësti e apartamentit të lartpërmendur nga depozita e deklaruesit në ‘Raiffeisen Bank’ në vlerat 2.300 euro dhe 67.000 lekë”.* Ndërkohë që, sipas kontratës së shitjes, në vitin 2015 është likuiduar shuma 2.300 euro + 68.000 lekë. Deklarimi i subjektit përputhet me kontratën e shitjes, me përjashtim të një vlere prej 10.000 lekësh.

**1.4.5** Në DPV-në për vitin 2016, subjekti ka deklaruar: *“Pakësim i depozitës në ‘Raiffeisen Bank’ për shlyerje të detyrimeve të parapaguara nga firma ndërtuese e apartamentit të banimit në bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortit të subjektit, në shumën 1.600.000 lekë”.* Kjo pagesë është vërtetuar të jetë kryer nëpërmjet “Raiffeisen Bank”, nga ku rezulton se në datën 12.2.2016, nga llogaria e subjektit është derdhur shuma prej 1.600.000 lekësh në favor të shoqërisë “V.” sh.p.k., me përshkrimin: *“Silvana Pani, detyrim i debitorit A. P. për apartamentin e ndërtuar”.*

Duke qenë se sipas kontratës së shitjes së datës 31.12.2015, çmimi prej 27.000 euro ishte likuiduar tërësisht brenda vitit 2015, vërtetuar edhe me dokumente shkresore bankare, Komisioni ka kryer disa veprime hetimore me qëllim qartësimin e shkakut dhe qëllimin e pagesës prej 1.600.000 lekësh në vitin 2016 dhe konkretisht:

a) Subjektit të rivlerësimit iu kërkuan sqarime mbi transferimin e shumës 1.600.000 lekë në favor të shoqërisë “V.” sh.p.k., në vitin 2016, dhe se çfarë përfaqëson kjo shumë në kushtet

kur çmimi i shitjes ishte likuiduar tërësisht, sipas kontratës së shitjes së datës 31.12.2015. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, znj. Silvana Pani, deklaroi se : ... *shuma prej 1.600.000 lekësh përbën diferencën midis 27.000 euro dhe 15.500 euro, pasi nga çmimi i shitjes prej 3.731.445 lekë ose 27.000 euro, vetëm 15.500 euro janë paguar deri në vitin 2015, ndërsa pjesa prej 11.500 euro (11.500 × 139.130 = 1.600.000 lekë) është paguar në vitin 2016.* Në vijim, subjekti ka deklaruar: ... *sqaroj se shuma e mësipërme është derdhur në llogari të firmës ndërtuese, pasi është kredituar prej saj, në disa këste para vitit 2015, për efekt të dorëzimit të situacioneve të punimeve të ndërtimit në organin tatimor....*, por pa e vërtetuar këtë pretendim me ndonjë dokument shkresor.

Veç sa më sipër, në përgjigje subjekti ka deklaruar: ...*kontrata e shitjes është bërë më 31.12.2015 me insistim të firmës ndërtuese dhe shitëse, pasi në janar të vitit 2016 tatimi mbi fitimin për biznesin e madh kalonte nga 10 % në 15 % të fitimit dhe ishte në favor të firmës...* pretendim që nuk qëndron, pasi referuar legjislacionit tatimor, konkretisht udhëzimit nr. 31, datë 29.12.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi me botimin e tij në fletoren zyrtare, po në vitin 2014, rezulton se tatimi për fitimin është rritur nga 10 % në 15 % që në vitin 2014, dhe ka qenë në fuqi edhe në vitin 2015 e më tej.

**b)** Shoqërisë “V.” sh.p.k., i është kërkuar të japë informacion në lidhje me faktin se çfarë përfaqëson shuma e paguar nga subjekti në vlerën 1.600.000 lekë në vitin 2016 dhe kjo shoqëri ka informuar<sup>8</sup> se nëpërmjet kësaj shume, z. A. P. ka shlyer detyrimin debitor ndaj shoqërisë “V.” sh.p.k., që rrjedh nga marrëveshja e datës 1.05.2011, të cilën e ka vënë në dispozicion bashkëngjitur. Nga verifikimi aktmarrëveshjes së lidhur me akt të thjeshtë midis palëve, shoqëria “V.” sh.p.k., merr përsipër kreditimin e 40 % të vlerës së kontratës së sipërmarjes, datë 7.4.2011, dhe me përfundimin e regjistrimit të pronës në favor të porositesit, ky i fundit është i detyruar të shlyejë plotësisht kreditimin e bërë nga shoqëria. Bashkëngjitur aktmarrëveshjes, janë vënë në dispozicion katër mandatpagesa të shoqërisë “V.” sh.p.k., sipas të cilave : (1) në datën 2.5.2011, shoqëria i ka kaluar në *cash* z. A. P. shumën 5.000 euro, shumë të cilën, po në këtë datë, z. A. P., ia kishte kaluar në rrugë bankare shoqërisë nëpërmjet “Raiffeisen Bank”; (2) në datën 26.7.2011, shoqëria i ka kaluar z. A. P. në *cash*, shumën prej 300.000 lekësh, shumë të cilën, po në këtë datë, z. A. P., ia kishte kaluar në rrugë bankare shoqërisë nëpërmjet “Tirana Bank”; (3) në datën 1.9.2011, shoqëria i ka kaluar z. A. P., shumën prej 2.000 euro, shumë të cilën po në këtë datë, z. A. P., ia kishte kaluar në rrugë bankare shoqërisë nëpërmjet “Raiffeisen Bank”; (4) në datën 30.12.2011, shoqëria i ka kaluar z. A. P., shumën prej 1.500 euro, shumë të cilën po në këtë datë, z. A. P., ia kishte kaluar në rrugë bankare shoqërisë nëpërmjet “Raiffeisen Bank”; (5) veç sa më sipër, shoqëria ka deklaruar kalimin në favor të z. A. P. edhe të një shume prej 1.000 euro, në datën 3.11.2011, për të cilën nuk është vënë në dispozicion mandatpagesë, shumë të cilën, po në këtë datë, z. A. P., ia kishte kaluar në rrugë bankare shoqërisë nëpërmjet “Raiffeisen Bank”.

Siç vërehet, mandatpagesat e vëna në dispozicion nga shoqëria “V.” sh.p.k., kanë përcaktimin kreditim për z. A. P. n, por pa përshkruar shkakun e këtyre kreditimeve. Nga ana tjetër, dorëzimi i situacioneve të shoqërisë në organet tatimore, pasi bashkëshorti A. P. kishte kryer

<sup>8</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., e arkivuar pranë Komisionit në datën 17.8.2020, nr. \*\*\* prot., në dosjen e Komisionit.



pagesat në rrugë bankare në llogari të shoqërisë ndërtimore (sipas deklarimit të subjektit), në të njëjtën ditë me lëshimin e këtyre mandateve për kthim lekesh *cash* të zoti A. P., vë në dyshim jo vetëm legjitimitetin por dhe vërtetësinë e mandatpagesave, sidomos në kushtet kur subjekti nuk ka kryer asnjë deklaram në lidhje me shumat e kthyera prej shoqërisë në vitin 2011.

Në total shuma e kthyer z. A. P. në vitin 2011, sipas marrëveshjes së datës 5.1.2011, është në vlerën 1.613.850 lekë, shumë e cila supozohet të jetë paguar nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2016 si detyrim debitor. Sipas subjektit, pikerisht për shkak të kthimit të kësaj vlere në favor të zotit P. në vitin 2011, kjo shumë nuk është deklaruar si e paguar në DPV-në për vitin 2011. Por nga ana tjetër, në këtë deklaratë subjekti nuk ka deklaruar gjendjen e likuiditetit as në *cash* e as në banke në shumën prej 1.613.850 lekësh të pretenduara të kthyera nga shoqëria "V." sh.p.k., në mënyrën e sipërpërmendur.

Ndërkohë, nga verifikimi i veprimeve bankare, vërehet se përveç shumave të sipërpërmendura të paguara në llogari të shoqërisë "V." sh.p.k. e të kthyera sërish prej saj të zoti Pani në vitin 2011, në llogari të shoqërisë "V." sh.p.k. kanë kaluar edhe shumat prej 10.000 euro dhe 200.000 lekë, përkatësisht në datat 19.4.2011 dhe 20.6.2011. Këto shuma dhe burimi i tyre nuk janë deklaruar gjithashtu nga subjekti në DPV-në për vitin 2011 si pagesa të çmimit të blerjes së pasurisë, sipas detyrimeve ligjore.

c) I është kërkuar informacion noterit M. L. pranë të cilit janë kryer veprimet e tjetërsimit të pasurisë në favor të bashkëshorteve A. dhe Silvana Pani për veprime të kryera prej tyre në zyrën e tij të noterisë, i cili nëpërmjet rrugës elektronike<sup>9</sup>, ka vënë në dispozicion aktet, si vijojnë: (1) kontratë porosie, datë 7.4.2011, në të cilën midis të tjerash parashikohet se kësti i fundit prej 5.000 euro do të paguhet nëpërmjet rakordimit midis palëve me dorëzimin e dokumentacionit të pronësisë. Ky fakt bie në kundërshtim me marrëveshjen e datës 1.5.2011, sipas të cilës shuma e paguar pas regjistrimit të pasurisë, do të ishte 40 % e vlerës së kontratës së datës 7.4.2011 (ose 12.000 euro); (2) kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 31.12.2015, dhe dokumentet bashkëngjitur, në të cilën nuk rezulton të jetë përmendur aktmarrëveshja e datës 1.5.2011, si dhe asnjë fakt në lidhje me veprime e kryera prej palëve në përmbushje të kësaj porosie. Përkundrazi, kontrata konfirmon likuidimin e çmimit të shitjes në shumën prej 27.000 euro tërësisht brenda vitit 2015, vërtetuar me dokumente bankare, pa parashikuar asnjë detyrim të z. A. P. ndaj shoqërisë ndërtuese në cilësinë e palës shitëse.

### **1.5 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë dhe analizën financiare**

Në përfundim të hetimit administrativ, për sa i takon analizës financiare për të verifikuar të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë, bazuar në të gjitha provat dhe rrethanat arsyetuar më sipër, si dhe në referencë të faktit që në deklaramet ndër vite, por edhe ato gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka krijuar një situatë kaotike lidhur me mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes së pasurisë, duke vështirësuar identifikimin e situatës faktike, Komisioni iu referua pagesave të kryera sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 31.12.2015, likuiduar totalisht brenda vitit 2015 në rrugë bankare përgjatë viteve 2011, 2012 dhe 2015. Si burim i krijimit të

---

<sup>9</sup> Shihni komunikimet elektronike të datës 1.9.2020 në dosjen e Komisionit.

kësaj pasurie, në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në për vitin 2015, janë deklaruar të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit.

Për të verifikuar mundësinë e pagimit të çmimit të shitjes me të ardhura ligjore nga Komisioni janë evidentuar të ardhurat nga pagat, likuiditetet në banka, kursimet në *cash* të deklaruara, pasuritë e blera (apartament banimi + mobilimin e tij), shpenzimet e jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së<sup>10</sup>, pasqyruar në tabelen më poshtë, nga ku rezulton se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë, pasi rezulton me një balancë negative prej 3.742.978 lekësh për vitin 2011 dhe prej 3.047.722 lekësh për vitin 2015, në dhjetor të të cilit subjekti kishte paguar këstin e fundit për blerjen e pasurisë (vlera në lekë është llogaritur referuar kursit të këmbimit të euros të datës 31.12.2011).

	<b>Përshkrimi</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2015</b>
<b>1</b>	<b>Pasuri</b>	<b>5 121 537</b>	<b>-866 387</b>	<b>-836 722</b>
	Apartament me sip. 89.52 m <sup>2</sup> , Përmet	3 196 850	150 000	384 595
	Automjet BMW	1 062 818		
	<b>SHTESA/PAKËSIME LIKUIDITETE</b>	861 869	-1 016 387	-1 221 317
<b>2</b>	<b>Të ardhura</b>	<b>2 472 647</b>	<b>2 369 648</b>	<b>2 132 107</b>
	Të ardhura nga pagat subjekti	1 297 166	1 151 909	1 384 513
	Të ardhura nga pagat bashkëshorti	777 096	789 033	641 747
	Të ardhura nga depozita në banka - tabelë shoqëruese për depozitat	398 385	428 706	105 847
<b>3</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>1 094 089</b>	<b>741 704</b>	<b>6 016 551</b>
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	546 480	558 192	897 104
	Pagesa blerje karburanti për makinën	350 000		
	Shpenzime qiraje ( <i>sipas pyetësorit standard</i> )	60 000	60 000	20 000
	Shpenzime arredimi			900 000
	Transaksione të bashkëshortit në OTP Bank			4 030 000
	Shpenzime udhëtimi	137 609	123 512	169 447
	<b>Mundësia për kursime (2-1-3)</b>	<b>-3 742 978</b>	<b>2 494 331</b>	<b>-3 047 722</b>

Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me pasurinë apartament banimi me nr. pasurie 9/145+1-7, blerë nga shoqëria “V.” sh.p.k., subjektit i kaloi barra e provës, sipas parashikimit të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve, si vijojnë:

i) Ka mospërputhje midis kontratës së porosisë, datë 7.4.2011 dhe kontratës së shitjes së pasurisë, datë 31.12.2015, akte në të cilat, ky çmim është përcaktuar përkatësisht në vlerat 30.000 euro dhe 27.000 euro.

ii) Në DPV-në për 2011, subjekti nuk ka deklaruar asnjë fakt për pasurinë apartament banimi, vit në të cilin sipas kontratës së shitjes ishte likuiduar shuma 19.500 euro + 500.000 lekë, si dhe nuk janë kryer deklarime për burimin e pagesave të kryera, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

iii) Në asnjë prej DPV-ve nuk është deklaruar detyrimi financiar ndaj shoqërisë ndërtuese, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

<sup>10</sup> Sipas përbërjes familjare të subjektit, 4 persona, shkresa nr. 804/1 prot., datë 29.1.2019, e ILDKPKI-së.

iv) Në të gjitha DPV-të janë kryer deklarime kontradiktore të cilat nuk përputhen me kontratën e shitjes, ashtu sikurse edhe me deklaramet gjatë procesit të rivlerësimit.

v) Në asnjë prej DPV-ve duke përfshirë edhe deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka kryer deklarime në lidhje me aktmarrëveshjen e datës 1.5.2011 dhe as veprime në lidhje me likuidimin në favor të shoqërisë apo kthimin e shumës në total prej 1.613.850 lekësh prej saj, sipas aktmarrëveshjes. Ka mospërputhje midis kësaj marrëveshjeje dhe kontratës së porosisë datë 7.4.2011, për sa i takon shumës që bashkëshorti i subjektit do të paguante pas regjistrimit të pasurisë në ZVRPP, ndërkohë që kjo marrëveshje nuk është përmendur në kontratën e shitjes në datën 31.12.2015. Në këto kushte, si dhe referuar faktit që në DPV-në për vitin 2015, subjekti nuk ka deklaruar asnjë detyrim ndaj shoqërisë "V." sh.p.k., mbetet ende i paqartë pagimi i shumës prej 1.600.000 lekësh në vitin 2016 në favor të kësaj shoqërie, si detyrim i debitorit A. P. për apartamentin e ndërtuar.

vi) Sipas kontratës së shitjes dhe dokumentacionit bankar që vërteton likuidimin e çmimit të shitjes, duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë në çmimin 27.000 euro ose 3.731.445 lekë, pasi rezulton me një balancë negative në shumën 3.742.978 lekë për vitin 2011 dhe në shumën 3.047.722 lekë për vitin 2015.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Së pari, në lidhje me mospërputhjet e çmimit të shitjes midis kontratës së porosisë lidhur në datën 7.4.2011 dhe kontratës së shitjes së pasurisë me datë 31.12.2015, përkatësisht në vlerat 30.000 euro dhe 27.000 euro, subjekti nuk ka dhënë sqarime. Ndërsa e pyetur në seancën dëgjimore, subjekti deklaroi se kjo mospërputhje kishte ardhur për shkak të mospërfshirjes në çmimin e shitjes të vlerës së sipërfaqes së ambienteve të përbashkëta ( ballkone, shkallë dhe ashensor), deklarim që nënkupton se për këto ambiente ishte parashikuar më parë një çmim prej 3.000 euro, vlerë e papaguar e shoqërisë ndërtimore.

Së dyti, në lidhje me mosdeklarimin në DPV-në e vitit 2011 të pasurisë apartament banimi, vit në të cilin sipas kontratës së shitjes ishte likuiduar shuma prej 19.500 euro dhe 500.000 lekësh, si dhe mosdeklarimin e pagesave të kryera sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, në parashtrimet e saj subjekti ka sqaruar se: *".... pagesat e kësteve për vitin 2011 nuk janë 19.500 euro dhe 500.000 lekë, por 10.000 euro dhe 200.000 lekë (likuiduar dorazi pronarit të objektit përkatësisht në datat 19.4.2011 dhe 20.6.2011), këste të cilat, për shkak të harresës nga ana e bashkëshortit, nuk janë deklaruar në DPV-në e vitit 2011, por janë deklaruar në DPV-në e vitit 2012, në të cilën janë paraqitur si dokumente dhe mandatpagesat e kryera, të cilat janë kryer nga të ardhurat e realizuara ndër vite (gjendje cash) dhe nga të ardhurat e realizuara për vitin 2011 nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit. Pagesat e tjera janë kryer nga vetë shoqëria ndërtuese, sipas aktmarrëveshjes së datës 1.0.2011, paraqitur si provë në Komision nga shoqëria ndërtuese V." sh.p.k ..."*.

Së treti, subjekti nuk ka dhënë sqarime në lidhje me mosdeklarimin në asnjë prej DPV-ve të detyrimit financiar ndaj shoqërisë ndërtuese, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar. Për sa i takon deklarametve kontradiktore në të gjitha DPV-të krahasuar me kontratën e shitjes, ashtu edhe deklaramet gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti nuk dha shpjegime, ndërsa në shpjegimet e pakta gjatë seancës degjimore deklaroi se këto kontradikta kanë ardhur për shkak

të neglizhencës dhe papërgjegjshmërisë, të cilat janë të lidhura me faktorët jetikë, siç kanë qënë problemet familjare për shkak të gjendjes shëndetësore të vajzës së saj, por edhe pakujdesisë në plotësimin e deklaratve periodike.

Së katërti, lidhur me paqartësitë e Komsionit për sa i takon shumës prej 1.600.000 lekësh paguar në vitin 2016 shoqërisë ndërtimore, mosdeklarimin e aktmarrëveshjes së datës 1.05.2011 dhe veprimeve ndërvepruese me shoqërinë ndërtimore brenda vitit 2011, si dhe mospërputhjen midis kësaj marrëveshjeje me kontratën e porosisë, datë 7.4.2011, në parashtrimet e saj, subjekti nuk ka dhënë vetëm këtë sqarim : “ *Sipas aktarrëveshjes, me regjistrimin e pronës në favor të porositësit (aktualisht bashkëpronësi), është bërë edhe likuidimi i pjesës tjetër të vlerës së apartamentit, në shumën prej 1.600.000 lekësh në favor të shoqërisë ndërtuese “V.” sh.p.k., vërtetuar kjo pagesë edhe nga të dhënat e referuara nga “Raiffeisen Bank”.*

Së pesti, lidhur me pamundësinë financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë në çmimin 27.000 euro ose 3.731.445 lekë, për shkak të një balance negative prej 3.742.978 lekësh për vitin 2011 dhe balacë negative prej 3.047.722 lekësh për vitin 2015, subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke deklaruar se: “ *... lidhur me analizën e Komisionit për pamundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit, për pagimin e kësteve sipas kontratës së porosisë, sqaroj se bazuar në të ardhurat nga paga e subjektit dhe të bashkëshortit të saj, duke përfshirë këtu edhe depozitat bankare deri në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit nuk ka qënë në pamundësi financiare për të shlyer të gjitha kështet sipas kontratës së porosisë, por ka qënë marrëveshja midis bashkëshortit të saj dhe shoqërisë ndërtuese “V.” sh.p.k., dhe realitetit që pa u bërë pronar në nuk mund të bënim likuidimin e gjithë vlerës së apartamentit, sipas kontratës së porosisë...* ”. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar që shuma në total prej 4.030.000 lekësh paguar nga bashkeshorti i saj A. P. në llogari të shoqërisë “B. P.” sh.p.k., është konsideruar pa të drejtë nga Komisioni si shpenzim familjar për vitin 2015. Ndërkohë, që nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar të kundërtën e barrës së provës (trajtuar në vijim në pikën 3 te rubrika Konstatime të tjera).

Përveç sa më sipër, subjekti ka vënë në dispozicion vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 28.4.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, me të cilin vërtetohen bonuse karburanti për vitin 2011, në shumën prej 245.000 lekësh, si dhe për vitet 2012 dhe 2013, përkatësisht në shumën 420.000 lekë, për secilin vit. Këto të ardhura, subjekti i konsideron si të ardhura suplementare, të cilat i ka përfshirë në analizën financiare të kryer prej saj, duke pretenduar që edhe nga Komisioni duhet të meren në konsideratë.

Bazuar në keto pretendime, subjekti ka paraqitur një analizë financiare, duke konsideruar pagimin e çmimit të shitjes për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi pjesërisht deri në vitin 2015, në shumën prej 15.500 eurosh dhe pjesërisht në vitin 2016, në shumën prej 11.500 euro, analizë sipas të cilës, balanca rezulton pozitive.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Pasi shtyrtoi të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje konstatimet për pasurinë objekt shqyrtimi, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk arriti të kundërshtojë apo të justifikojë në mënyrë bindëse pasaktësitë dhe mospërputhjet në

deklarime dhe as të provojë të kundërtën e barrës së provës për asnjë nga konstatimet, për shkak se:

Nuk u vërtetua me asnjë prove ndryshimi i mareveshjes për çmimin e shitjes dhe nuk u dhanë shpjegime në lidhje me shkaqet objektive dhe ligjore që kanë çuar në ndryshimin e çmimit të shitjes së pasurisë nga 30.000 euro parashikuar në kontratën e porosisë të datës 7.4.2011, në 27.000 euro sipas përcaktimit të kontratës së shitjes. Referuar deklarimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, e cila pranoi dy rrethana të favorizimit të shoqërisë ndërtimore, përmendur në paragrafin 1.4.5, pikat “a” dhe “b” të këtij vendimi, si dhe referuar deklarimit në seancën dëgjimore, ngrihen dyshime të arsyeshme se pagesa e një çmimi më të ulët se ai i parashikuar në kontratën e porosisë, është bërë në shkëmbim të favorizimit që i është bërë shoqërisë “V.” sh.p.k., prej bashkëshortëve A. dhe Silvana Pani.

Për sa i takon mosdeklarimeve në DPV-në e vitit 2011 të pasurisë dhe të pagesave për blerjen e saj, subjekti pranon se gjatë këtij viti janë kryer pagesat e kësteve në vlerat 10.000 euro dhe 200.000 lekë, të ndryshme nga ato të parashikuara në kontratën e shitjes, dhe se mosdeklarimi i tyre ka qenë një harresë gjatë plotësimit të formularit. Nga ana tjetër, për sa i takon mospërputhjes së këtyre pagesave me përcaktimin e vlerës së paguar sipas kontratës së shitjes (19.500 euro + 500.000 lekë), pa dhënë shpjegime të hollësishme, subjekti i referohet aktmarrëveshjes së datës 1.5.2011, e cila nuk ka qenë në asnjë moment pjesë e deklarimeve të subjektit. Për më tepër, shumën e pretenduar si të kthyer në vitin 2011, sipas aktmarrëveshjes prej 1.613.850 lekësh, subjekti nuk e ka deklaruar si gjendje *cash* në DPV-në për këtë vit.

Deklarimi i subjektit gjatë parashtrimeve, se pagesat e kryera në vitin 2011 janë deklaruar në DPV-në për vitin 2012, nuk e justifikon pasaktësinë në deklarin për vitin 2011, pasi në DPV-në për vitin 2012 është e vërtetë që subjekti ka deklaruar: “*Pagim kësti për blerje apartamenti 2+1, në Përmet me sip 98 m<sup>2</sup>, në shumën 10.000 euro dhe 200.000 lekë*”, por nuk ka bërë asnjë sqarim që këto pagesa ishin kryer përgjatë vitit 2011 dhe cilat ishin arsyt e mosdeklarimit të këtyre pagesave në këtë vit. Nga ana tjetër, në DPV-në për vitin 2012, subjekti nuk ka deklaruar pagesën reale prej 150.000 lekësh të kryer në datën 17.12.2012, nëpërmjet “Raiffeisen Bank”.

Subjekti nuk ka dhënë sqarime në lidhje me mosdeklarimin e detyrimit financiar ndaj shoqërisë ndërtuese, sipas ligjit nr. 9049 datë 10.4.2003, i ndryshuar, ashtu sikurse edhe për deklarimet kontradiktore për sa i takon çmimit të blerjes së pasurisë.

Në përfundim, Komisioni krijoi bindjen se modeklarimi i asnjë fakti në lidhje me pasurinë e porositur me kontratë porosie të datës 7.4.2011, si: pagesave të kryera gjatë vitit 2011; detyrimeve financiare ndaj shoqërisë ndërtuese; si dhe likujditetin *cash* të pretenduar të kthyer nga shoqëria ndërtimore brenda vitit, nuk janë thjesht një harresë nga subjekti gjatë plotësimit të DPV-së për vitin 2011. Përkundrazi, në kushtet kur përgjatë këtij viti nga subjekti ishte lidhur një kontratë porosie dhe u pretendua të jetë lidhur një marrëveshje e re midis palëve që ka ndryshuar mënyrën e likujdimit të çmimit të shitjes, si dhe në kushtet kur janë kryer disa transaksione midis palëve në *cash* dhe në rrugë bankare, subjekti duhet të ketë qenë plotësisht i ndërgjegjshëm për detyrimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar sipas të cilave subjektet kanë pasur detyrimin të deklarojnë brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, të të drejtave reale mbi to,

burimet e krijimit të tyre, detyrimeve financiare, etj. Këto detyrime, subjekti rezulton të mos i ketë përmbushur edhe në vijim, në DPV për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015, vite në të cilat, subjekti vijon të deklarojë në mënyrë kontradiktore me parashikimet në kontratën e shitjes, si dhe në asnjë prej tyre nuk ka deklaruar detyrime financiare ndaj shoqërisë, apo dhe marrëveshjen me shoqërinë ndërtimore. Për rrjedhojë, Komisioni vlerësoi se subjekti ka kryer deklarime jo vetëm të pasakta por edhe të pamjaftueshme në DPV-të që nga 2011-2016.

Për sa i takon shkakut të pagesës prej 1.600.000 lekësh në vitin 2016, subjekti i referohet, gjithashtu, marrëveshjes së datës 1.5.2011. Por, Komisioni nuk e gjeti të materializuar këtë aktmarrëveshje dhe atë çka ajo parashikon, në asnjë prej deklarimeve periodike vjetore apo në deklaratën *Vetting*, dhe as në kontratën e shitjes së datës 31.12.2015. E pyetur gjatë seancës dëgjimore përse nuk është parashikuar në kontratën e shitjes mënyra e re e likuidimit të çmimit të shitjes sipas aktmarrëveshjes së palëve të datës 1.5.2011, subjekti u përgjigj se e ka nënshkruar kontratën pa e lexuar (!!!). Po kështu, Komisioni nuk e gjeti të justifikuar ligjërisht veprimin e kthimit në *cash* nga shoqëria ndërtuese "V." sh.p.k., të shumës në total prej 1.613.850 lekësh bashkëshortit të subjektit, menjëherë pasi e kishte paguar këtë shumë në favor të shoqërisë në rrugë bankare, si pjesë e çmimit të blerjes së pasurisë.

Veç sa më sipër, Komisioni çmon të vejë në dukje faktin që me kërkesën e parë të Komisionit të datës 22.7.2020, shoqëria "V." sh.p.k. vuri në dispozicion mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes në mënyrën e përcaktuar në kontratën e shitjes së datës 31.12.2015, vërtetuar me dokumente bankare, pa përmendur ndonjë marrëveshje midis palëve. Vetëm pas kërkesës së dytë të Komisionit, të datës 7.8.2020, kjo shoqëri vuri në dispozicion aktmarrëveshjen e datës 1.5.2011. Kjo rrethanë, si dhe fakti që ky akt nuk është deklaruar asnjëherë prej subjektit dhe nuk është përmendur gjatë redaktimit të kontratës së shitjes, ngrenë dyshimin se aktmarrëveshja midis palëve në datën 1.5.2011, mund të jetë redaktuar në rastin më të mirë në momentin e plotësimit të DPV-së të vitit 2016, dhe në rastin më të keq, gjatë procesit të rivlerësimit.

Bazuar në të gjitha sa u arsyetuan më sipër, gjatë procesit të vendimmarrjes, Komisioni çmoi të mos e marrë në konsideratë aktmarrëveshjen e datës 1.5.2011 si provë shkresore që vërteton pretendimet e subjektit, sepse ky akt nuk mund të konkurojë me kontratën e shitjes më 31.12.2015 dhe pagesat e kryera në rrugë bankare sipas parashikimit në këtë kontratë, ashtu sikurse edhe me të gjitha provat e tjera që dëshmuajnë pasaktësi, paqartësi dhe pajaftueshmëri të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit për pasurinë objekt shqyrtimi, si gjatë deklaratave periodike ashtu edhe gjatë procesit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, çmimi i paguar për blerjen e pasurisë, në përfundim të procesit të rivlerësimit, u konsiderua i paguar terësisht brenda vitit 2015 dhe se subjekti ka qenë në pamundësi financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë për shkak të balancave negative për vitin 2011 dhe 2015, ashtu sikurse kishte rezultuar edhe në rezultatet e hetimit administrativ.

Por, në analizën financiare përfundimtare, Komisioni përfshiu si të ardhura ligjore edhe bonueset e karburantit për vitin 2011, 2012 dhe 2013, përkatësisht në shumat prej 245.000, 420.000 dhe 420.000 lekësh, të vërtetuara nga subjekti pas kalimit të barrës së provës. Për rrjedhojë, balanca negative për vitin 2011 ndryshon nga 3.742.978 lekë në 3.497.978 lekë,

ndërsa përmirësohet balanca pozitive për dy vitet e tjera<sup>11</sup>. Për sa i takon pretendimit në lidhje me shumën e konsideruar si shpenzim i subjektit prej 4.030.000 lekësh gjatë vitit 2015, për shkak të pagesave të kryera nga bashkëshorti i subjektit në llogari të shoqërisë “Blu Point” sh.p.k., subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë dhe dokument shkresor për të vërtetuar këtë pretendim<sup>12</sup>.

Por, edhe duke marrë në konsideratë pretendimin e subjektit, sipas të cilit gjatë vitit 2011, janë paguar vetëm shumat prej 10.000 euro dhe 200.000 lekësh përkatësisht në datat 19.4.2011 dhe 20.6.2011, nga analiza financiare e këtij viti sipas këtij varianti, subjekti do të rezultonte me një balancë negative prej 1.884.128 lekësh përgjatë këtij viti. Së bashku me diferencën negative për vitin 2015 prej 3.047.722 lekësh, subjekti do të rezultonte përsëri në pamundësi financiare për blerjen e pasurisë edhe sipas këtij varianti.

Përfundimisht, në përfundim të procesit të rivlerësimit, për sa i takon pasurisë apartament banimi në Përmet, me nr. pasurie \*\*\*, u konstatua se subjekti: (i) ka kryer deklarime të pasakta që vijnë në kundërshtim me ligjin; si dhe (ii) nuk justifikoi blerjen e saj me të ardhura të ligjshme, sipas germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, të cilat përbëjnë shkaqe për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84.2016.

**2. Apartament banimi me sip. 75.68 m<sup>2</sup>**, në bashkëpronësi me prindërit dhe të vëllanë me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, Përmet. Vlera: 19.425 lekë. Pjesa takuese: 25 %. Burimi i krijimit nga ligji “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Pagesa e vlerësimit të apartamentit sipas ligjit të mësipërm është bërë nga prindërit e subjektit.

Në lidhje me këtë pasuri ILDKPKI-ja ka konstatuar se subjekti nuk e ka deklaruar apartamentin e banimit në bashkëpronësi me prindërit dhe të vëllanë të përfituar nga privatizimi në deklaratimet e interesave private ndër vite.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni dhe procesi i rivlerësimit të kësaj pasurie**

Në lidhje me këtë pasuri gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se: (1) ASHK-ja Gjirokastrë<sup>13</sup> informoi se shtetasja Silvana P. Pani (S.) ka në bashkëpronësi me shtetasit K. S., P. S. dhe S. S. pasurinë e llojit apartament me sip. 75.68 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, Përmet; (2) OSHEE-ja<sup>14</sup> konfirmon në emër të z. P. S. (babai i subjektit), kontratën e furnizimit me Nr. \*\*\* në instancën Gjirokastrë, adresa Përmet.

#### **2.1 Nga deklaratimet e subjektit rezultoi se:**

Në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2003 dhe në deklaratimet periodike në vijim, subjekti nuk e ka deklaruar apartamentin e banimit në bashkëpronësi me prindërit dhe të vëllanë, përfituar nga privatizimi. Gjatë procesit të rivlerësimit, e pyetur mbi shkakun e mosdeklarimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2<sup>15</sup>, subjekti ka deklaruar se mosdeklarimi ka ardhur për shkak të harresës nga mospretendimi asnjëherë i kësaj pasurie, por edhe i faktit të

<sup>11</sup> Shihni analizën përfundimtare financiare në këtë vendim.

<sup>12</sup> Shihni shtjellimin në mënyrë të hollësishme në lidhje me këto pagesa në pikën 3 të paragrafit Konstatime të tjera.

<sup>13</sup> Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020, nga ASHK-ja Përmet, në dosjen e Komisionit.

<sup>14</sup> Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.1.2020, nga OSHEE-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>15</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ridërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 23.6.2020, në dosjen e Komisionit.

përpilimit për herë të parë të një deklarate pasurie, pa pasur ndonjë instruksion lidhur me mënyrën e hedhjes së të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera gjatë vitit.

**2.2.** Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të pasurisë, nga aktet<sup>16</sup> në dosje rezultoi se:

- Me kontratën për privatizimin e banesës, së datës 3.7.1993, shtetasi P. S. (babai i subjektit) ka privatizuar nga Ndërmarrja Komonale Banesa Përmet, banesën me adresë: nr. \*\*\*, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, në shumën 19.425 lekë.

- Sipas certifikatës familjare të datës 1.12.1992, rezulton se familja S. përbëhej nga prindërit dhe dy fëmijët K. S. dhe Silvana Sevo.

- Sipas vërtetimit të datës 21.10.2016 lëshuar nga ZVRPP-ja Përmet, rezulton se Silvana P. Pani (Sevo) ka të regjistruar në bashkëpronësi me shtetasit P. S., S. S., K. S. apartament me sip. 75.68 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, Përmet, me vlerë 19.425 lekë, përfituar nga ligji "Për privatizimin e banesave shtetërore".

Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me këtë pasuri, nuk ka pasur dyshime dhe problematika. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, nga Komisioni është evidentuar mosdeklarimi sipas ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, në deklaratën për vitin 2003 dhe në vijim i pjesës takuese të pasurisë në bashkëpronësi nga subjektit, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar. Në parashtrimet e saj të datës 29.9.2020, lidhur me këtë konstatim subjekti ka dhënë të njëjtat sqarime si gjatë procesit të rivlerësimit. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi se pasaktësia në deklarime qëndron, por nuk ka pasur për qëllim fshehjen e kësaj pasurie, dhe si e tillë për shkak të peshës specifike, nuk është çmuar si shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

**3.** Automjet, tip "BMW" me nr. shasie \*\*\*, viti i prodhimit 2001, blerë nga shtetasi B. P. (vëllai i bashkëshortit të subjektit). Vlera: 1.000.000 lekë. Nuk është deklaruar burimi i krijimit dhe as pjesa takuese.

Për këtë pasuri ILDKPKI-ja ka konstatuar: deklaram i paqartë dhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin e krijimit të shumës 1.000.000 lekë për blerjen e automjetit nga bashkëshorti.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni dhe procesi i rivlerësimit të kësaj pasurie**

DPSHTRR-ja<sup>17</sup> konfirmoi të regjistruar këtë automjet në emër të bashkëshortit të subjektit, z. A. P..

**3.1.** Në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë, nga aktet<sup>18</sup> në dosje rezulton se:

- Me prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 22.4.2010, i përfaqësuar B. P. (vëllai i bashkëshortit), ka caktuar si përfaqësues të tij z. A. P. për të vepruar në emër të tij lidhur me ushtrimin e të drejtës së pronësisë së automjetit tip "BMW" me nr. shasie \*\*\*, të cilën e kishte përfituar

<sup>16</sup>Shihni aktet në aneksin 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2019, nga ASHK-ja, Kamëz, Vorë në dosjen e Komisionit.

<sup>17</sup>Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2020, nga DPSHTRR në dosjen e Komisionit.

<sup>18</sup> Shihni aktet në aneksin 4/4 në dosjen e ILDKPKI dhe shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2020, nga DPSHTRR në dosjen e Komisionit.



sipas certifikatës së pronësisë lëshuar nga autoritetet amerikane. Sipas kësaj prokure, përfaqësuesi e merr mjetin në dorëzim në datën 22.4.2010.

- Sipas formularit të zhdoganimit të datës 28.10.2011, në emër të z. A. P., automjeti është zhdoganuar në doganën “3 Ura”, në shumën 62.818 lekë, vlerë e cila nuk është deklaruar nga subjekti.

- Me kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 2.11.2011, blerësi A. P. ka blerë nga shitësi B. P., automjetin tip “BMW”, në vlerën 1.000.000 lekë, shlyer totalisht jashtë zyrës së noterisë. Nga verifikimi i DPV-së për vitin 2011 konstatohet se bashkëshorti subjektit ka deklaruar blerjen e automjetit nga vëllai B. P., sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 2.11.2011, në vlerën 1.000.000 lekë. Burimi i deklaruar: shuma 500.000 lekë paguar *cash* të vëllait B. P. dhe shuma 500.000 lekë dhuratë prej tij.

### 3.2 Në lidhje me burimin e krijimit dhe analizën financiare

Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, por, duke qenë se në DPV-në e vitit 2011 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar si burim për blerjen e këtij automjeti: (i) shumën prej 500.000 lekësh paguar *cash* të vëllait B. P.; dhe (ii) shumën prej 500.000 lekësh dhuratë prej tij, subjektit iu kërkua të vërtetojë me dokumentacion shkresor të ardhurat e ligjshme të shtetasit B. P., me qëllim verifikimin e mundësisë financiare për dhurimin e shumës prej 500.000 lekësh.

Gjatë procesit të rivlerësimit subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë të ardhura ligjore të B. P. për vitin 2010 dhe as për vitin 2011, vit në të cilin është blerë automjeti (datë 2.11.2011). Ndërkohë, ka vënë në dispozicion dokumente që vërtetojnë të ardhura të personit të lidhur për vitet 2008 dhe 2009, dokumente të cilat janë paraqitur për të justifikuar mundësinë e personit të lidhur, z. B. P., për dhënien e një huaje subjektit të rivlerësimit në shumën prej 30.000 USD, në janar të vitit 2010 dhe të një huaje tjetër në shumën prej 5.000 USD në vitin 2009, të cilat janë marrë në shqyrtim nga Komisioni gjatë trajtimit të këtyre huave.

Për sa më sipër, shuma prej 500.000 lekësh e pretenduar si dhurate nga shtetasi B. P., nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën finciare, si në tabelën më poshtë, nga ku duket se në momentin e blerjes së mjetit subjekti nuk pa pasur mundësi për blerjen e tij për shkak të një balance negative prej 1.877.619 lekësh. Në këtë analizë, si shpenzim për blerjen e automjetit është konsideruar dhe vlera e zhdoganimit prej 62.818 lekësh, paguar nga subjekti.

	<b>Përshkrimi</b>	deri më 2.11.2011
<b>1</b>	<b>Pasuri</b>	<b>3 126 283</b>
	Apartament në Përmet	2 851 100
	Automjet tip “BMW”	1 062 818
	<i>Shtesa/pakësime/likuiditete</i>	-787 635
<b>2</b>	<b>Të ardhura</b>	<b>2 218 044</b>
	Të ardhura nga pagat subjekti	1 195 560
	Të ardhura nga pagat bashkëshorti	712 547
	Të ardhura nga interesat e depozitave bankare	309 937
<b>3</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>969 380</b>

Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	455 400
Pagesa për blerje karburanti për makinën	350 000
Shpenzime qeraje (sipas pyetësorit standard)	55 000
Shpenzime udhëtimi	108 980
<b>Mundësia për kursime (2-1-3)</b>	<b>-1 877 619</b>

Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me këtë pasuri, subjektit i kaloi barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e konstatimeve:

i) Në deklaratën *Vetting* nuk është deklaruar saktësisht vlera e automjetit, pasi nuk është përfshirë vlera e zhdoganimit, si dhe nuk është deklaruar burimi i krijimit të pasurisë, sipas shtojcës nr. 2 “deklarata e pasurisë” së ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ii) Subjekti nuk ka pasur të ardhura ligjore për krijimin e kësaj pasurie për shkak të një balance negative prej 1.877.619 lekësh.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në parashtrimet e datës 29.9.2020, lidhur me këto konstatime subjekti ka deklaruar se: “...në këtë çmim është deklaruar vlera reale e makinës për atë periudhë dhe jo pagesa e bërë nga bashkëshorti ....kjo vlerë përbëhet nga 500.000 dhuratë nga z. B. P. vëllai i bashkëshortit dhe se 500.000 lekë duhet që bashkëshorti të paguajë vëllain e tij por nuk është thënë se likuidimi i tij është bërë menjëherë. Pra, është mbajtur parasysh vetëm vlera reale për kohën e automjetit dhe jo likuidimi i tij. Për sa i përket zhdoganimit në vlerën 62.818 është bërë nga harresa ose kam pasur parasysh një vlerë të vogël nën 100.000 lekë. Ju sqaroj, gjithashtu, se automjeti tip ‘BMW’ në pronësi të bashkëshortit ka ardhur në Shqipëri në mars të vitit 2010 nga dogana e Durrësit dhe është përdorur nga bashkëshorti me prokurë deri në datën 2.11.2011, ditë kur u krye akti i shitjes. Pra, për të vërtetuar burimet e ligjshme të z. B. P. mendoj se duhen vërtetime para këtij viti. Por gjithashtu këtë mjet ai e ka blerë qysh në vitin 2006 dhe deri në mars të vitit 2010 mjeti është në pronësi dhe përdorur prej tij në SHBA. Pra, për të kërkuar burimet e ligjshme të z. B. P. është e pamundur sepse ka kaluar një periudhë shumë e gjatë kohe dhe dokumentet nuk rruhen për kaq gjatë. Z. B. P. jeton në SHBA qysh prej vitit 1996 e deri sot dhe është pasens që unë si subjekt rivlerësimi, të provojë të ardhurat e ligjshme të vëllait të bashkëshortit për blerjen e automjetit në SHBA, automjet i cili në dijeninë time është blerë në vitin 2006”.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Nga analiza e parashtrimeve të subjektit dhe deklarimeve në seancën dëgjimore të cilat konsistuan në të njëjtin qëndrim, konstatohet se subjekti nuk arriti të vërtetojë të kundërtën e barrës së provës për sa i takon mundësisë financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit, pasi:

Subjekti pretendoi që shuma prej 500.000 lekësh i është dhënë personit tjetër të lidhur, z. B. P., jo menjëherë me lidhjen e kontratës, pretendim i cili mbetet në nivel deklarativ. Nga ana tjetër, për sa i takon shumës prej 500.000 lekësh e deklaruar si dhuratë nga z. B. P., subjekti pretendoi se kjo vlerë përbën çmimin me të cilin B. P. e kishte blerë këtë automjet në vitin

2006, pa e vërtetuar këtë pretendim me ndonjë dokument shkresor, ndërkohë që, nuk paraqiti dokumentacion për të vërtetuar të ardhura të ligjshme të tij për blerjen e këtij automjeti në vitin 2006. Veç kësaj, fakti që në kontratë është përcaktuar si çmim shitjeje shuma prej 1.000.000 lekësh, e bën të paqartë deklarin e subjektit sipas të cilit shuma prej 500.000 lekësh ka qenë dhuratë prej z. B. P.. Në një rast të tillë, çmimi i shitjes në kontratë do të ishte 500.000 lekë.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se subjekti nuk justifikon blerjen e mjetit në datën 2.11.2011, në vlerën 1.000.000 lekë me të ardhura të ligjshme sipas parashikimit të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, të cilit i referohet neni 61/3 i këtij ligji.

Për sa i takon analizës financiare, duke qenë se në parashtrimet e saj, subjekti ka vënë në dispozicion vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 28.4.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, i cili vërteton bonuse karburanti, Komisioni përfshiu si të ardhur ligjore pjesën takuese të bonusit të karburantit për periudhën 1 janar - 2 nëntor 2011, në vlerën 204.167 lekë. Për këtë shkak, balanca negative e vënë në dispozicion të subjektit me rezultatet e hetimit, në përfundim ë procesit, ndryshon nga -1.877.619 lekë në -1.673.452 lekë.

Për sa i takon mosdeklarimit të vlerës së doganës, subjekti pretendoi se ka qenë një harrësë dhe Komisioni nuk e konsideroi këtë si një pasaktësi me peshë specifike, por vlerën e zhdoganimit e përfshiu si shpenzim në analizën financiare, për shkak se është vërtetuar e paguar nga bashkëshorti i subjektit.

Për sa i takon mosdeklarimit të burimit të të ardhurave për këtë automjetit në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në shtojcën nr. 2, “deklarata e pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Aq më tepër, në kushtet kur nuk u justifikua blerja e mjetit me të ardhura të ligjshme, në përfundim të procesit, Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjafueshëm, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, konstatimet si më sipër, vlerësohen si shkak për marjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani.

**4. Depozitë bankare në “Alpha Bank”** e krijuar më 26.7.2013, nga pakësimi i depozitës bankare në “Raiffeisen Bank” në emër të subjektit. Vlera e deklaruar e kësaj depozite është 2.693.368,88 lekë. Burimi i krijimit nga paga e subjektit dhe bashkëshortit.

Në lidhje me këtë depozitë ILDKPKI-ja ka konstatuar: në deklarinimet e interesave private ndër vite, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar saktë shtesat e kryera në depozitën në “Raiffeisen Bank” dhe burimin e krijimit të tyre. Gjithashtu, mungon dokumentacioni justifikues ligjor i burimit.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni dhe procesi i rivlerësimit të kësaj pasurie**

Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2019, “Alpha Bank” ka konfirmuar në emër të subjektit depozitën bankare me numër ....356130, e cila është çelur në datën 26.7.2013, nëpërmjet depozitimit *cash* të shumës prej 2.500.000 lekësh,

depozitë e cila në fund të vitit 2016, rezulton të jetë aq sa është deklaruar nga subjekti, në shumën prej 2.693.368, 88 lekësh, pasqyruar si në tabelën më poshtë:

Depozita në “Alpha Bank” e subjektit	2013	2014	2015	2016
Depozitë, datë 26.7.2013	2.500.000 <sup>19</sup>			
Të ardhura interesa të depozitës		121.500	40.108	31.760
<b>Shuma e depozitës ndër vite</b>	<b>2.500.000</b>	<b>2.621.500</b>	<b>2.661.608</b>	<b>2.693.368</b>

#### 4.1 Nga verifikimi i deklarimeve periodike konstatohet se:

- Në DPV-në e vitit 2013, vit në të cilin është çelur kjo depozitë, nuk rezulton që subjekti ta ketë deklaruar atë. Gjatë procesit të rivlerësimit, e pyetur për shkakun e mosdeklarimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se shkak për këtë mosdeklarim ka qënë harresa, duke menduar se ato nuk ishin shtesa të reja, por copëzimi i shumës së depozitës së deklaruar në “Raiffeisen Bank”, duke mos përbërë asnjë ndryshim në depozitat e saj.

- Në DPV-në për periudhën 2014 – 2016, subjekti deklaroi vetëm shtesat e krijuara në këtë depozitë në “Alpha Bank” dhe burimin e krijimit nga interesat bankare.

Në përfundim të hetimit administrativ me njoftimin e rezultateve të hetimit nga Komisioni u evidentua mosdeklarimi në DPV-në për vitin 2013 të depozitës në “Alpha Bank”, çelur në datën 26.7.2013, sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, konstatim për të cilin subjekti dha të njëjtat sqarime edhe gjatë procesit të rivlerësimit, duke theksuar se në DPV-në për vitet 2014 – 2016, ka qënë e saktë në deklaratimet e kësaj depozite dhe interesave të saj, fakt i cili rezulton të jetë i vërtetë. Por, pavarësisht kësaj, subjekti ka pasur detyrim për të deklaruar çeljen e kësaj depozite në DPV-në e vitit 2013, detyrim të cilin nuk e ka përmbushur. Pavarësisht se kjo pasaktësi nuk ka sjellë si pasojë fshehjen e kësaj depozite dhe për këtë shkak, në vetvete, nuk ka ndonjë peshë specifike të posaçme, Komisioni e çmon atë në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes.

#### 4.2 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite, u konstatua se:

Duke qënë se si burim i depozitës objekt shqyrtimi në “Alpha Bank”, është deklaruar pakësimi i depozitës në “Raiffeisen Bank”, nga Komisioni gjatë hetimit administrativ është verifikuar krijimi i depozitës në “Raiffeisen Bank”, si dhe mundësia financiare me të ardhura të ligjshme për të krijuar këtë depozitë ndër vite.

Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, të “Raiffeisen Bank”, subjekti ka pasur llogari depozite me numer .... \*\*\*, gjendja e të cilës në datën 25.7.2013, ka qënë 8.380.000 lekë. Subjekti e ka pakësuar këtë depozitë në datën 26.7.2013, duke tërhequr *cash* shumën prej 5.000.000 lekësh, nga të cilat në po këtë datë, shumën prej 2.500.000 lekësh e ka depozituar *cash* në “Alpha Bank”, pa përshkrim dhe shumën prej 2.500.000 lekësh e ka depozituar *cash* në “Tirana Bank”, me përshkrim *kursime familjare*.

<sup>19</sup> Shuma prej 2.500.000 lekësh rezulton të jetë tërhequr nga subjekti në datën 26.7.2013 prej llogarise në “Raiffeisen Bank” me numer .... \*\*\*, sipas konfirmimit të “Raiffeisen Bank”.

Për sa i takon burimit të ligjshëm të depozites në “Raiffeisen Bank”, nga verifikimi i DPV-ve, gjatë hetimit administrative rezultoi se:

**4.2.1** Në DPV-në për vitin 2003, subjekti ka deklaruar depozitë në Bankën e Kursimeve në shumën 2.000.000 lekë, por pa e vërtetuar këtë me një dokument bankar dhe pa deklaruar burimin e krijimit sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Gjatë procesit të rivlerësimit, e pyetur mbi burimin dhe dokumentet që vërtetojnë burimin e të ardhurave, subjekti deklaroi se burimi i shumës prej 2.000.000 lekësh në ish-Bankën e Kursimeve ka qenë nga të ardhurat nga pagat e saj për vitet 1993 – 1995 dhe 1995 e në vazhdim. Gjithashtu, sipas subjektit, në këtë shumë janë përfshirë edhe interesat nga depozitat në ish-Bankën e Kursimeve, si dhe nga të ardhurat në firmat piramidale pa e vërtetuar këtë fakt me dokument shkresor. Pasi janë verifikuar të ardhura të ligjshme të dokumentuara të subjektit të rivlerësimit<sup>20</sup> në periudhen përpara vitit 2003, si dhe pasuritë dhe shpenzimet sipas standardit të ILDKPKI-së<sup>21</sup> në tabelën më poshtë është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur mundësia financiare për krijimin e shumës prej 2.000.000 lekësh për periudhën 1995 - 2003, nga ku duket se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës në Bankën e Kursimeve në vitin 2003.

	Përshkrimi	1995 deri në fund 2003
<b>1</b>	<b>Pasuri</b>	<b>2 000 000</b>
	<i>Shtesa/pakësime/likuiditete</i>	2 000 000
<b>2</b>	<b>Të ardhura</b>	<b>4 182 955</b>
	Të ardhura nga pagat subjekti	4 182 955
<b>3</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>1 886 691</b>
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	1 835 691
	Shpenzime qeraje ( <i>sipas pyeteësorit standard</i> )	51 000
	<b>Mundësia për kursime (2-1-3)</b>	<b>296 264</b>

**4.2.2** Në DPV-në për vitin 2004 subjekti nuk ka deklaruar asnjë shtesë apo pakësim të kësaj depozite. Për herë të parë informacioni bankar për këtë depozitë në “Raiffeisen Bank”<sup>22</sup> vijon nga viti 2005, vit i cili fillon me një gjendje depozite prej 2.400.000 lekësh. Sipas këtij informacioni duket se gjendja e depozitës në fund të vitit 2004 ka qenë në shumën 2.400.000 lekë. Subjekti nuk e ka deklaruar në vitin 2004 shtesën prej 400.000 lekësh dhe burimin e të ardhurave sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

**4.2.3** Në DPV-në për vitin 2005, subjekti ka deklaruar “*shtesa në shumën 500.000 lekë, si dhe interes i lindur nga deklarimi i mëparshëm në shumën prej 70.000 lekësh*” papërcaktuar kujt depozite i referohet. Sipas dokumentacionit bankar, kjo depozitë në vitin 2005 është shtuar me 700.000 lekë dhe jo me 570.000 lekë deklaruar nga subjekti. Subjekti nuk e ka deklaruar

<sup>20</sup> Subjekti ka paga të dokumentuara duke filluar nga viti 1995 dhe bashkëshorti nga viti 2004.

<sup>21</sup> Në vitet 1995-1996 janë llogaritur shpenzimet e jetesës 80 % i të ardhurave nga pagat. Në vitet 1997-1999 janë llogaritur shpenzime jetese në shumën 5.000 lekë/muaj për person dhe numrit të personave në familje: një person në vitin 1997, dy duke filluar nga viti 1998 vit kur subjekti është martuar. Për vitet 2000-2003 shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së: për tre persona në vitet 2000-2002 dhe për katër persona në vitin 2003.

<sup>22</sup> Vit i ndryshimit nga Banka e Kursimeve në “Raiffeisen Bank”, dhe nga ku fillon sistem i ri elektronik i informacionit.

saktë shtesën në këtë depozitë dhe nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar. Gjendja e kësaj depozite në fund të vitit 2005 sipas dokumentacionit bankar ka qenë në vlerën 3.186.000 lekë.

**4.2.4** Në DPV-në për vitin 2006 subjekti ka deklaruar *shtesa në shumën 800.000 lekë*, pa përcaktuar kujt depozite i referohet. Sipas dokumentacionit bankar kjo depozitë në vitin 2006 është shtuar me 800.000 lekë (nga kursimet e pagës së subjektit dhe nga interesat). Pra, subjekti e ka deklaruar saktë shtesën, por nuk ka deklaruar burimin sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar. Gjendja e kësaj depozite në fund të vitit 2006 sipas dokumentacionit bankar ka qenë në vlerën prej 4.080.962 lekësh.

**4.2.5** Në DPV-në për vitin 2007, ka deklaruar *depozitë në shumën 500.000 lekë*, pa përcaktuar kujt banke i referohet (duhet të jetë shtesë depozite, pasi nuk rezulton të ketë pasur depozitë të re). Sipas dokumentacionit bankar, kjo depozitë në vitin 2007 është shtuar me shumën prej 992.000 lekësh. Pra, subjekti nuk e ka deklaruar saktë shtimin e depozitës, si dhe nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar. Gjendja e kësaj depozite në fund të vitit 2007 sipas dokumentacionit bankar ka qenë në shumën prej 5.200.000 lekësh.

**4.2.6** Në DPV-në për vitin 2008, ka deklaruar *depozitë në “Raiffeisen Bank”, shtesa në shumën 118.000 lekë*. Sipas dokumentacionit bankar, gjendja e depozitës është shtuar vetëm nga interesat, në shumën prej 180.000 lekësh dhe jo në shumën prej 118.000 lekësh sa është deklaruar nga subjekti. Gjendja e depozitës në fund të vitit 2008 ka qenë në shumën prej 5.380.000 lekësh.

**4.2.7** Në DPV-në për vitin 2009, ka deklaruar *shtesa nga interesat e depozitës bankare në shumën 600.000 lekë*. Sipas dokumentacionit bankar, kjo depozitë në vitin 2009 është shtuar me 465.000 lekë, nga kursimet e pagës së subjektit dhe nga interesat. Subjekti nuk ka deklaruar saktë shtesën, si dhe nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar. Gjendja e kësaj depozite në fund të vitit 2009 ka qenë në shumën prej 6.250.000 lekësh.

**4.2.8** Në DPV-në për vitin 2010, ka deklaruar *depozitë bankare (shtesa) në shumën 344.375 lekë*. Sipas dokumentacionit bankar kjo depozitë në vitin 2010 është shtuar me 250.000 lekë, pra, subjekti nuk ka deklaruar saktë shtesën, si dhe nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar. Gjendja e kësaj depozite në fund të vitit 2010 ka qenë në shumën prej 6.810.000 lekësh (së bashku me interesat).

**4.2.9** Në DPV-në për vitin 2011, ka deklaruar *depozitë në “Raiffeisen Bank” (shtesa nga interesat) në shumën prej 498.300 lekësh*. Sipas dokumentacionit bankar kjo depozitë në vitin 2011 është shtuar me shumën prej 100.000 lekësh të derdhura *cash*. Pra, subjekti nuk ka deklaruar saktë shtesat, si dhe nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar. Gjendja e kësaj depozite në fund të vitit 2011 sipas dokumentacionit bankar ka qenë në shumën prej 7.308.300 lekësh (së bashku me interesat).

**4.2.10** Në DPV-në për vitin 2012, ka deklaruar *shtesa nga interesat e depozitës në “Raiffeisen Bank” në shumën 428.706 lekë*. Sipas dokumentacionit bankar kjo depozitë në vitin 2012 është shtuar me shumën 500.000 lekë, nga kursimet e pagës së subjektit. Subjekti ka një

pasaktësi të vogël në deklaram, si dhe nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar. Gjendja e kësaj depozite në fund të vitit 2012 sipas dokumentacionit bankar ka qenë në shumën prej 8.237.000 lekësh (së bashku me interesat).

**4.2.11** Në DPV-në për vitin 2013, ka deklaruar *pakësim në depozitën në “Raiffeisen Bank” në shumën prej 500.000 lekësh dhe shtesa nga interesat e depozitës bankare në shumën 147.047 lekë*. Sipas dokumentacionit bankar vërtetohet se interesat kanë qenë në shumën 147.047 lekë dhe depozita është pakësuar me shumën 550.000 lekë. Siç vërehet ka një pasaktësi të vogël në deklaramin e pakësimit të likuiditetit. Ndërkohë, në datën 26.7.2013, shuma prej 5.000.000 lekësh ka kaluar tek “Alpha Bank” dhe “Tirana Bank” përkatësisht nga 2.500.000 lekë në secilën bank. Gjendja e kësaj depozite, mbetur në “Raiffeisen Bank”, në fund të vitit 2013 sipas dokumentacionit bankar ka qenë në shumën 2.500.000 lekë. Në DPV-në për vitin 2013, subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e depozitës në “Raiffeisen Bank” në shumën 5.000.000 lekë, si dhe hapjen e dy depozitave në “Alpha Bank” dhe “Tirana Bank”.

Në lidhje me depozitën në “Raiffeisen Bank”, në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e konstatimeve, duket se:

i) Në DPV-të për periudhën 2003 – 2013, subjekti ka kryer deklarime të pasakta të shtesave dhe pakësimeve të likuiditeteve në depozitën në “Raiffeisen Bank”, si dhe nuk ka deklaruar dhe vërtetuar me dokumentacion shkresor burimin në rastin e shtesave.

ii) Në DPV-në për vitin 2013, subjekti nuk ka deklaruar pakësimin në shumën prej 5.000.000 lekësh në “Raiffeisen Bank”, si dhe hapjen e dy depozitave në “Alpha Bank” dhe “Tirana Bank” sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

iii) Nga analiza financiare pasqyruar në tabelën e vënë në dispozicion me rezultatet e hetimit, duket se subjekti nuk ka qenë në gjendje të justifikojë me të ardhura të ligjshme, shtesat në depozitën në “Raiffeisen Bank”, si dhe të mbulojë shpenzimet përgjatë periudhës 2003 – 2013, për shkak të balancave negative përkatësisht : në vitin 2006, në shumën 320.588 lekë; në vitin 2007, në shumën 3.552.843 lekë; në vitin 2009, në shumën 359.632 lekë; në vitin 2010, në shumën 814.012 lekë; dhe në vitin 2011, në shumën 3.742.978 lekë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Së pari, në parashtrimet e datës 29.9.2020, lidhur me deklaramet e pasakta të shtesave dhe pakësimeve në DPV-të për periudhën 2003 – 2013, si dhe burimin e shtesave të likuiditeteve, subjekti ka pretenduar se për vitin 2004 nuk është pajisur me informacion nga banka por nga veprimet bankare gjatë vitit 2005 evidentohet se shuma 2.400.972 lekë vjen nga një depozitë e mëparshme<sup>23</sup>. Ndërsa, për vitet 2005 – 2013, subjekti ka specifikuar në mënyrë analitike

<sup>23</sup> Subjekti ka vënë në dispozicion një fragment të lëvizjes së llogarisë dhe sqaron se: “...për vitin 2004 nuk disponoj asnjë dokument, megjithë kërkesën e bërë në ‘Raiffeisen Bank’. Nga kërkimet pranë ‘Raiffeisen Bank’ në lidhje me depozitën në datën 28.9.2020 më është dorzuar NRP Balancë me veprime në depozitë nga data 25.2.2005 – 16.12.2005. Në këtë statement evidentohet kalimi i shumës 2.400.972,99 lekë (depozita 0003635155 e Silvana Panit, depoz 3-mujore në depozitë 6-mujore)”.

shtesat e depozitave gjatë çdo viti dhe burimin e krijimit të tyre i, cili deklarohet të jetë nga: (i) kurimet nga paga e atij viti; dhe (ii) interesat nga depozita.

Së dyti, në lidhje me mosdeklarimin në DPV-në për vitin 2013, të pakësimit të shumës prej 5.000.000 lekësh të depozitës në “Raiffeisen Bank”, si dhe hapjen e dy depozitave në “Alpha Bank” dhe “Tirana Bank”, subjekti ka sqaruar: *“Në DPV 2013 nuk është deklaruar prej meje hapja e depozites se re në Alpha Bank, pasi ajo është krijuar nga copëzimi i depozitës ekzistuese në “Raiffeisen Bank”, ku konkretisht në datën 26.7.2013, është bërë pakësimi i depozitës në “Raiffeisen Bank”, nr. 0002628273, për shumën 2.500.000 lekë, e cila është depozituar po atë ditë në Alpha Bank”.*

Së treti, në lidhje me pamundësinë financiare për të justifikuar me të ardhura të ligjshme, shtesat në depozitën në “Raiffeisen Bank”, si dhe të mbulojë shpenzimet përgjatë periudhës 2003 – 2013, për shkak të balancave negative për vitet 2006 – 2010, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit një analizë financiare sipas së cilës ka pasur mundësi financiare dhe rezulton me balancë pozitive për të gjitha vitet.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Në lidhje me mosdeklarimin e pakësimit të depozitës në “Raiffeisen Bank” në vitin 2013, si dhe shtesave të kësaj depozite, ndër vite, pavarësisht se këto ndryshime janë evidentuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ nëpërmjet informacionit bankar, kjo nuk e përjashton subjektin nga detyrimi për deklarimin e saktë të tyre në deklarimet periodike. Në lidhje me burimin e krijimit të shtesave të depozitës, subjekti ka prezantuar një përmbledhje të depozitave bankare ndër vite, duke paraqitur gjendjet në fund të çdo viti dhe burimin për shtesat, që janë nga pagat dhe interesat e depozitave, të cilat Komisioni i kishte evidentuar dhe i kishte përfshirë në analizën financiare bazuar në gjenden dhe ecurinë e depozitave sipas lëvizjeve të llogarive të subjektit dhe të bashkëshortit në sistemin bankar<sup>24</sup>.

Për sa i takon analizës financiare të prezantuar nga subjekti, Komisioni vlerësoi se nuk mund të merret në konsideratë, pasi përpos gabimeve materiale është e paplotë dhe nuk pasqyron situatën reale të subjektit dhe të familjes së saj, bazuar në provat dhe dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ.

Në përfundim, subjekti nuk arriti të kundërshtojë bindshëm barrën e provës, pasi sipas germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, nuk justifikoi me të ardhura të ligjshme shtesat në depozitën në “Raiffeisen Bank”, si dhe të mbulojë shpenzimet përgjatë periudhës 2003 – 2013, për shkak të balancave negative të rezultuara në vitet 2006, 2007, 2009, 2010 dhe 2011 (balanca negative për vitin 2011, është zvogëluar për shkak të marrjes në konsideratë të bonusit të karburantit, trajtuar në vijim në vlerësimin përfundimtar të analizës financiare), çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>24</sup> Gjendja e likuiditeteve në banka është evidentuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ. Burimi i shtesave të depozitave janë kursimet nga paga dhe interesat e gjeneruara nga vetë depozitat. Këto të fundit, nuk janë tërhequr cash nga subjekti dhe nuk mbeten si gjendje për t’u përdorur në llogaritë rrjedhëse të subjektit. Interesat, me maturimin e depozitës, riinvestohen dhe qëndrojnë të investuara/të mbyllura në depozita me afat 3 mujore deri 1-vjeçare.



5. Depozitë bankare në “Tirana Bank” e krijuar më 26.7.2013 nga pakësimi i depozitës bankare në “Raiffeisen Bank” në emër të subjektit. Vlera: 2.695.515,95 lekë. Burimi i krijimit nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit.

Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se sipas dokumentacionit të administruar nga “Tirana Bank”<sup>25</sup> subjekti rivlerësimi në datën 26.7.2013 ka krijuar depozitë me afat në shumën 2.500.000 lekë, dhe janë gjeneruar interesa për vitet 2014 – 2016 në shumën 195.516 lekë. Në datën 30.12.2016 depozita është në shumën 2.693.368,88 lekë, aq sa është deklaruar nga subjekti, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Depozita në “Tirana Bank” e subjektit	2013	2014	2015	2016
Depozitë, datë 26.7.2013	2.500.000			
Të ardhura interesa të depozitës		117.000	44.489	34.027
<b>Shuma e depozitës ndër vite</b>	<b>2.500.000</b>	<b>2.617.000</b>	<b>2.661.489</b>	<b>2.695.516</b>

5.2. Nga deklaratat periodike ka rezultuar se:

- Në DPV-në për vitin 2013 subjekti nuk e ka deklaruar këtë depozitë kursimesh. Gjatë procesit të rivlerësimit, e pyetur mbi shkakun e mosdeklarimit të kësaj depozite, subjekti deklaroi se kjo ka ardhur si pasojë e harresës duke menduar se ato nuk ishin shtesa të reja por copëzimi i shumës së depozitës së deklaruar në “Raiffeisen Bank”, duke mos përbërë asnjë ndryshim në depozitat e saj.

- Në DPV-në për vitet 2014 – 2016, subjekti deklaroi vetëm shtesat e krijuara në depozitë në “Tirana Bank” dhe burimin e krijimit të tyre nga interesat.

- Në deklaratën *Vetting* është deklaruar se burimi i kësaj depozite është nga pakësimi i depozitës bankare në “Raiffeisen Bank”. Ky deklarim i subjektit, u vërtetua referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, të “Raiffeisen Bank”, ku rezulton se në datën 26.7.2013, subjekti ka tërhequr *cash* shumën prej 5.000.000 lekësh, nga të cilat shumën prej 2.500.000 lekësh e ka depozituar *cash* në “Tirana Bank” në datën 26.7.2013.

Në përfundim të hetimit administrativ, u konstatua se në DPV-në për vitin 2013 subjekti nuk ka kryer deklarim të depozitës në “Tirana Bank”, çelur në datën 26.7.2013, sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, konstatim për të cilin në parashtrimet e datës 29.9.2020, subjekti ka sqaruar: *“Depozita në ‘Tirana Bank’ e krijuar më 26.7.2013 ka si burim pakësimin e depozitës te ‘Raiffeisen Bank’. Në DPV-në e vitit 2013 nuk e kam deklaruar si depozitë të re, pasi është krijuar nga depozita ekzistuese në ‘Raiffeisen Bank’”*.

Sqarimet e subjektit përputhen me lëvizjet bankare të evidentuara gjatë hetimit, por pavarësisht kësaj, subjekti ka pasur detyrimin për të deklaruar saktësisht depozitat në çdo bankë të nivelit të dytë, në rastin konkret në DPV-në e vitit 2013, detyrim të cilin nuk e ka përmbushur, duke e bërë këtë deklarim jo vetëm të pasaktë, por edhe të përsëritur, fakt që është marrë në konsideratë nga Komisioni në vlerësimin tërësor të çështjes.

<sup>25</sup>Shihni shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, nga “Tirana Bank”, në dosjen e Komisionit.

**6. Llogari rrjedhëse page në emër të subjektit.** Vlera: 11.835,48 lekë. Nuk përcaktohet banka.

Sipas shkresës së administruar nga “Raiffeisen Bank” me nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, u konfirmua llogaria e pagës së subjektit të rivlerësimit dhe gjendja në datën 27.1.2017 në shumën prej 11.835 lekësh.

**7. Llogari rrjedhëse kursimi në emër të subjektit.** Vlera: 747.273,73 lekë.

Sipas shkresës së administruar nga “Raiffeisen Bank” me nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, u konfirmua kjo llogari rrjedhëse me burim nga llogaria e pagës së subjektit të rivlerësimit, me gjendje në shumën prej 747.273,73 lekësh, më 27.1.2017.

**8. Llogari rrjedhëse e mbetur në emër të subjektit.** Vlera: 652,29lekë.

Sipas shkresës së administruar nga “Raiffeisen Bank” me nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, u konfirmua kjo llogari.

**9. Llogari rrjedhëse page në emër të bashkëshortit.** Vlera: -7.139,08 lekë.

Sipas shkresës së administruar nga “Raiffeisen Bank” me nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, u konfirmua kjo llogari.

#### **Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur - bashkëshorti**

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. P., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar që nuk ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e tij.

Nga hetimi administrativ nuk u konstatuan pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme në emër të bashkëshortit të subjektit në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*, përveç atyre pasurive të deklaruara nga subjekti. Por gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i DPV-ve, ka rezultuar se si subjekti ashtu edhe bashkëshorti nuk kanë deklaruar tri depozita bankare në “Tirana Bank” (trajtuar në rubrikën “konstatime të tjera” në vijim të këtij vendimi), sipas detyrimeve të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

#### **KONSTATIME TË TJERA**

Përveç verifikimit të pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, Komisioni kreu hetime në lidhje me disa konstatime të rezultuara gjatë hetimit administrativ, si vijojnë:

**1.** Në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se ajo dhe bashkëshorti, nëpërmjet prokurave me nr. \*\*\*, datë 1.11.2005 dhe nr. \*\*\*, datë 15.1.2008, janë autorizuar si përfaqësues ligjorë të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. me NIPT \*\*\*, me administrator z. N. P., vëllai i bashkëshortit, për të vepruar për llogari të kësaj shoqërie, duke vënë në dispozicion dokumentet<sup>26</sup>, si vijojnë:

---

<sup>26</sup>Shihni dokumentet në aneksin 35 të dosjes së ILDKPKI-së dhe dokumentet bashkëgjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 1 në dosjen e Komisionit.

- Prokurë e përgjithshme nr. \*\*\*, datë 1.11.2005, me të cilën z. N. P. , i ka dhënë të drejtën z. A. P. për të kryer veprime përfaqësimi ligjore dhe financiare në emër të shoqërisë sipas të dhënave në prokurë.

- Prokurë e posaçme nr. \*\*\*, datë 15.1.2008, me të cilën z. N.P., ka caktuar si përfaqësues të ligjshëm z. A. P., vëllanë tjetër të bashkëshortit dhe znj. Silvana Pani për të bërë përfaqësimin e shoqërisë të të tretët lidhur me aktivitetin e shoqërisë duke i dhënë të drejtat e përcaktuara në këtë akt.

- Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 11. 2.2016, nga znj. Silvana Pani, ku ndër të tjera deklaroi se prokura e posaçme nr. \*\*\*, datë 15.1.2008, është përpiluar nga shoqëria “N.” sh.p.k. pa dijeninë dhe miratimin e saj pasi ndodhej në SHBA, si dhe nuk ka kryer asnjë veprim juridik dhe asnjë përfaqësim të ngarkuar nga prokura. Ky deklarim bie në kundërshtim me faktin se në datën 31.10.2011, subjekti ka kryer pagesën prej 500.000 lekësh në llogarinë e shoqërisë “E.P.A.” sh.p.k., në “Raiffeisen Bank”, pagesë për të cilën, gjatë procesit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani, pranoi se ka qenë për llogari të shoqërisë “N.” sh.p.k.

- Ekstrakt i regjistrimit tregtar të QKB-së për shoqërinë “N.” sh.p.k., regjistruar në datën 31.10.2005 me përfaqësues ligjor dhe ortak z. N. P. me seli në Përmet, me objekt tregëtim karburantesh të ndryshme me pakicë, lënde djegëse të çdo lloji, etj.

Nisur nga dokumentet e administruara më sipër dhe duke mbajtur në konsideratë nenin 96 të Kodit të Procedurës Civile “*paisja me prokurë e përfaqësuesit*”, germa “ç”, sipas të cilit gjyqtarëve dhe prokurorëve iu ndalohej të jenë përfaqësues të palëve me prokurë, Komisioni kreu disa verifikime, duke kërkuar informacion nga gjykatat, prokuroritë, noterët në qytetin e Përmetit, zyra e tatimeve, bankat, etj, nëse subjekti Silvana Pani ka përfaqësuar në marrëdhëniet me të tretët shtetasin N. P., si administrator i shoqërisë “N.” sh.p.k., ose këtë shoqëri dhe nga përgjigjet zyrtare<sup>27</sup> rezultoi se:

Prokuroria Përmet ka informuar se nga ana e këtij institucioni në periudhën kohore 2006, 2007 dhe 2011, është bërë prokurim i fondeve për furnizimin me naftë të institucionit pranë subjektit “N.” sh.p.k. Referuar raportit profesional të subjektit të rivlerësimit konstatohet se për periudhën mars 2004 – shtator 2007, dhe shkurt 2011– mars 2016, znj. Silvana Pani ka ushtruar detyrën e drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Përmet.

Për të parë rolin e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Përmet, gjatë procedurave të prokurimit të furnizimit me naftë të këtij institucioni nga subjekti juridik “N.” sh.p.k., iu kërkua Prokurorisë së Rrethit Përmet si autoriteti kontraktues, informacion i plotë mbi titullarin e autoritetit kontraktor të kësaj procedure, duke vënë në

<sup>27</sup>Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 28.04.2020 nga noteri M. L.; shkresë kthim-përgjigje nr. 3 prot., datë 4.5.2020 nga noteri S. A.; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2020 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; shkresë kthim -përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2020, nga Gjykata e Apelit Gjirokastër; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., M/P, datë 4.5.2020, nga prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 3.6.2020, nga Drejtoria e Tatimeve Gjirokastër në dosjen e Komisionit; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2020, të Bankës së Shqipërisë në dosjen e Komisionit; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2020, të “Raiffeisen Bank” në dosjen e Komisionit; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 7.5.2020, të BKT në dosjen e Komisionit; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2020, të “Tirana Bank” në dosjen e Komisionit; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2020, të “ProCredit Bank” në dosjen e Komisionit; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2020, të “ABI Bank” në dosjen e Komisionit; shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\*prot., datë 5.5.2020, të “OTP Bank” në dosjen e Komisionit.

dispozicion njoftimin e fituesit, kontratën e nënshkruar nga titullari i autoritetit/zyrtari i autorizuar, si dhe çdo ankesë të paraqitur pranë autoritetit kontraktor në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet informoi se<sup>28</sup> në arshivën e saj për periudhën 2006 – 2007, janë gjetur vetëm urdhërpagesat, mandatarkëtimet në bankë, si dhe faturat tatimore të shitësit, ndërkohë që për vitin 2011 janë ngritur komisione sipas procesverbaleve përkatëse, duke vënë në dispozicion dhe urdhrin e prokurimit nr. 18, datë 25.11.2011, për prokurimin me vlera të vogla.

Nga gjithë informacioni dhe dokumentet e vëna në dispozicion nga Prokuroria e Rrethit Përmet konstatohet se:

i) Për vitin 2006, znj. Silvana Pani (urdhëruese) ka nënshkruar dy urdhërpagesa për kreditorin përfitues shoqëria “N.” sh.p.k., përkatësisht: urdhërpagesën nr. \*\*\*, datë 16.3.2006, për shumën 16.500 lekë dhe urdhërpagesën nr. \*\*\*, datë 10.4.2006, për shumën 16.500 lekë. Të dyja faturat tatimore të shitjes (nr. \*\*\*, datë 29.1.2006 dhe nr. \*\*\*, datë 25.2.2006) janë nënshkruar nga z. N. P., kunati i subjektit.

ii) Për vitin 2007, znj. Silvana Pani (urdhëruese) ka nënshkruar tre urdhërpagesa për kreditorin përfitues “E. P.” sh.p.k., përkatësisht: urdhërpagesën nr. \*\*\*, datë 14.5.2007, për shumën 17.100 lekë; urdhërpagesën nr. \*\*\*, datë 11.6.2007 për shumën 17.400 lekë; dhe urdhërpagesën nr. \*\*\*, datë 13.7.2007, për shumën 17.400 lekë. Faturat tatimore të shitjes (nr. \*\*\*, datë 27.4.2007; nr. \*\*\*, datë 1.6.2007; dhe nr. \*\*\*, datë 28.6.2007) janë nënshkruar nga z. N. P.<sup>29</sup>.

iii) Për vitin 2011, znj. Silvana Pani në cilësinë e drejtueses së prokurorisë ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. \*\*\*, datë 25.11.2011, “Për prokurimin me vlera të vogla” (naftë). Komisioni i prokurimit, referuar procesverbalit të datës 25.11.2011, vendosi të përcaktojë si fitues operatorin ekonomik “E. P” sh.p.k., për naftë, si dhe “R.” sh.p.k., dhe “E.” sh.p.k. për karburant. Fatura tatimore e shitjes nr. \*\*\*, datë 29.11.2011, për shitësin “E. P.” sh.p.k është nënshkruar nga z. N. P.

Nga analiza e dokumenteve të mësipërme, u konstatua se subjekti Silvana Pani, në cilësinë e drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Përmet, për të cilën ishte lëshuar një prokurë pa afat nr. \*\*\* kol, datë 15.1.2008, prej shoqërisë “NIEM” sh.p.k., ka vepruar në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, sipas të cilit zyrtari në ushtrimin e funksioneve të tij, paraprkisht sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh vetë çdo situatë të konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë ajo.

Për sa më sipër sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova dhe shpjegime për të vërtetuar të kundërtën.

---

<sup>28</sup> Shihni shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., E. N., datë 3.8.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, në dosjen e Komisionit.

<sup>29</sup> Mes shoqërisë “E. P” sh.p.k. dhe “N.” sh.p.k. ka pasur një marrëveshje shërbimi të datës 1.11.2007<sup>29</sup> sipas të cilës “E. P.” sh.p.k. i ka dhënë më nënqira “N.” sh.p.k. ambiente për mini market, lavazh dhe bar kafe në pikën e karburantit dhe po ashtu “N.” shpk do të kryejë në emër të “E. P.” edhe shitjen me pakicë të karburanteve në pikën e karburantit

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në parashtrimet e saj të datës 29.9.2020, lidhur me këtë konstatim, subjekti ka sqaruar: *“Për sa i përket prokurës së posaçme me nr. \*\*\*, datë 15.01.2008, është i vërtetë fakti se unë nuk kam qenë në dijeni të hartimit të kësaj prokure, pasi kjo prokurë në të vërtetë për personin tim është bërë thjesht, që në kushtet e ndonjë pamundësie të veprimit nga ana e administratorit të shoqërisë ‘N.’ sh.p.k., z. N. P., të bashkëshortit tim apo vëllait tjetër, z. A. P., unë të mund të kryeja thjesht një xhirim apo transferte lekësh, sipas kontratave të shërbimit apo nënkontratave të shoqërisë ‘N.’ sh.p.k, me ‘E. P.’, ‘E.P.’ dhe në fund me ‘B. P.’, por kjo, s’do të thotë që unë në prokurimet e zhvilluara me cilësinë e autoritetit kontraktor, të mos dija që shoqëria ‘Niem’ sh.p.k. me administrator z. N. P., ishte shoqëria e vëllait të bashkëshortit tim dhe në këto kushte sipas nenit 26 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” , i ndryshuar, me takonte mua si përfaqësuesja e autoritetit kontraktor, të refuzoja ofertën e përcaktuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave në kushtet e konfliktit të interesit, gjë e cila nuk është bërë prej meje në cilësinë e autoritetit kontraktor, për shkak të pamundësisë objektive, pasi dy nga ofertuesit ishin shoqëria ‘N.’ sh.p.k., me administrator kunatin tim, z. N. P. dhe tjetri shoqëria ‘R.’ sh.p.k., me administrator z. K. Gj., djali i dajës së bashkëshortit tim dhe tjetri shoqëria ‘E.’ sh.p.k., me një karburant jo cilësor dhe me çmimin më të lartë të ofruar. Në pamundësi objektive, pasi për blerjen e karburantit nuk mund të shikosh oferta të tjera jashtë qytetit ku ndodhet dhe institucioni ku punon, duke vlerësuar edhe faktin e mospasjes së ankesave nga dy ofertuesit e tjerë, është vendosur sipas vlerësimit të ofertave nga komisioni”.*

## **Vlerësimi i Komisionit**

Bazuar në deklaratimet si më sipër, të shprehura edhe në seancën degjimire, Komisioni çmoi se subjekti nuk vërtetoi të kundërtën e barrës së provës, pasi nuk ka shmangur konfliktin e interesit gjatë ushtrimit të detyrës si drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Përmet, duke vepruar në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Sipas fakteve dhe provave, si dhe vetë deklaratimeve të saj, subjekti ka qenë në dijeni të konfliktit të interesit. Pretendimet se mosrefuzimi i ofertës ka ardhur për shkak të pamundësisë objektive për blerje karburanti jashtë qytetit dhe mospasjen e ankesave nga ofertuesit e tjerë, nuk janë bindëse dhe në përputhje me ligjin, pasi subjekti në cilësinë e urdhërueses dhe drejtueses së prokurorisë, në kushtet e dijenisë së plotë mbi subjektet pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, si dhe të lidhjeve të afërta me ta, duhet që sipas nenit 37 të këtij ligji, të mënjante dhe zgjidhte vetë situatën e konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë, duke autorizuar një tjetër zyrtar për të kryer veprimet në emër të institucionit në lidhje me procedurat e prokurimit.

Në vlerësimin e tij, Komisioni i është referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, sipas të cilit, një zyrtar në ushtrimin e funksioneve të tij, me qëllim për të garantuar një vendimmarrje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, duhet të parandalojë konfliktin midis interesave publike dhe interesave private.

Po kështu, ky ligj në nenin 3 të tij, parashikon llojet e ndryshme të shfaqjes së konfliktit të interesit, si vijon:

“4. ....a) “konflikt faktik i interesit” është gjendja, ne të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij zyrtare;

b) “konflikt në dukje i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë;

c) “konflikt i mundshëm i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara;

ç) “konflikt rast për rast i interesit” është gjendja me konflikt interesi, në njërën nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë;

d) “konflikt i vazhdueshëm i interesit” është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.”

Ndërsa në nenin 5 të tij, përcakton shprehimisht interesa privatë, konkretisht: “Interesat private të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: dh) mardhënie: i) familjare apo të bashkëjetesës; v) të njohura të miqësisë apo të armiçësisë; e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni”.

Më tej, në nenin 37 të tij, ligji përcakton mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesit duke parashikuar shprehimisht se: “Për parandalimin sa më të hershëm dhe sa më efikas të çdo konflikti interesi, të çdo lloji qoftë ai: 1. Zyrtari, në ushtrimin e funksioneve të tij, paraprakisht, sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh vetë çdo situatë të konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë ajo, duke përdorur, sipas rastit dhe përshtatshmërisë, një apo disa nga mënyrat e mëposhtme:

a) duke transferuar a tjetërsuar interesat privatë;

b) duke u vetëpërkushtuar paraprakisht nga procesi konkret i vendimmarrjes, me përjashtim të rasteve kur është e pamundur delegimi i kompetencave të zyrtarit te një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës ose ne rastet e organit kolegjal, duke mos marrë pjesë në diskutimin dhe votimin e çështjes në konflikt;

c) duke dhënë dorëheqjen nga detyrat, funksionet apo angazhimet private, që janë në konflikt me funksionin e tij publik;

ç) duke dhënë dorëheqjen nga funksioni publik, veçanërisht në kushtet e lindjes së konflikteve të vazhdueshme të interesit”.

Nga ana tjetër, ligji nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, në nenin 37 të tij ka përcaktuar rastet e pengesave ligjore, lidhur me pjesëmarrjen e nëpunësit publik në një procedurë administrative, ndër të cilat parashikohen edhe rastet e mëposhtme:

b) bashkëshorti apo bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes direkt apo indirekt në çështjen në fjalë;

c) punonjësi apo personat e parashikuar nga paragrafi b) i këtij neni kanë një interes direkt apo indirekt në një çështje të ngjashme me çështjen në fjalë;

g) punonjësi ose personat e përmendur në paragrafin b) të këtij neni kanë miqësi ose armiqësi me palët e interesuara në procedimin administrativ apo lidhjen e kontratës.

Pra, pengesat ligjore të vendosura nga ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, apo Kodi i Procedurave Administrative, synojnë të rregullojnë marrëdhënie të caktuara midis palëve në procedura administrative, të cilat të ngrenë dyshime për respektimin ose jo të parimit të paanësisë ose të objektivitetit. Në vlerësim të pengesave ligjore të përcaktuara nuk është e nevojshme të provohet nëse veprimi apo pasoja ka ardhur, por mjafton vetëm mundësia e veprimit përkundrajt parimit të paanësisë dhe të objektivitetit.

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se gjatë ushtrimit të funksionit si drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, subjekti i rivlerësimit ka qenë në “konflikt të vazhdueshëm interesi”, së paku në dukje, gjatë procedurave të prokurimit të furnizimit me naftë të këtij institucioni nga subjekti juridik “N.” sh.p.k, për shkak të marrëdhënies së posaçme me administratorin e saj shtetasin N. P. (vëllai i bashkëshortit).

2. Në përgjigjet e pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se në periudhën gusht 2002 – maj 2015, ka banuar me qera në një apartament 1+1, në lagjen “\*\*\*\*”, Përmet, në pronësi të shtetasit K. N. J. (B. J.), banues në Greqi, ku në periudhën gusht 2002 – gusht 2007 ka paguar si qera mujore shumën prej 3.000 lekësh, kurse në periudhën 2007 – maj 2015 shumën prej 5.000 lekësh, pagesë e cila i është dhënë çdo muaj vëllait të pronarit shtetasit A. J. Pasi është pyetur nga Komisioni, subjekti ka vënë në dispozicion bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit standard shpegime e dokumente nga verifikimi i të cilave, Komisioni nuk ka ngritur dyshime në lidhje me këtë adresë të deklaruar. Shumat e deklaruara të pagimit të qirave janë konsideruar si shpenzime gjatë analizës financiare.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave<sup>30</sup> raporton se janë kryer transaksione nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. P., në “Societe Generale Albania” (OTP Bank), si vijon :

- në datën 30.7.2015, në shumën 1.500 000 lekë me përshkrimin “*derdhje cash në lekë*”.
- në datën 15.9.2015, në shumën 1.000.000 lekë me përshkrimin “*derdhje cash në lekë*”.
- në datën 30.10.2015, në shumën 1.530 000 lekë me përshkrimin “*derdhje cash në lekë*”.

Gjatë procesit të rivlerësimit, i pyetur mbi arsyen e kryerjes së këtyre transaksioneve subjekti Silvana Pani deklaroi<sup>31</sup>: “...këto pagesa janë kryer nga bashkëshorti i saj, z. A. P. pranë ‘Societe General Albania’ në favor të shoqërisë ‘B. P. P.’ sh.p.k me NIPT \*\*\*, për llogari të shitjes së karburantit të shoqëria “N.” sh.p.k. me NIPT \*\*\* me administrator z. N. P., vëllai i bashkëshortit, sipas kontratës së shërbimit midis qiradhënësit dhe qiramarrësit, si dhe prokurës nr. \*\*\*, datë 1.11.2005...”.

Për të vërtetuar këto deklarime, subjektit iu kërkuan faturat tatimore të shitjes si dhe mandatpagesat përkatëse që vërtetojnë likuidimin e faturave për shitjen e karburantit në shumat e mësipërme. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se nuk disponon dokumente vërtetuese, duke sqaruar se: “Midis ‘B. P. P.’ sh.p.k dhe ‘N.’ sh.p.k, ka pasur

<sup>30</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë .26.12.2019, të DPPPP-së në dosjen e Komisionit.

<sup>31</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ridërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 23.6.2020, në dosjen e Komisionit.

kontrats qiraje për mjedisin e përdorur dhe marrëveshje shërbim (bashkëngjitur përgjigjeve) për karburantin e shitur. Pra, shoqëria 'N.' sh.p.k., shet te B. P.' shërbimin e kryer (shitjen e karburantit) pasi , karburanti, mjedisi dhe gjithçka në objekt është pronë e 'B. P.' dhe jo e shoqërisë 'N.' sh.p.k. Shoqërisë 'N.', merr përsipër shitjen e karburantit te 'B. P.' me punonjësit e vet, xhirimin e lekëve nga karburanti i shitur në bankë në llogarinë e 'B. P.', si dhe mirëmbajtjen e ambienteve. Lekët e xhiros, derdheshin 2-3 herë në jave, prandaj janë dhe shuma të konsiderueshme, tre shumat e sipërpërmendura të cilat janë derdhur në 'Societe General Albania' në vitin 2015. Pra, këto shuma jane lekë të 'B. P' dhe jo të shoqërisë 'N.'. Në fund të muajit 'N.' sh.p.k. i faturonte 'B.P' sh.p.k., faturën për shërbimin e kryer. Pra, nuk ka fatura shitje karburanti nga 'N.' sh.p.k. jo për këto tre shuma por për asnjë tjetër. Karburanti shitet me kupon tatimor dhe çdo 24 orë sipas raportit tatimor, bashkëngjitur pritej fatura përmbledhëse me TVSH, me nipt-in e 'B.P' për xhiron e realizuar. Në rastet kur klienti është tatimpagues i regjistruar i pritët fatura me TVSH si tatimor, si në rastin e "C. " sh.p.k. e përmendur te pika 2...".

Ndërkohë, subjekti ka paraqitur një marrëveshje shërbimi nr. 057/2007, datë 1.11.2007 të lidhur mes shoqërive "E. P. A" sh.p.k. si marrës i shërbimit dhe "N." sh.p.k. si dhënës i shërbimit.

Në përfundim të hetimit administrativ, subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë shkresore për të vërtetuar kryerjen e pagesave në "OTP Bank" nga bashkëshorti në emër dhe për llogari të shoqërisë "N." sh.p.k., dhe as dokumenta shkresorë, si, kuona tatimore apo fatura tatimore të shitjes me TVSH të karburantit, etj, me qëllim vërtetimin e pretendimeve të ngritura në përgjigje të pyetësorit nr. 3. Si rrjedhim, në analizën financiare për vitin 2015, pasqyruar në mënyrë të përblehur në tabelën më poshtë, shumat e mësipërme janë konsideruar si shpenzime të subjektit të rivlerësimit. Përgjatë këtij viti, subjekti rezulton me një balancë negative prej 3.047.722 lekësh.

	<b>Përshkrimi</b>	<b>2015</b>
<b>1</b>	<b>Pasuri</b>	<b>-836 722</b>
	Apartament me sip. 89.52 m <sup>2</sup> , Përmet	384 595
	<i>Shtesa/pakësime/likuiditete</i>	-1 221 317
<b>2</b>	<b>Të ardhura</b>	<b>2 132 107</b>
	Të ardhura nga pagat subjekti	1 384 513
	Të ardhura nga pagat bashkëshorti	641 747
	Të ardhura nga interesat e depozitave bankare	105 847
<b>3</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>6 016 551</b>
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	897 104
	Shpenzime qeraje ( <i>sipas pyetësorit standard</i> )	20 000
	Shpenzime arredimi <sup>32</sup>	900 000
	Transaksione të bashkëshortit në "OTP Bank"	4 030 000
	Shpenzime udhëtimi	169 447
	<b>Mundësia për kursime (2-1-3)</b>	<b>-3 047 722</b>

<sup>32</sup> Deklaruar në DPV/2015.



Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

Në parashtrimet e datës 29.9.2020, lidhur me këtë konstatim subjekti vijoi të këmbëngulë se pagesat e kryera nga bashkëshorti në vitin 2015, nuk janë shpenzime të familjes së saj, duke sqaruar se : *“Pagesat në ‘Societe General Albania’ në shumën prej 1.500.000 lekësh, datë 30.7.2015; në shumën 1.000.000 lekë, datë 15.09.2015; dhe në shumën 1.530.000 lekë, datë 30.10.2015, janë pagesa të bëra për llogari të shoqërisë ‘B.P. P.’ nga ‘N.’ sh.p.k. Pra, këto nuk janë shpenzime nga familjaret e mi, por thjesht sa është kryer veprimi...”*

Subjekti ka bashkalidhur me prapësimet: (1) dokumentin “marrëveshje shërbimi”, datë 1.1.2017, midis shoqërive “B. P.” sh.p.k. dhe “N.” sh.p.k.; si dhe (2) deklaratë pa akt noterial të shoqërisë “B. P. P” sh.p.k., datë 27.4.2020, e cila konfirmon se: *“derdhjet e mësipërme ...janë të ardhura nga shitja e karburantit të realizuara nga ...shoqëria “B. P. P.” sh.p.k.”*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Subjekti nuk vërtetoi të kundërtën e barrës së provës, pasi nuk depozitoi asnjë dokument shkresor që të vërtetonte se shumata e paguara nga bashkëshorti janë të ardhura nga shitja e karburantit prej shoqërisë “N.” sh.p.k., për llogari të shoqërisë “B. P.” sh.p.k. E pyetur në seancën dëgjimore nga përfaqësuesi i vëzhguesave ndërkombëtarë se ku i kishte gjetur paratë bashkëshorti dhe nëse ai menaxhonte paratë *cash* të shoqërisë “N.” sh.p.k. përpara se t'i depozitonte në bankë, subjekti u përgjigj se nuk ishte në dijeni të këtij fakti. Në këto kushte, gjatë procesit të vendimmarrjes, shumata në total prej 4.030.000 lekësh, është përfshirë si shpenzim gjatë analizës financiare për vitin 2015 dhe, për rrjedhojë, balanca negative në shumën 3.047.722 lekë për vitin 2015 mbetet e pandyshuar.

Pas procesit të vendimmarrjes, zhvilluar në datën 1.10.2020 nga ora 14:00 – 16:00, me *e-mail* të datës 2.10.2020, ora 14:21, subjekti ka vënë në dispozicion në rrugë elektronike, një ekstrakt nga statement bankar të shoqërisë “B. P. P.” sh.p.k. pranë “Alpha Bank”. Duke qenë se këto dokumente shkresore u vunë në dispozicion pasi procesi i rivlerësimit ishte konsideruar i mbyllur dhe vendimmarrja kishte përfunduar, *e-mail*-i dhe dokumentet bashkëngjitur do të vihen në dispozicion të Kolegjit të Posaçëm të Apelimeve.

Por, pavarësisht kësaj, Komisioni çmon të theksojë se ky statement bankar nuk vërteton faktin që pagesat e kryera nga bashkëshorti i subjektit në shumata: (i) prej 1.000.000 lekësh në datën 18.9.2015, me përshkrimin *“depozituar nga A. P. shitje karburanti”*; dhe (ii) prej 1.530.000 lekësh, në datën 30.10.2015, me përshkrimin *“depozituar nga A. P.”*, janë të ardhura të përfituara nga shitja e karburantit prej shoqërisë “N.”sh.p.k., për llogari të shoqërisë “B. P.” sh.p.k. Veç kësaj, në këtë ekstrakt, vërtetohen edhe pagesa të tjera në shumën totale prej 3.066.000 lekësh të kryera gjatë periudhës 15.9.2015 – 30.10.2015, nga z. A. P., në llogarinë e shoqërisë “B. P.” sh.p.k., pagesa të cilat nëse do t'i shtoheshin analizës financiare, balanca negative e viteve e vitit 2015 do të shtoheshin me vlerën e këtyre pagesave.

**4.** Sipas dokumentacionit të administruar nga bankat rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. P. ka pasur tri llogari bankare në “Tirana Bank”<sup>33</sup> si vijojnë:

<sup>33</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, nga “Tirana Bank”, në dosjen e Komisionit.

1) llogari bankare në dollarë me nr. \*\*\*, çelur më 14.1.2008, datë në të cilën është depozituar shuma prej 29.720 USD dhe mbyllur në vitin 2014, e cila nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti dhe as nga bashkëshorti i saj në DPV-të 2008 – 2014, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar;

2) llogari bankare me nr. \*\*\*, në “Tirana Bank” në euro, çelur më 7.6.2007, datë në të cilën është depozituar shuma prej 6.000 euro dhe mbyllur në vitin 2012, e cila nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti dhe as nga bashkëshorti i saj në DPV-të 2007 – 2012, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 i ndryshuar;

3) llogari bankare me nr. \*\*\*, në “Tirana Bank” në lekë, çelur më 24.10.2006, datë në të cilën është transferuar shuma prej 18.816 lekësh nga shoqëria “E. P.” sh.p.k., mbyllur në vitin 2012, e cila nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti dhe as nga bashkëshorti i saj në DPV-të 2006 – 2012, sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i veprimeve bankare në “Tirana Bank”, rezultoi se janë konstatuar transaksionet, si vijojnë:

**4.1** Në datën 14.1.2008, z. A. P. ka kryer pagesën në shumën 41.650 USD në SHBA me përshkrimin “për L. Xh”, nëpërmjet llogarisë së tij nr. \*\*\*, shumë, e cila përbëhet nga 29.720 USD gjendje në llogari të kaluara po këtë datë prej llogarisë në euro, si dhe 12.033 USD të kaluara po këtë datë prej llogarisë në lekë.

Në lidhje me këtë shumë, në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se : ... në shkurt të vitit 2008 ka kryer operacionin implant coclear të vajzës E.P. në vlerën 42.000 USD dhe, për këtë shkak është kryer transferta e shumës 41.650 USD, nga llogaria e bashkëshortit në “Tirana Bank”, në datën 16 (data e saktë është 14) janar 2008, në llogari të motrës së saj L. Xh. në SHBA. Duke qenë se kjo shumë u pagua nga kompania e sigurimit të kësaj shtetaseje, kjo shumë u kthye brenda vitit sërish në llogari të bashkëshortit tim, z. A. P.... Këto pretendime janë vërtetuar me nxjerrjen e llogarisë nga “Tirana Bank”, vënë në dispozicion nga subjekti.

Në vijim të përgjigjeve të pyetësorit standard, subjekti ka bërë të ditur se për sigurimin e kësaj shume, e cila është kthyer nga SHBA-ja prej z. E. Xh. (bashkëshorti i znj. L. Xh.) në llogari të bashkëshortit, në datën 22.4.2008, ka marrë dy hua. Konkretisht, ka deklaruar se: “Kemi marrë borxh për transfertën e kryer në datën 16 (14) janar 2008, në shumën 41.650 USD, të cilat i ka marrë bashkëshorti im dhe konkretisht: 25.000 (njezet e pesë mijë) euro te z. K. Gj., i cili është djali i dajës së tij, administrator i firmës ‘R.’ sh.p.k. dhe 2.000.000 lekë te vëllai i tij, z. N. P., emigrant në Greqi dhe administrator i firmës ‘N’ sh.p.k., borxh i cili u kthye përsëri pasi operacioni nuk u pagua nga ana jonë. Ky borxh është marrë për shkak të mospasjes së bashkëshortit tim të autorizimit (prokurë) për të tërhequr këtë shumë nga depozita ime bankare (‘Raiffeisen Bank’) ndërkohë që unë ndodhesha së bashku me vajzën time në Amerikë për kryerjen e operacionit coclear implant”

Për sa i takon dy huave të sipërpërmendura, të cilat nuk janë deklaruar në asnjë prej DPV-ve dhe as në deklaratën Vetting, subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me periudhën e dhënies së tyre, por nga të dhënat bankare të “Tirana Bank” rezultoi se:

- Bashkëshorti i subjektit, z. A. P., në datën 7.6.2007, ka derdhur në llogarinë e tij me nr. \*\*\*, në “Tirana Bank” shumën prej 6.000 euro dhe në datën 17.12.2007 ka derdhur shumën prej

19.000 euro. Për të dyja këto veprime, në total për shumën 25.000 euro, nuk ka një përshkrim veprimi në lidhje me marrjen e ndonjë huaje.

- Bashkëshorti i subjektit, Z. A. P., në datën 3.10.2007, ka derdhur shumën prej 2.000.000 lekësh, në llogarinë e tij në lekë me nr. \*\*\*, në “Tirana Bank”, me përshkrimin “transfertë nga llogaria e kursimit”, e cila pas verifikimit rezultoi të jetë llogaria me nr. 1900-170123 200DF, çelur prej tij po në datën 3.10.2007, po në “Tirana Bank”. Nuk rezulton të ketë përshkrim veprimi për shkak të një huaje.

Në kushtet kur nuk është administruar asnjë kontratë huaje, si dhe në kushtet kur subjekti nuk ka kryer asnjë deklaram në lidhje me këto hua, Komisioni i është referuar deklarameve të subjektit *“Kemi marrë borxh për transfertën e kryer në datën 16(14) janar 2008, në shumën 41.650 USD”*, si dhe veprimeve bankare të bashkëshortit të subjektit, z. A. P., në vitet 2007 dhe 2008. Në përfundim të hetimit administrativ, duket se huat e pretenduara prej shtetasve K. Gj. dhe N. P., janë depozituar prej z. A. P. në “Tirana Bank” në vitin 2007, në mënyrën që u përshkrua dhe u vërtetua më sipër në llogaritë e tij në euro dhe në lekë. Këto dy llogari kanë shërbyer si burim për llogarinë bankare me nr. \*\*\*, të çelur në datën 14.1.2008, nga ku shuma prej 41.650 USD është transferuar në SHBA me përshkrimin “për L. Xh.”, me qëllim kryerjen e operacionit të vajzës E. P.

Por, nga verifikimi i DPV-së vitit 2007 dhe të gjitha DPV-ve në vijim, konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar sipas ligjit huat e marra, si dhe nuk ka paraqitur asnjë dokument që vërteton këto hua. Po kështu, nuk ka deklaruar detyrime financiare ndaj shtetasve K. Gj. dhe N. P., si dhe as detyrimin e shlyer ndaj tyre. Subjekti, pasi u pyet në lidhje me mosdeklarimin e këtyre huave, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, ka deklaruar se: *“... lidhur me huat e marra shtetasve K. Gj. dhe N. P., të padeklaruara në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, arsyeja ka qenë se këto hua janë marrë dhe janë kthyer brenda vitit, duke pasur një efekt financiar zero në llogaritë tona bankare dhe duke mos pasur një trajnim për mënyrën e përpilimit të deklaratave periodike vjetore në lidhje me të gjitha veprimet financiare dhe shpenzimet e kryera janë bërë edhe një sërë gabimesh apo mosdeklarimesh të sakta, sikurse është dhe rasti konkret apo rasti i mosdeklarimit të shumës së paguar nga kompania ‘A.’ në SHBA, lidhur me operacionin e vajzës sonë”*.

Ky deklaram i subjektit vjen në kundërshtim me deklaramet e saj në pyetësorin standard, ku ka deklaruar se huat prej shtetasve K. Gj. dhe N. P kanë shërbyer si burim për dërgimin e shumës 41.650 USD, në SHBA, më 14.1.2008. Po kështu, duke ndjekur rrjedhën kronologjike dhe logjike të veprimeve bankare dhe deklarameve të subjektit, shumat e pretenduara të marra hua janë ato që bashkëshorti i subjektit ka depozituar në llogaritë e tij në “Tirana Bank” në vitin 2007 (fakt i pakundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit).

Për sa më sipër, është tërësisht e vërtetuar se veprimet bankare nga bashkëshorti i subjektit me objekt shumat e pretenduara, të mara hua dhe dërgimi e kthimi i tyre nga SHBA-ja janë kryer përkatësisht në vitet 2007 dhe 2008 dhe jo në vitin 2009, deklaruar nga subjekti. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me mosdeklarimin e huave të marra prej shtetasve K. Gj. e N. P., për shkak se ishin marrë dhe kthyer brenda vitit, duket i pabazuar dhe i pavërtetë.

Pavarësisht se huat e pretenduara nuk janë deklaruar sipas ligjit në DPV, bazuar në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të provojë me dokumenta shkresorë burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasve K. Gj. dhe N. P.

Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, sa i takon burimit të ligjshëm të të ardhurave të shtetasit N. P., subjekti ka paraqitur: formularët e deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimin për vitet 2006 dhe 2007, të shoqërisë “N.” sh.p.k.; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.6.2020, nga DRT-ja Gjirokastër në lidhje me qarkullimin e realizuar për vitin 2008 nga shoqëria “N.” sh.p.k.; ekstrakt të thjeshtë të shoqërisë “N.” sh.p.k. Nga këto dokumente, që janë fotokopje dhe të pakonfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve, duket se të ardhurat e z. N. P., për vitet 2006 dhe 2007, kanë qenë në vlerën 860.674 lekë, pra, të pamjaftueshme për dhënien e huas prej 2.000.000 lekësh.

<b>N. P.</b>	<b>Fitimi realizuar</b>	<b>Tatim-fitimi</b>	<b>Fitimi neto</b>
Deklarata e pagesës së tatim-fitimit, viti 2006	665 200	133 040	532 160
Deklarata e pagesës së tatim-fitimit, viti 2007	410 642	82 128	328 514
<b>Total</b>			<b>860 674</b>

Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit K. Gj., subjekti nuk ka paraqitur dokumenta që vërtetojnë të ardhura të tij, por ka paraqitur një ekstrakt të thjeshtë të shoqërisë “R.” sh.p.k., administrator i së cilës është z. K. Gj.. Nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-së, rezultoi se për vitet 2006 dhe 2007, kjo shoqëri nuk ka shpërndarë dividend.

Në përfundim të hetimit administrativ, subjekti nuk vërtetoi me dokumente shkresore të ardhura të ligjshme të huadhenësve, për të cilët u kryen hetime edhe në lidhje me konfliktin e interesit apo përfshirjen e tyre në veprimtari të krimit të organizuar<sup>34</sup>, nga ku nuk rezultuan të dhëna.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i kaloi barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe duket se:

- i) Në asnjë prej DPV-ve subjekti nuk ka deklaruar huat dhe detyrimet financiare ndaj shtetasve K. Gj. dhe N. P., sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
- ii) Nuk vërtetohet me dokumente shkresore marrja e huave prej shtetasve K. Gj. dhe N. P., të cilat nuk rezultojnë që të kenë kaluar në rrugë bankare në llogari të bashkëshortit të subjektit.
- iii) Subjekti nuk provoi burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasve K. Gj. dhe N. P. sipas pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- iv) Ka deklarime kontradiktore e të pasakta të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me marrjen dhe kthimin e huave.
- v) Subjekti nuk ka deklaruar në asnjë nga DPV-të sipas detyrimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, tri llogaritë bankare në emër të bashkëshortit në “Tirana Bank”: (1) llogarinë bankare në dollarë me nr. \*\*\*, çelur më 14.1.2008 dhe mbyllur në vitin 2014;

<sup>34</sup> Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2020, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit dhe shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2020, nga Prokuroria Përmet, në dosjen e Komisionit.

(2) llogarinë bankare në euro, me nr. \*\*\*, çelur më 7.6.2007 dhe mbyllur në vitin 2012; (3) llogarinë bankare në lekë, me nr. \*\*\*, çelur më 24.10.2006 dhe mbyllur në vitin 2012.

iv) Për të gjitha arsyet e sipërpërmendura, huat në shumat 25.000 euro dhe 2.000.000 lekë, nuk janë konsideruar si të ardhura të ligjshme gjatë analizës financiare për vitin 2007, i cili duket se ka një balancë negative prej 3.552.843 lekësh.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit në lidhje me çdo pretendim**

Në përfundim të procesit, Komisioni konkludoi se subjekti nuk vërtetoi të kundërtën e barrës së provës, në lidhje me të gjitha konstatimet, arsyetuar si vijon:

i) Në lidhje me mosdeklarimin e huave në vitin 2007 dhe detyrimeve financiare ndaj shtetasve K. Gj. dhe N. P., subjekti ka deklaruar: “... shumat prej 25.000 euro, marrë nga z. K. Gj. djali i dajës së bashkëshortit tim, si dhe 2.000.000 lekë, të marra nga vëllai i bashkëshortit, z. N. P., nuk janë deklaruar pasi nuk është konsideruar si hua por si një shumë e kthyeshme për një periudhë të shkurtër kohe”. Ky pretendim nuk e përjashton subjektin nga detyrimi për të deklaruar saktësisht huat e marra, detyrimet financiare për shkak të huave, si dhe pakësimin e likuiditeteve që kanë shërbyer për kthimin e huave, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

ii) Për sa i takon konstatimit se nuk vërtetohet me dokumente shkresore marrja e huave nga shtetasit K. Gj. dhe N. P., të cilat nuk rezultojnë që të kenë kaluar në rrugë bankare në llogari të bashkëshortit, subjekti ka parashtruar se: “Këto dy hua, njëra për operacionin e vajzës dhe tjetra për garanci për marrjen e vizës për trajtimin e mëtejshëm pas operacionit të vajzës sonë në SHBA, në kushtet e pamundësisë së kryerjes së këtij operacioni nga shteti ynë, nga të gjitha shpjegimet tona, si dhe dokumentacionet e vëna në dispozicion, rezultojnë se nuk janë marrë as për të blerë shtëpi dhe as pasuri të tjera, por janë marrë për arsye shëndetësore, për nevojën më jetike të femijës sonë, nga të afërmit tanë, të cilët padyshim që kanë pasur mundësi financiare më të shpejtë për dhënien e tyre thjesht dhe dorrazi, një veprim i kryer në kushte mirëbesimi dhe për ndihmë shëndetësore, që çdokush do ta bënte në rastin konkret, nëse do të kishte mundësi financiare”.

Në lidhje me këtë pretendim, Komisioni çmon se është e vërtetë që për shkak të marrëdhënieve familjare, dhënia e marrja e huas mund të bëhet pa një akt shkresor. Por në kushtet kur : (i) subjekti nuk ka kryer asnjë deklaram në DPV në lidhje me huat dhe shlyerjen e tyre duke i përmendur ato vetëm gjatë procesit të rivlerësimit në plotësimin e pyetesorit standard; (ii) në asnjë moment gjatë derdhjeve cash që bashkëshorti i subjektit ka kryer në llogaritë e tij në “Tirana Bank” nuk rezulton të ketë një përshkrim veprimi me objekt huat e marra; (iii) subjekti nuk vërtetoi edhe pas kalimit të barrës së provës të ardhura të ligjshme të huadhënësve për dhënien e huave, Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit nuk vërtetetoi marrjen e dy huave nga shtetasit N. P. dhe K. Gj., gjë që ka sjellë si pasojë balancën negative për vitin 2007. Në këtë mënyrë, nuk vërtetohet dhe burimi i ligjshëm i shumës prej 41.650 USD derguar në SHBA nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit më 14.1.2008, si burim për të cilën subjekti ka deklaruar dy huat e marra nga shtetasit K. Gj. e N. P..

Veç sa më sipër, deklarimi i subjektit në parashtrime se vetëm njëra prej huave ka shërbyer për operacionin e vazhës në shkurt të vitit 2008, përveç se bie në kundërshtim me deklarinin në pyetësonin standard se si burim për krijimin e shumës 42.000 USD kanë shërbyer të dyja huat, vërteton akoma me shumë mungesën e burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj shume. Nga ana tjetër, deklarimi se njëra prej huave ka shërbyer si garanci për marrjen e vizës amerikane, bie në kundërshtim me deklarinin në DPV-në e vitit 2009, ku subjekti ka deklaruar marrjen e një huaje prej 30.000 USD, nga vëllai i bashkëshortit, z. B. P., për ta vënë si garanci për marrjen e vizës amerikane.

iii) Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasve K. Gj. dhe N. P. subjekti ka sqaruar se: *“... në lidhje me të ardhurat e vëllait të bashkëshortit z. N. P., ju bëj me dije se fitimit të tij nga firma ‘N.’ sh.p.k., për dy vjet në shumën prej 860.674 lekësh i duhen shtuar edhe kursimet e tij nga puna si emigrant në Greqi për një periudhë mbi 10-vjeçare, por dhe faktit që një pjesë e lekëve është marrë dhe nga xhiroja e momentit nga shitja e karburantit në marrëveshje me palën kontraktuese. Për sa i përket dokumentacionit të firmës ‘N.’ një është fotokopje kurse tjetra është dokument origjinal i dalë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë. Po kështu, edhe dokumenti i firmës ‘R.’ sh.p.k., i vulosur nga organi tatimor, ju është përcjellë si provë e të ardhurave të ligjshme të firmës ‘R.’ sh.p.k., dokumente të cilat po ua bashkangjisim përsëri më të zgjeruara, të vërtetuara nga organi tatimor”*.

Për sa i takon të ardhurave të z. N. P., nuk është paraqitur asnjë dokument shtesë për të provuar të ardhura nga puna e tij si emigrant në Greqi apo për të provuar qarkullimin e momentit nga shitja e karburantit shoqëria “N.” sh.p.k.

Për sa i takon të ardhurave të z. K. Gj., subjekti i ka bashkëlidhur prapësimeve këto dokumente: (1) bilancin e vitit 2007 të shoqërisë “R.” sh.p.k. me administrator zotin K. Gj.; dhe (2) dokumentin origjinal nga DRT-ja Gjirokastrë që vërteton xhiron e realizuar në lekë të kësaj shoqërie për vitet 2006, 2007 dhe 2008.

Nga verifikimet, duket se huaja e dhënë subjektit nuk evidentohet në bilancin e shoqërisë “Rosi” sh.p.k. për vitin 2007. Gjithashtu, nga ky bilanc, duket se nuk është shpërndarë dividend nga shoqëria.

Sa më sipër, gjatë vleresimit përfundimtar të çështjes, nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme për dhënien e huas prej 2.000.000 lekë nga z. N. P. dhe 25.000 euro nga z. K. Gj..

iv) Për sa i takon deklarimeve kontradiktore dhe të pasakta të subjektit, gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me marrjen dhe kthimin e huave, subjekti deklaroi se: *“... nuk kemi pretenduar asnjëherë që kjo shumë është marrë në vitin 2009”*, ndërkohë që gjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësonit nr. 3, subjekti ka deklaruar se huat janë marrë dhe kthyer brenda vitit 2009.

v) Në lidhje me mosdeklarimin në asnjë prej DPV-ve të tri llogarive bankare në emër të bashkëshortit, në “Tirana Bank”, subjekti ka deklaruar: *“Llogaritë e bashkëshortit tim në lekë, dollarë dhe euro janë hapur vetëm për të bërë të mundur pajisjen me vizë për të shkuar në SHBA për problemin shëndetësor të vazhës sonë dhe të kurimit të mëtejshëm të saj. Gjithashtu, janë kryer edhe veprime për likuidimin e detyrimeve të firmës ‘N.’ ndaj firmës ‘E.’ dhe më*

*vonë 'B. P.'. Ato nuk janë deklaruar në DPV jo për arsye të fshehjes së tyre, por nuk ka pasur asnjë rezultat ekonomik-financiar që të ketë ndikuar në të ardhurat e familjes”.*

Në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se asnjë nga pretendimet e subjektit nuk justifikon mosdeklarimin e tri llogarive bankare, shtesave dhe pakësimeve të tyre, deklarime të cilat mungojnë të jenë kryer për një periudhë prej 6 vitesh nga çelja deri në momentin e mbylljes së tyre, në shkëlqje të detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i cili parashikon: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, si më poshtë: d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në çash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”. Për më tepër, deklarimi i subjektit se një ndër shkaqet e mosdeklarimit të këtyre tri llogarive bankare është dhe fakti se nëpërmjet tyre janë kryer edhe veprime për likuidimin e detyrimeve të shoqërisë “N..” sh.p.k. ndaj shoqërisë “E.” sh.p.k., dhe më vonë “B. P.” sh.p.k., ngre dyshimin se llogaritë e padeklaruara në “Tirana Bank” janë krijuar me të ardhura të përfituara nga z. A. P., si ortak i padekluar i shoqërisë “N.” sh.p.k.

Për të gjitha sa është aryetuar më sipër, si dhe referuar faktit se në të tria llogaritë rezultojnë të jenë kryer një numër i konsiderueshëm transaksionesh gjatë periudhës së rivlerësimit, Komisioni çmoi të konsiderojë mosdeklarimin e këtyre llogarive bankare, jo thjesht si një pasaktësi në deklarime, por edhe si fshehje pasurie, sipas parashikimit të gërmes “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003.

vi) Për sa i takon analizës financiare, balanca negative për vitin 2007, në shumën prej 3.552.843 lekësh, mbetet e pandryshuar për shkak të mosmarrjes në konsideratë të dy huave të padeklaruara dhe të pavërtetuara dhe në përfundim konkludohet se subjekti nuk justifikoi me të ardhura të ligjshme krijimin e shumës prej 41.650 USD, dërguar në SHBA në janar të vitit 2008, sipas gërmes “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003.

Të gjitha përfundimet e sipërpërmendura përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

**4.2** Në datën 18.1.2010, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. P., ka derdhur *cash* në llogarinë e tij me nr. \*\*\*, shumën prej 30.000 USD me përshkrimin “dhënë nga B. P.”. Në datën 9.2.2010, z. A. P. ka tërhequr *cash* shumën 28.000 USD.

Gjatë hetimit administrativ, pasi u pyet në lidhje me këto transaksione në përgjigjet e pyetësorit 2, subjekti sqaroi se: “... *kjo shumë që ka qenë e z. B. P. është marrë nga ana e bashkëshortit tim te shtëpia e prindërve të tij dhe është vendosur në llogarinë e tij për efekt garancie për t’u pajisur me vizë në Ambasadën Amerikane për të dhe për vajzën tonë. Nga kjo shumë, në datën 9.9.2010 (duhet të jetë gabim muaji, pasi kthimi është kryer në shkurt), është tërhequr dhe kthyer përsëri te prindërit 28.000 USD. Lidhur me pjesën e mbetur të pakthyer prej 2.000 USD, për shkak dhe kohës së largët, nuk më kujtohet se përse është mbajtur kjo shumë, por gjithsesi mund të them se ato janë marrëdhënie midis vëllezërish.”*

Bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të vërtetojë me dokumente shkresore të ardhurat e ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore të z. B. P., me qëllim vërtetimin e mundësisë së tij financiare për dhënien e shumës 30.000 USD. Duke qenë se përveç shumës prej 30.000 USD, në DPV-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar edhe një hua prej 5.000 USD, të dhënë nga personi i lidhur, z. B. P., (poshtëtrajtuar), Komisioni ka verifikuar mundësinë financiare të këtij huadhënësi, për dhënien në total të shumës prej 35.000 USD.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti vuri në dispozicion dokumentet shkresore: dokumentacionin e pagesës së taksave të vitit 2008 sipas formularit 1040, të Departamentit të Thesarit të Shërbimit të të ardhurave të brendshme, sipas të cilit vërtetohen të ardhura *neto* të z. B. P., në shumën 10.454 USD; dokumentacionin e pagesës së taksave të vitit 2009 sipas formularit 1120S, të Departamentit të Thesarit të Shërbimit të të ardhurave të brendshme, sipas të cilit vërtetohen të ardhura *neto* të z. B. P., në shumën 13.677 USD.

Në total, gjatë viteve 2008 dhe 2009, shtetasi B. P. ka realizuar të ardhura *neto* në shumën 24.131 USD, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, të cilat duket se janë të pamjaftueshme për dhënien e huas në shumën 5.000 USD, në vitin 2009 dhe shumën 30.000 USD më 18.1.2010 (total 35.000 USD). Veç kësaj, dokumentet e paraqitura nuk janë në formën e kërkuar nga ligji, të legalizuara me vulë apostile, ndërsa dokumenti i paraqitur për vitin 2008 nuk ishte depozituar i përkthyer dhe noterizuar.

Dokumentacioni i pagesës së taksave në USD/vitet	2008	2009	Total
<b>Të ardhurat bruto nga shitja</b>	<b>106.068</b>	<b>109.862</b>	<b>215.930</b>
Kompensimi i zyrtarëve (paga, sigurime, elementë të tjerë)		16.800	16.800
Punë me kontratë	5.937		5.937
Sigurime	1.040		1.040
Shërbimet ligjore dhe profesionale	300		300
Ushqime dhe shpenzime të zbritshme	7.114		7.114
Taksa dhe licenca	550	2.579	3.129
Zbritje të tjera	80.673	76.806	157.479
Zbritje totale	<b>95.614</b>	<b>96.185</b>	<b>191.799</b>
<b>Të ardhurat e zakonshme të biznesit B. P.</b>	<b>10.454</b>	<b>13.677</b>	<b>24.131</b>
<b>Shuma e dhënë hua nga B. P.</b>			<b>35.000 USD</b>

Lidhur me shumën 30.000 USD, në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i kaloi barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me konstatimet, duket se:

- i) Nuk u vërtetua me dokumente shkresore burimi i ligjshëm i të ardhurave të shtetasit B. P. sipas pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, për dhënien e shumës prej 30.000 USD.
- ii) Nuk është vërtetuar dorëzimi në rrugë bankare ose jo i kësaj shume nga personi i lidhur, z. B. P., te bashkëshorti subjektit të rivlerësimit, z. A. P., dhe po kështu nuk vërtetohet me dokumente shkresorë kthimi i kësaj shume prej këtij të fundit te vëllai i tij B. P..



iii) Veprimet në lidhje me derdhjen dhe tërheqjen e shumës prej 30.000 USD, pretenduar të dhënë dhe të kthyer z. B. P., janë kryer nëpërmjet llogarisë bankare me nr. \*\*\*, në “Tirana Bank”, në emër të bashkëshortit të subjektit, llogari e cila nuk është deklaruar në asnjë prej DPV-ve nga subjekti i rivlerësimit.

Në parashtrimet e saj, subjekti ka rikonfirmuar që shuma prej 30.000 USD është vendosur në llogarinë e bashkëshortit për t’u pajisur me vizë në SHBA dhe është kthyer brenda vitit përkatës duke vënë në dispozicion deklarin e të ardhurave të z. B. P., për vitet 2006 dhe 2007. Nga këto dokumente rezulton se z. B. P. ka një biznes “V. T. I”, që ofron shërbime transporti. Fitimet *neto* të aktivitetit të tij privat për vitin 2006 janë 19.954 USD dhe për vitin 2007 janë 8.713 USD. Ndërkohë, gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti kishte vënë në dispozicion dokumente që vërtetonin të ardhura të personit tjetër të lidhur, z. B. P., për vitet 2008 dhe 2009, përkatësisht, në total në vlerat 10.454 USD dhe 13.677 USD.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti, konstatohet se të ardhurat e gjeneruara nga biznesi i personit tjetër të lidhur, z. B. P., gjatë viteve 2006 – 2009 në total 52.798 USD janë *neto* dhe janë të lira për t’u përdorur dhe/ose për të dhënë hua. Në zërin shpenzime të biznesit pasqyrohen paga, pagesa tatimesh dhe sigurimesh ndaj shtetit. Kështu, shpenzimet e jetesës së z. B. P. janë konsideruar që mbulohen nga paga e tij. Për sa i takon legalizimit me vulë apostile të dokumenteve që vërtetojnë të ardhurat e z. B. P., gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti nuk i paraqiti këto dokumente të legalizuara në formën e kërkuar nga ligji, por duke qenë se këto dokumente janë printime nga sistemi *online* i zyrës së tatimeve të SHBA-së, Komisioni çmoi t’i konsiderojë si prova shkresore me vlerë ligjore<sup>35</sup>.

Bazuar në provat e administruara, por edhe në kushtet e vështirësisë për të vërtetuar pasuri të tjera të personit të lidhur, detyrime financiare të tij, të ardhura të tjera përveç atyre të vërtetuara nga subjekti, si dhe shpenzime të tjera përveç atyre të jetesës, për shkak se personi tjetër i lidhur, z. B. P., u vërtetua që banon prej kohësh në SHBA, gjatë procesit të vendimmarrjes, Komisioni, nuk mundi të arrijë në konkluzionin që shtetasi B. P. nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e shumës 30.000 USD, në datën 18.1.2010. Por, pavarësisht kësaj, subjekti nuk vërtetoi që shuma prej 30.000 USD, depozituar *cash* në datën 18.1.2010 nga bashkëshorti i saj në “Tirana Bank”, i ishte dhënë këtij të fundit nga personi tjetër i lidhur, z. B. P. dhe as faktin që shuma prej 28.000 USD, tërhequr *cash* në datën 9.2.2010, i është kthyer sërish z. B. P.. Për më tepër depozitimi i kësaj shume është kryer në një llogari bankare të padeklaruar nga subjekti në asnjë prej DPV-ve.

Këto rrethana e vënë subjektin e rivlerësimit në kushtet e pasaktësisë dhe pamjaftueshmërisë në deklarime, të cilat kanë vështirësuar punën e Komisionit për një vlerësim të qartë e përfundimtar në lidhje me dy transaksionet e kryera nga bashkëshorti A. P. në vitin 2010, përkatësisht në datat 18.1.2010 dhe 9.2.2010. Gjithsesi, shuma prej 30.000 euro nuk e ka afektuar analizën financiare për vitin 2010, duke marrë të mirëqenë pretendimin e subjektit që ajo i është marrë dhe kthyer B. P.t brenda vitit 2010. Në lidhje me diferencën prej 2.000 euro,

<sup>35</sup> Në datën 6.20.2020, pas procesit të vendimmarrjes, subjekti ka përcjellë në rrugë elektronike dy dokumente të skanuara që pasqyrojnë vulë apostile të datës 28.9.2020, të papërkthyer në gjuhën shqip. Në këto dokumente nuk përcaktohet se cilat janë dokumentet që legalizohen.

subjekti nuk dha një shpjegim të qartë se përse është mbajtur kjo shumë, duke deklaruar se është për shkak të marrëdhënieve midis dy vëllezërve.

5. Sipas dokumentacionit të administruar nga “Tirana Bank”<sup>36</sup>, ka rezultuar se në datën 26.6.2007 është bërë pagesa prej 200.000 lekësh nga z. A. P. në “Tirana Bank” me pershkrimin “pagesë tatim-fitimi për muajin qershor nga shoqëria ‘A.S.’ sh.p.k.” Subjekti, pasi u pyet mbi arsyet e kësaj pagese dhe për marrëdhënien e bashkëshortit të saj me këtë shoqëri, në përgjigje të pyetësorit 2 ka sqaruar se: “ ... pagesa nga llogaria e bashkëshortit tim në ‘Tirana Bank’ për shoqërinë ‘A.S.’ sh.p.k. në datën 26.6.2007, në shumën 200.000 lekë, është tatim-fitimi në muajin qershor 2007. Bashkëshorti im punon në organin tatimor dhe për efekt të realizimit të planit tatimor nga çdo inspektor është kryer kjo pagesë. Është komunikuar me administratorin e firmës me telefon, i cili për momentin nuk ndodhej në Përmet dhe s’kishte mundësi pagese.”

Gjatë procesit të rivlerësimit, subjektit iu kërkua të vërtetojë me dokumente shkresore pagesën dhe formularin e tatim-fitimit të shoqërisë “A.S.”sh.p.k., si dhe kthimin e shumës 200.000 lekë nga shoqëria te bashkëshorti i saj. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se: “... për vitin (2007) kur është kryer veprimi bankar sipas procedurës apo praktikës së asaj kohe, nuk ka pasur formularë deklarimi të tatimit mbi fitimin dhe në këto rrethana nuk mund të vërtetoj për sa kërkoni, ndërkohë që edhe nga kontrolli i dosjeve që i përkasin vitit 2007, nga sektori i financës së firmës ‘A.S.’ nuk është gjetur ndonjë dokument, që lidhet me pagesën prej 200.000 lekësh nga bashkëshorti im, si nëpunës i tatimeve, pasi sipas financieres, në atë kohë, njoftimet jepeshin edhe dorazi, lidhur me pagesat e kësteve apo të tatimit mbi fitimin. Ndërsa lidhur me kthimin e shumës prej 200.000 lekë, të paguar nga llogaria e bashkëshortit tim për llogari të firmës ‘A.S.’, sqaroj se kjo shumë i është kthyer bashkëshortit tim dorazi, vërtetuar kjo edhe me deklaratën e administratorit të firmës ‘A.S.’, z. A. Ç..”

Bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, subjekti ka vënë në dispozicion: (1) një deklaratë të thjeshtë pa datë të shtetasit A. Ç., administrator i shoqërisë “A.S.”sh.p.k., e cila konfirmon deklaratimet e subjektit; dhe (2) nxjerrje llogarie nga “Tirana Bank”.

Në përfundim të hetimit administrativ, pretendimet e subjektit nuk u vërtetuan me dokumente shkresore në kohë reale dhe, si rrjedhim, shuma prej 200.000 lekësh është konsideruar si shpenzim i subjektit gjatë analizës financiare për vitin 2007, vit i cili rezulton me një balancë negative prej 3.552.843 lekësh.

Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën. Në parashtrimet e saj, vërehet se subjekti ka dhënë të njëjtat sqarime si ato gjatë procesit të rivlerësimit, duke konfirmuar që pagesa prej 200.000 lekësh, nga llogaria e bashkëshortit te shoqëria “A.S.” sh.p.k. është për tatim-fitimi të shoqërisë për vitin 2007, e cila është bërë nga bashkëshorti i saj për shkak të punës si inspektor në tatime. Subjekti ka deklaruar se nuk ka mundur të gjejë dokumente që provojnë sa më sipër. Në përfundim të procesit, subjekti nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës dhe, për rrjedhojë, analiza financiare për vitin 2007 kur është kryer pagesa, nuk ka pësuar ndryshime.

<sup>36</sup>Shihni shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, nga “Tirana Bank”, në dosjen e Komisionit.

**6.** Sipas dokumentacionit bankar të “Raiffeisen Bank” dhe “Tirana Bank”, subjekti dhe bashkëshorti kanë kryer pagesa për blerje karburanti në llogari të shoqërisë “E. E” sh.p.k., në shumat si vijojnë:

- në datën 31.10.2011, subjekti ka paguar *cash* shumën prej 500.000 lekësh, në “Raiffeisen Bank”;
- në datën 2.6.2008, bashkëshorti i subjektit ka paguar *cash* shumën prej 174.000 lekësh, në “Tirana Bank”;
- në datën 2.6.2008, bashkëshorti i subjektit ka paguar *cash* shumën prej 143.000 lekësh në “Tirana Bank” me përshkrimin “nga N. për E. P.”;
- në datën 2.6.2008, bashkëshorti i subjektit ka paguar *cash* shumën prej 521.713 lekësh në “Tirana Bank”.

Subjekti, pasi u pyet në lidhje me këto pagesa, si dhe për shkaqet e tyre në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sqarosi se: “... *shuma prej 500.000 lekësh në datën 31.10.2011 në ‘Raiffeisen Bank’ nga llogaria ime është derdhur për llogari të shitjes së karburantit nga ‘N.’ sh.p.k. me administrator z. N. P., vëllain e bashkëshortit tim për llogari të ‘E. P.’ sh.p.k. Shuma prej 174.000 dhe 143.000 në vitin 2008 në ‘Tirana Bank’ janë derdhur në llogarinë e bashkëshortit nga ‘C.’ sh.p.k., e cila furnizohej me karburant pranë ‘E. P.’ sh.p.k. Këto janë pagesa për shlyerje karburanti, për llogari të ‘N.’ sh.p.k. Këto veprime janë kryer nga llogaria e bashkëshortit tim në pamundësi të kryerjes nga llogaria e shoqërisë ‘N.’ sh.p.k. për mungesë fondesh, për mungesë të qenies së z. N. P. ose për ndonjë arsye që lidhet me rregullat dhe administrimin e bankave. Po kështu, edhe shuma prej 521.713 lekësh është pagesë që rrjedh nga shitja e karburantit për llogari të shoqërisë ‘N.’ sh.p.k. dhe jo për pagesa të tjera. Bashkëngjitur dokumentacioni justifikues*”. Ndërkohë, subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion justifikues.

Gjatë procesit të rivlerësimit, subjektit iu kërkua të vërtetojë pretendimet me dokumente shkresore si, faturat tatimore të shitjes apo mandatpagesat përkatëse që vërtetojnë likuidimin e këtyre faturave për blerjen e karburantit në shumat e mësipërme. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka dhënë vetëm shpjegime për pamundësinë e paraqitjes së dokumenteve të sipërpërmendura. Për këtë arsye, në përfundim të hetimit administrativ, gjatë analizës financiare shumat e mësipërme, në total prej 1.338.713 lekësh, janë konsideruar si shpenzime të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit gjatë viteve përkatëse 2008 dhe 2011, ku për vitin 2008 duket se ka rezultuar me balancë pozitive, ndërsa për vitin 2011 me balancë negative prej - 3.742.978 lekësh.

Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën. Në parashtrimet e saj, subjekti nuk ka dhënë sqarime në lidhje me këtë barrë prove. Në këto kushte, rezultati i konstatuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe analiza financiare për vitin 2011, mbeten të pandryshuara në përfundim të procesit të rivlerësimit, me përjashtim të zvogëlimit të balancës negative për shkak të përfshirjes së bonuseve të karburantit, përfituar gjatë këtij viti, të cilat u përfshinë si e ardhur ligjore.

**9.** Në DPV-në e vitit 2011 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar shumën *cash* 600.000 lekë nga paga dhe nga llotaria sportive. Subjektit, pasi iu kërkuan të dhëna se sa janë të ardhurat e

përfituara nga paga dhe sa nga llotaria sportive, si dhe të vërtetojë me dokumentacion këto të fundit, në përgjigje të pyetësorit 2, subjekti sqaroi se: *“Shuma e përfiturar nga bashkëshorti im nga llotaria sportive për vitin 2011 nuk mund të saktësohet për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe kohës relativisht të gjatë që ka kaluar. Dokumentacioni i llotarisë sportive nuk ekziston pasi dorëzohej skedina”*.

Si rrjedhim, gjatë hetimit administrativ është verifikuar mundësia financiare e bashkëshortëve Pani për krijimin e shumës *cash* prej 600.000 lekësh në fund të vitit 2011, dhe nga analiza financiare e këtij viti, duket se nuk kanë pasur mundësi ta krijojnë, pasi ky vit rezulton me një balancë negative prej -3.742.978 lekësh. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi. Në parashtrimet e saj, subjekti nuk ka dhënë sqarime në lidhje me këtë barrë prove. Në këto kushte, rezultati i konstatuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe analiza financiare për vitin 2011 ndryshoi nga -3.742.978 lekë në -3.497.978 lekë, vetëm për shkak të marrjes në konsideratë të bonusit të karburantit.

**10.** Në deklarinimin e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: *“... depozitim në llogarinë personale të bashkëshortit si kthim i borxhit të vjetër të padeklaruar në shumën 850.000 lekë”*.

Gjatë hetimit administrativ u konstatua se ky deklarinim përputhet me informacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”<sup>37</sup> sipas të cilit shtetasja M. Dh. ka depozituar në llogari të bashkëshortit të subjektit, z. A. P., më 7.8.2012 shumën 300.000 lekë dhe më 31.8.2012 shumën 550.000 lekë, pra, në total 850.000 lekë, me përshkrimin “derdhje nga M. Dh”.

Subjektit, iu kërkua të vërtetonte marrëdhënien e huas dhe periudhën e dhënies së saj, marrëdhënien me shtetasen M. Dh., si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer si burim për dhënien e huas nga bashkëshorti i saj, duke i vërtetuar këto fakte me dokumente shkresore, e në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se: *“... në vitin 1995, bashkëshorti im i ka dhënë hua në shumën 2.000.000 dhrahmi, shokut të tij, z. G. Ll. me banim në Përmet. Ky borxh u rikthye në vitin 2012 nga motra e tij e martuar në Vlorë, znj. M. Th. (Ll.). Burimi i kësaj shume: bashkëshorti im ka qenë i punësuar në Parkun e Mallrave Përmet me detyrë kryetar i degës së financës prej dhjetorit 1990 deri në maj të vitit 1993. Më pas ka emigruar në Greqi ku ka punuar për disa vite me pagesë 10.000 dhrahmi në ditë”*. Subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.5.2020, të znj. M. Th., me anë të së cilës konfirmohet dhënia e huas, ndërsa nuk ka vënë në dispozicion dokumente që vërtetojnë të ardhura të pretenduara të bashkëshortit.

Në kushtet kur subjekti nuk ka vërtetuar me një dokument shkresor në kohë reale dhënien e huas në shumën 850.000 lekë dhe në kushtet kur subjekti nuk ka deklaruar asnjë vlerë likuiditeti në lekë si huadhënie dhe asnjë detyrim financiar për shkak të saj, sipas parashikimit të germës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, që nga viti 2003 deri në vitin 2012, shuma prej 850.000 lekësh nuk është përfshirë në analizën financiare si e ardhur ligjore për vitin 2012, rrethanë që në fakt nuk e afekton analizën financiare për këtë vit, pasi rezulton të jetë me balancë pozitive.

<sup>37</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, nga “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

Gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk evidentoi konflikt të interesit të subjektit me shtetasit M. Th.. (Ll) dhe G. Ll., ashtu sikurse nuk u evidentua përfshirja e tyre në veprimtari të krimit të organizuar<sup>38</sup>.

Në përfundim të hetimit administrativ, me njohjen e rezultateve të hetimit, Komisioni evidentoi: (i) pasaktësi në deklarinimin para fillimit të detyrës për vitin 2003 dhe në DPV-të deri në vitin 2012; dhe (ii) mospërfshirjen si të ardhur të ligjshme të shumës 850.000 lekë në analizën financiare për vitin 2012. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera në lidhje me këto konstatime.

Në parashtrimet e saj, subjekti ka pretenduar se shuma prej 850.000 lekësh duhet të përfshihej në analizën financiare, pasi është kthyer nëpërmjet sistemit bankar, por nuk ka dhënë asnjë sqarim sa i takon mosdeklarimit të detyrimit financiar për shkak të këtij borxhi për periudhën 2003 – 2012.

Komisioni, në përfundim të procesit, vlerësoi se subjekti nuk vërtetoi në mënyrë bindëse dhe me dokumente shkresore që shuma prej 850.000 lekësh derdhur në llogari të bashkëshortit në vitin 2012, ka qenë për shkak të një borxhi të pashlyer, pasi: (i) subjekti nuk vërtetoi marrëdhënien e huas me një dokument shkresor të lidhur në kohë reale; (ii) në DPV-të për periudhën 2003 – 2012, subjekti nuk ka deklaruar detyrime financiare për shkak të një huaje të pashlyer, sipas parashikimit të germës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, Për këto arsye, Komisioni çmoi t’i konsiderojë DPV-të për periudhën 2003 – 2012, jo vetëm të pasakta, por edhe të pamjaftueshme.

**11.** Në DPV-të për vitin 2013 është deklaruar: “... borxh i vjetër i padeklaruar, derdhur në llogarinë bankare ‘Tirana Bank’, shuma 3.496.28 USD”.

Gjatë hetimit administrativ, nga informacioni i marrë nga “Tirana Bank”, rezultoi se në llogarinë e bashkëshortit të subjektit është derdhur shuma prej 5.000 USD, datë 11.11.2013, me përshkrimin “likuidim detyrimi nga E. M.”.

Subjekti, pasi u pyet në lidhje me këtë hua, si dhe mbi mospërputhjen e shumave, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sqaroi se: “... E. M. është shoku i ngushtë i bashkëshortit tim dhe mik i familjes. Para vitit 2003, ai i detyrohej bashkëshortit tim një shumë prej 400.000 lekësh. Burimi i këtyre të ardhurave është puna në PAM Përmet dhe emigracioni. Nga shuma e rikthyer në vitin 2013 në formën e 5.000 USD, 1.500 USD ( të cilat u konvertuan në lekë me kurs këmbimi preferencial ) iu kthyen z. E. M., ndërsa shuma e mbetur prej 3.496.28 USD (3.72 USD komision) u konsiderua si shtesë dhe u deklarua në fund të vitit 2013”.

Subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumente që vërtetojnë pretendimet si më sipër. Po kështu, është e paqartë përse z. E. M. i ka kthyer shumën prej 5.000 USD dhe jo 400.000 lekë sa ishte huaja e pretenduar nga subjekti. Për më tepër, nga verifikimi i deklaratës për vitin 2003 dhe deklaratave në vijim deri në vitin 2013, u konstatua se subjekti nuk ka deklaruar asnjë vlerë likuiditeti në lekë si huadhënie dhe asnjë detyrim financiar sipas parashikimit të germës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar. Për këto arsye, shuma

---

<sup>38</sup> Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2020, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit dhe shkresë kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2020, nga Prokuroria Përmet, në dosjen e Komisionit.

5.000 euro nuk është përfshirë në analizën financiare si e ardhur ligjore për vitin 2013, vit i cili në fakt rezulton me balancë pozitive të fondeve.

Gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk evidentoi konflikt të interesit të subjektit me shtetasin E. M., ashtu sikurse nuk u evidentua përfshirja e tij në vperimtari të krimit të organizuar<sup>39</sup>.

Në përfundim të hetimit administrativ, me njohjen e rezultateve të hetimit, Komisioni evidentoi: (i) pasaktësi në deklarinimin para fillimit të detyres për vitin 2003 dhe në DPV-të deri në vitin 2013; dhe (ii) mospërfshirjen si të ardhur të ligjshme të shumës prej 3.496.28 USD në analizën financiare për vitin 2013. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera në lidhje me këto konstatime.

Në parashtrimet e saj, subjekti ka pretenduar se shuma prej 3.496.28 USD duhet të përfshihej në analizën financiare pasi është kthyer nëpërmjet sistemit bankar. Ky pretendim i subjektit nuk mjafton për të vërtetuar këtë shumë si hua të pashlyer deri në vitin 2013, pasi subjekti nga njëra anë nuk ka vërtetuar me dokument shkresor në kohë reale marrëdhënien e huas dhe nga ana tjetër, nuk ka dhënë asnjë deklarinim sipas ligjit të detyrimit financiar për shkak të huas për periudhën 2003 – 2013, konstatim për të cilin në parashtrimet e saj nuk ka dhënë asnjë shpjegim. Në përfundim të procesit, Komisioni çmoi t'i konsiderojë DPV-të për periudhën 2003 – 2013, jo vetëm të pasakta, por edhe të pamjaftueshme.

**12.** Në DPV-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar: *“5.000 USD hua nga vëllai”*.

Gjatë hetimit administrativ u konstatua se në datën 9.2.2010, bashkëshorti i subjektit, z. A. P., ka kryer transfertën prej 5.000 USD, nëpërmjet “Tirana Bank” në llogari të vëllait të tij, z. B. P., me pershkrimin “kthim detyrimi”, por pa pershkruar llojin e detyrimit dhe periudhën e lindjes se ketij detyrimi, si dhe pa deklaruar në DPV-në e vitit 2010 shlyerjen e detyrimit apo pakësimin e likuiditetit. Subjekti, pasi u pyet se çfarë përfaqësonte kjo shumë, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka sqaruar se: *“... shuma prej 5.000 USD është dhënë nga vëllai i bashkëshortit B. P. për problemet e mëtejshme që mund të kishte vajza jonë E. P. me trajtimet e mëtejshme pas operacionit”*.

Lidhur me mundësinë financiare të personit të lidhur, z. B. P., për dhënien e huas prej 5.000 USD, Komisioni ka kryer përlllogaritjet bazuar në dokumentet që subjekti ka vënë në dispozicion për vitet 2008 dhe 2009, duke përfshirë edhe huan prej 30.000 USD, dhënë më 18.1.2010 (trajtuar në pikën 4.2 rubrika “Konstatime të tjera”), nga ku në përfundim të hetimeve paraprake, dukej se shtetasi B. P. nuk ka pasur mundësi për dhënien në total të shumës 35.000 USD bashkëshortit të subjektit (shihni tabelën në faqet 40-41).

Për sa i takon mundësisë financiare të bashkëshortit të subjektit për kthimin e huas në shumën 5.000 USD deri në datën 9.2.2010, nga analiza financiare si në tabelën më poshtë, duket që bashkëshortët Pani nuk kanë pasur mundësi për shlyerjen e huas me të ardhura të ligjshme, për shkak të një balance negative prej 502.280 lekësh.

---

<sup>39</sup> Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2020, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit dhe shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2020, nga Prokuroria Përmet, në dosjen e Komisionit.

	<b>Përshkrimi</b>	deri 9.2.2010
<b>1</b>	<b>Pasuri</b>	<b>208 794</b>
	<i>SHTESA/PAKËSIMË LIKUIDITETE</i>	208 794
<b>2</b>	<b>Të ardhura</b>	<b>293 515</b>
	Të ardhura nga pagat subjekti	167 561
	Të ardhura nga pagat bashkëshorti	125 954
<b>3</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>587 001</b>
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	45 540
	Shpenzime qiraje sipas pyetësorit standard	10 000
	Shpenzime nga llogaria e A. P. nga "Tirana Bank"	524 750
	Shpenzime udhëtimi	6 711
	<b>Mundësia për kursime (2-1-3)</b>	<b>-502 280</b>

Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me huan në shumën 5.000 USD, të deklaruar në vitin 2009, marrë nga personi i lidhur, z. B. P., subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve, si vijon:

- i) nuk vërtetohet me dokument shkresor dhënia e huas nga z. B. P., në vitin 2009 dhe as kalimi i shumës në rrugë bankare prej tij;
- ii) nuk vërtetohen të ardhura të ligjshme të personit të lidhur, z. B. P., që kanë shërbyer si burim për dhënien e huas;
- iii) subjekti nuk ka deklaruar shlyerjen e huas në vitin 2010 (si rrjedhojë as burimin që ka shërbyer për shlyerjen) sipas detyrimit të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar;
- iv) subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për shlyerjen e kësaj huaje;
- v) për këto arsye, huaja prej 5.000 USD nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën financiare për vitin 2009, e cila rezulton me një balancë negative prej 359.632 lekësh.

Në lidhje me këto konstatime, në parashtrimet e saj, subjekti ka sqaruar në mënyrë koncize se: *"... sipas edhe sqarimeve në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, kjo shumë është nga vëllai i bashkëshortit, z. B. P., për problemet e mëtejshme që mund të kishte vajza jonë, për trajtimin pas operacionit, shumë kjo e panjohur dhe e pallogaritur në analizën financiare të vitit 2009, për shkak të pamundësisë financiare të z. B. P., ndërkohë që z. B. P. jeton dhe punon në SHBA, qysh prej vitit 1996."*

Bashkëngjitur me parashtrimet, subjekti ka depozituar dokumente shkresore që vërtetojnë të ardhura të personit tjetër të lidhur, z. B. P., për vitet 2006 dhe 2007, ndërkohë që gjatë procesit të rivlerësimit kishte paraqitur dokumente që vërtetonin të ardhura për vitet 2008 – 2009. Bazuar në dokumentet shkresore të administruara, pavarësisht se nuk kanë qenë të legalizuara në formën e ligjit, Komisioni mori të mirëqenë faktin se në total, të ardhurat *neto* të personit tjetër të lidhur për të katër vitet, kanë qenë në shumën 52.798 USD.

Referuar kësaj shume, Komisioni nuk mund të arrijë në konkluzionin se personi tjetër i lidhur, z. B. P., nuk ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar dhënien e huas prej 5.000 USD, në vitin 2009 (dhe 30.000 USD në janar të vitit 2010). Por, ky fakt si dhe deklarimi i subjektit në DPV-në e vitit 2009 *"5.000 USD borxhe nga vëllai"*, nuk mjaftuan që Komisioni





DPV-në për vitin 2011 kompensime funksioni) dhe, për rrjedhojë, analiza financiare ndryshoi respektivisht: (i) për vitin 2011, nga -3.742.978 lekë bëhet -3.497.978 lekë; (ii) për vitin 2012, nga +2.494.331 lekë bëhet +2.914.331 lekë; dhe (iii) për vitin 2013 nga +1.005.501 lekë bëhet +1.425.501 lekë.

### **Në lidhje me shpenzimet për operacionin dhe kurimin e vajzës së subjektit të rivlerësimit**

Gjatë hetimit administrativ u vërtetua se bashkëshorti i subjektit, z. A. P., në datën 14.1.2008 i ka dërguar shumën 41.650 USD motrës së subjektit, znj. L. Xh., në rrugë bankare nëpërmjet “Tirana Bank”, me qëllim për të përballuar shpenzimet e operacionit të vajzës E. P., që sipas deklarimeve në përgjigjet e pyetësorit standard është kryer në shkurt të vitit 2008 (shoqëria e sigurimeve konfirmon që shërbimet shëndetësore për E. P. janë kryer në datën 22.2.2008). Kjo shumë i është kthyer përsëri z. A. P. në të njëjtën llogari, në datën 22.4.2008, me pretendimin se këto shpenzime janë financuar nga znj. L. Xh., me banim në SHBA.

Në DPV-në e vitit 2008 dhe në asnjë prej DPV-ve, përfshirë edhe deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar asnjë fakt në lidhje me shpenzimet për operacionin e vajzës në SHBA apo edhe për kurimin e saj, si dhe as pakësim të gjendjes *cash* ose në bankë për shkak të këtyre shpenzimeve. Ndërsa në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: “... në muajin shkurt të vitit 2008, kemi kryer operacionin implant coclear të vajzës sonë E. P. në vlerën 42.000 USD, të paguara nga Kompania e Sigurimit të motrës sime L. Xh.”.

Bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të vërtetojë me dokumente shkresore të legalizuara sipas legjislacionit në fuqi, burimin e ligjshëm të shumës prej 42.000 USD, shpenzimet konkrete për kurimin dhe operacionin e vajzës, si dhe të deklarojë shkakun e mosdeklarimit të tyre në DPV-në e vitit 2008.

Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, konfirmoi se në vitin 2008 ka kryer operacionin e vajzës E. P. në SHBA, ndërsa, në lidhje me shpenzimet për operacionin dhe kurimin, ka deklaruar se nuk janë kryer prej saj dhe prandaj nuk janë deklaruar, por në dijeninë e saj kanë qenë në shumën 42.000 USD.

Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit dhe gjithë dokumenteve që ka vënë në dispozicion, rezultoi se:

- Sipas vërtetimit të datës 18.10.2007, i pa perkthyer dhe noterizuar, lëshuar nga Gjykata e Provës, Rrethi Hartford, shteti Connecticut, USA, i jepet znj. L. Xh. kujdestaria e përkohëshme mbi E. P. nga data 19.11.2007 për një periudhë 6-mujore.

- Sipas vërtetimit të datës 3.4.2008, i papërkthyer dhe noterizuar lëshuar nga Gjykata e Provës, Rrethi Hartford, shteti Connecticut, SHBA, i jepet znj. L. Xh. kujdestaria mbi E. P. nga data 3.4.2008 për një periudhë 1-vjeçare. Bashkëlidhur me këtë vërtetim, është vendimi me dy faqe i gjykatës, nëpërmjet të cilit vërtetohet se prindërit e E. hiqen si kujdestarë dhe kjo e drejtë i jepet znj. L. Xh.

- Deklarata e znj. L. Xh., datë 15.5.2020, pasqyron deklarimin sipas të cilit, motra e saj znj. Silvana Pani, datë 30.9.2007 ka udhëtuar për në SHBA, për kryerjen e operacionit të vajzës së saj E. P. dhe gjatë gjithë periudhës së qëndrimit të familjes Pani në SHBA, kanë banuar në shtëpinë e saj dhe se të gjitha shpenzimet lidhur me qëndrimin e familjes së motrës janë

përballuar me të ardhurat e saj, duke qënë se ajo jeton dhe punon në SHBA së bashku me familjen që prej vitit 1996. Për këtë arsye, shpenzimet e familjes Pani, gjatë qëndrimit në SHBA, janë llogaritur sipas standardit të shpenzimeve të qëndrimit të të afërm.

- Dokumenti kthim-përgjigje datë 27.7.2020, i dërguar nga shoqëria “A.B. C and B. Sh.”<sup>[1]</sup> i përkthyer dhe i noterizuar, verteton se E. P. është përfituese e planit të shëndetit, nga data 1.1.2008 deri më 5.1.2020.

- Dokumenti “pretendimet e pagueshme për furnizuesit tuaj - spitali” datë 20.11.2008<sup>[2]</sup>, i përkthyer dhe noterizuar, lëshuar nga shoqëria e sigurimit “A. B. C. and B. Sh.” për znj. L. Xh., vërteton pagesën e shumës 49.144.40 USD, direkt spitalit ku është trajtuar pacientja E. P. Në këtë dokument janë të pasqyruara dy shuma: 61.620.92 USD si detyrime totale dhe shuma 49.144.4 USD si detyrim i faturuar për t’u paguar. Sipas këtij dokumenti, shuma e paguar është 49.144.4 USD, ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se: “... në dijeninë time ato kanë qenë 42.000 USD”, por, sipas dokumentit të mësipërm të kompanisë ‘A.’ ato janë në total 61.620 USD, ku operacioni coclear implant ka kushtuar 49.144 USD dhe 12.467 shpenzimet të tjera”.

Të gjitha dokumentet i janë kërkuar subjektit të legalizuara me vulë apostile si gjatë procesit të rivlerësimit ashtu edhe me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ. Në parashtrimet e saj, subjekti nuk i vuri në dispozicion dokumentet sipas kësaj kërkesë. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti deklaroi se e dispononte legalizimin me vulë apostile, të cilin iu kërkua ta vinte në dispozicion menjëherë pas seancës dëgjimore. Subjekti ka vënë në dispozicion në rrugë elektronike në datën 6.10.2020, pra, 5 ditë pas seancës dëgjimore, zhvilluar në datën 1.10.2020 dhe pasi ishte kryer procesi i vendimmarrjes, datë 1.10.2020, dy dokumente të skanuara që pasqyrojnë vulë apostile të datës 28.9.2020, akte të papërkthyer dhe që nuk vërtetojnë se cilat janë dokumentet konkrete të legalizuara me këto vula. Këto dokumente do të vihen në dispozicion të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Në përfundim të procesit, pavarësisht se dokumentet e paraqitura për të vërtetuar shpenzime të operacionit dhe të kurimit të vajzës E. P. në SHBA nuk u paraqitën në formën e kërkuar nga ligji, pasi pjesërisht kanë qenë të papërkthyer dhe të panoterizuara dhe të gjitha ishin të pavërtetuara me vulë apostile, referuar përmbajtjes së tyre, deklarimeve të subjektit, si dhe fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni i vlerësoi ato bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe çmoi se të gjitha shpenzimet për operacionin dhe kurimin e vajzës, janë mbuluar nga motra e subjektit, znj. L. Xh.

Në rezultatet e hetimit dërguar subjektit, shuma prej 41.650 USD/ 3.788.484 lekë, transferuar në SH.B.A në datën 18.1.2008, ishte përfshirë në analizën financiare të vitit 2008 si shpenzim i subjektit të rivlerësimit, vit i cili kishte rezultuar me një balancë pozitive prej +788.758 lekësh. Pasi kjo shumë u vendos nga Komisioni që të mos konsiderohet si shpenzim i subjektit, nëse i shtohet balancës pozitive për vitin 2008, kjo balancë shkonte në vlerën + 4.577. 242 lekë. Por, në kushtet kur gjatë procesit të rivlerësimit nuk u vërtetua që shuma prej 41.650 USD, transferuar në SHBA në datën 18.1.2008 prej bashkëshortit të subjektit, të ishte justifikuar me të ardhura të ligjshme, është logjike që kjo shumë e kthyer sërish në llogari të

<sup>[1]</sup> Shihni dokumentin e dërguar me postë elektronike nga subjekti në datën 24.8.2020, në dosjen e Komisionit.

<sup>[2]</sup> Është e paqartë nëse kjo është data e printimit apo e gjenerimit të dokumentit.

bashkëshortit në datën 22.4.2008, është e pajustificuar nga burime të ligjshme. Për më tepër, llogaria bankare në “Tirana Bank”, ku janë kryer transaksionet për dërgimin dhe kthimin e kësaj shume, si dhe shtesat dhe pakësimet e kësaj llogarie, nuk janë deklaruar asnjëherë nga subjekti i rivlerësimit apo bashkëshorti, sipas detyrimit të gërmës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, i ndryshuar. Në këto rrethana, shuma prej 41.650 USD, nuk duhet të përfshihet si e ardhur ligjore në analizën përfundimtare financiare për vitin 2008, vit i cili nuk afektohet duke mbetur me një balancë pozitive në shumën prej 788.758 lekësh.

### **Analizë financiare**

Në përfundim të hetimeve kryesisht, Komisioni ka kryer analizë financiare për të gjithë periudhën e vlerësimit 2003 – 2016, përmbledhur në mënyrë të shkurtuar në tabelën më poshtë, e cila mund të ndryshonte në varësi të provave dhe dokumenteve që subjekti do të vinte në dispozicion në ushtrim të barrës së provës:

	1	2	3	4	5	6
<b>Përshkrimi</b>	<b>Pasuri</b>	<b>Detyrime</b>	<b>Pasuri neto (1-2)</b>	<b>Të ardhura</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>Mundësi a për kursime (4-3-5)</b>
<b>deri 2003</b>	2.000.000	0	2.000.000	4.182.955	1.886.691	296.264
<b>2004</b>	400.000	0	400.000	1.490.075	411.856	678.219
<b>2005</b>	1.013.702	0	1.013.702	1.671.130	474.228	183.200
<b>2006</b>	1.672.415	0	1.672.415	1.826.055	474.228	-320.588
<b>2007</b>	5.241.458	0	5.241.458	2.672.262	983.647	-
<b>2008</b>	-4.596.507	0	-4.596.507	1.362.795	5.170.544	788.758
<b>2009</b>	1.572.094	0	1.572.094	1.916.470	704.008	-359.632
<b>2010</b>	1.572.885	0	1.572.885	2.190.211	1.431.337	-814.011
<b>2011</b>	5.121.537	0	5.121.537	2.472.647	1.094.089	-
<b>2012</b>	-866.387	0	-866.387	2.369.648	741.704	2.494.331
<b>2013</b>	106.458	0	106.458	1.885.519	773.560	1.005.501
<b>2014</b>	270.486	0	270.486	2.319.677	1.709.794	339.397
<b>2015</b>	-836.722	0	-836.722	2.132.107	6.016.551	-
<b>2016</b>	-1.109.413	0	-1.109.413	2.379.674	2.770.192	718.895

Sipas rezultateve të hetimit, totali i balancës negative për të gjithë periudhën e rivlerësimit ishte në vlerën -11.837.775 lekë.

Në lidhje me analizën financiare, në parashtrimet e saj, si dhe në seancën dëgjimore, subjekti ka ngritur pretendime rast pas rasti, sipas kalimit të barrës së provës, në lidhje me çdo konstatim, të cilat janë analizuar në mënyrë të detajuar më sipër në këtë vendim.

Në mënyrë të përmbledhur, për sa i takon analizës financiare, subjekti ka pretenduar:

**1.** Çmimi për blerjen e pasurisë apartament banimi në Përmet, në shumën 27.000 euro, është paguar pjesërisht brenda vitit 2015, vit në të cilin është paguar shuma 15.500 euro dhe

pjesërisht në vitin 2016, kur është paguar shuma prej 1.600.000 lekësh dhe jo tërësisht brenda vitit 2015, sikurse është vlerësuar nga Komisioni. Lidhur me këtë pretendim, Komisioni, pasi analizoi të gjitha provat shkresore, si dhe deklaratimet e subjektit të cilat kanë pasur mospërputhje të theksuara, arsyetuar gjerësisht më sipër në vendim, në përfundim të hetimit administrativ ka vlerësuar që të konsiderojë pagimin e çmimit të blerjes së pasurisë brenda vitit 2015, paguar me këste në mënyrën e pasqyruar në kontratën e shitjes nr. 2731/1012/1, datë 31.12.2015, vërtetuar plotësisht me dokumente bankare. Për sa i takon marrëveshjes së datës 1.5.2011, së cilës i referohet subjekti për të justifikuar pretendimin e saj, Komisioni, përveç se nuk e gjeti të justifikuar ligjërisht, konstatoi se kjo marrëveshje nuk është përmendur as në kontratën e shitjes, e cila ka mirëpërcaktuar mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes brenda vitit 2015 dhe as në ndonjë prej deklaratave periodike vjetore. Për sa i takon shumës së paguar dhe të deklaruar në DPV-në e vitit 2016, duke vlerësuar çështjen me objektivitet, gjatë procesit të vendimmarrjes, Komisioni çmoi të mos e konsiderojë këtë shumë si shpenzim për vitin 2016, ashtu sikurse ishte llogaritur në analizën e vënë në dispozicion të subjektit me rezultatet e hetimit. Për këtë arsye, analiza financiare për vitin 2016 duhet të ndryshojë pozitivisht nga +718.896 lekë në +2.318.896 lekë.

**2.** Shuma prej 4.030.000 lekësh, e depozituar nga bashkëshorti në emër të shoqërisë “N.” sh.p.k., nuk duhet të konsiderohet si shpenzim familjar për vitin 2015, pretendim i cili nuk qëndron pasi subjekti nuk arriti të kundërshtojë me prova dhe dokumente shkresore të kundërtën e barrës së provës.

**3.** Vlera e automjetit, blerë në vitin 2011, duhet të konsiderohet si 500.000 lekë pasi 500.000 lekë janë dhuruar nga vëllai i bashkëshortit, pretendim i cili nuk qëndron pasi subjekti nuk arriti të kundërshtojë me prova dhe dokumente shkresore të kundërtën e barrës së provës.

**4.** Të konsiderohen si të ardhura të ligjshme ato të shtetasve N. P. dhe K. Gj. për dhënien e huave në vitin 2007, të shumave 2.000.000 lekë dhe 25.000 euro, pretendim i cili nuk qëndron pasi subjekti nuk arriti të kundërshtojë me prova dhe dokumente shkresore të kundërtën e barrës së provës në lidhje me të dyja këto hua.

**5.** Kthimi i shumës prej 200.000 lekësh, dhënë bashkëshortit nga shoqëria “A.S” sh.p.k. duhet të konsiderohet si e ardhur dhe jo vetëm si shpenzim për vitin 2007, pretendim i cili nuk qëndron pasi subjekti nuk arriti të kundërshtojë me prova dhe dokumente shkresore të kundërtën e barrës së provës.

**6.** Shumat 850.000 lekë dhe 5.000 USD, të dhëna hua nga bashkëshorti, duhet të përfshihen si të ardhura të ligjshme për vitet 2012 dhe 2013, përkatësisht, pasi janë kthyer nëpërmjet sistemit bankar, pretendim i cili nuk qëndron pasi subjekti nuk arriti të kundërshtojë me prova dhe dokumente shkresore të kundërtën e barrës së provës.

**7.** Shuma prej 5.000 USD, dhënë hua nga vëllai B. P., që punon dhe jeton në SHBA, duhet të përfshihet si e ardhur e ligjshme për vitin 2009, pretendim i cili nuk qëndron pasi subjekti nuk arriti të kundërshtojë me prova dhe dokumente shkresore të kundërtën e barrës së provës.

**8.** Shuma prej 41.650 USD, përdorur për shpenzimet mjekësore të vajzës nuk duhet të përfshihet te shpenzimet e vitit 2008, pasi është kthyer/rimbursuar duke u paguar nga shoqëria e sigurimeve “A.” në SHBA, pretendim i cili u mor në konsideratë gjatë vlerësimit

përfundimtar të çështjes, por kjo shumë nuk u konsiderua e përfituar me të ardhura të ligjshme dhe, si rrjedhim, analiza financiare për vitin 2008 mbetet e pandryshuar (me balancë pozitive).

**9.** Shuma 30.000 USD e dhënë në janar të vitit 2010, si garanci për marrjen e vizës amerikane nga vëllai i bashkëshortit nuk duhet të konsiderohet në analizë, pasi është kthyer në të njëjtin vit që është marrë. Lidhur me këtë pretendim, Komisioni evidenton edhe njëherë faktin se kjo shumë nuk ka afektuar analizën financiare pasi është konsideruar si e marrë dhe kthyer brenda vitit 2010.

**10.** Shumat e bonuseve të karburantit për vitet 2011 – 2013 (245.000 lekë, 420.000 lekë dhe 420.000 lekë), si kompensim funksioni, duhet të përfshihen si të ardhura të ligjshme për vitet respektive, pretendim i cili u vërtetua të jetë i bazuar dhe, për rrjedhojë, këto shuma janë përfshirë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare përfundimtare të këtyre viteve.

Bazuar në sa më sipër, analiza financiare e vënë në dispozicion të subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, në përfundim të procesit, ndryshoi në lidhje me sa vijojnë: (1) për vitet 2011, 2012 dhe 2013 u përfshinë si të ardhura ligjore bonuset e karburantit; (2) në vitin 2016, shuma prej 1.600.000 lekësh e deklaruar nga subjekti në DPV-në për këtë vit, nuk u konsiderua si shpenzim i subjektit të rivlerësimit, duke rritur balancën ekzistuese pozitive për këtë vit.

Analiza financiare përfundimtare, në përfundim të hetimit administrativ, pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur në tabelën, si vijon:

	1	2	3	4	5	6
Përshkrimi	Pasuri	Detyrimi	Pasuri <i>neto</i> (1-2)	Të ardhura	Shpenzime	Mundësia për kursime (4-3-5)
<b>deri 2003</b>	2 000 000	0	2 000 000	4 182 955	1 886 691	296 264
<b>2004</b>	400 000	0	400 000	1 490 075	411 856	678 219
<b>2005</b>	1 013 702	0	1 013 702	1 671 130	474 228	183 200
<b>2006</b>	1 672 415	0	1 672 415	1 826 055	474 228	-320 588
<b>2007</b>	5 241 458	0	5 241 458	2 672 262	983 647	-3 552 843
2008	-808 023	0	-808 023	1 362 795	1 382 060	788 758
<b>2009</b>	1 572 094	0	1 572 094	1 916 470	704 008	-359 632
<b>2010</b>	1 572 885	0	1 572 885	2 190 211	1 431 337	-814 012
<b>2011</b>	5 121 537	0	5 121 537	2 717 647	1 094 089	-3 497 978
<b>2012</b>	-866 387	0	-866 387	2 789 648	741 704	2 914 331
<b>2013</b>	106 458	0	106 458	2 305 519	773 560	1 425 501
<b>2014</b>	270 486	0	270 486	2 319 677	1 709 794	339 397
<b>2015</b>	-836 722	0	-836 722	2 132 107	6 016 551	-3 047 722
<b>2016</b>	-1 109 413	0	-1 109 413	2 379 674	1 170 192	2 318 896

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, rezultoi që subjekti nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme pasuritë dhe shpenzimet për të gjithë periudhën e rivlerësimit, për shkak të një balance negative në total në vlerën -11.592.775 lekë.

## Metodologjia e përdorur nga Komisioni gjatë analizës financiare

Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe e familjes së saj, sikurse edhe e gjithë personave të tjerë të lidhur, kur këta të fundit kanë pasur ndërveprime financiare me subjektin.

Deri në vitin 2003, analiza është bërë sipas metodologjisë kumulative, pasi nuk ka deklarime periodike të pasurisë. Personat e tjerë të lidhur (huadhënësit) janë analizuar duke përdorur metodologjinë kumulative, pasi nuk janë subjekt deklarimi periodik.

**Të ardhurat:** nga punësimi i dokumentuar i subjektit dhe bashkëshortit.

Për subjektin janë përfshirë pagat duke filluar nga data 1.1.1995<sup>43</sup> dhe deri në fund të periudhës së vlerësimit plus bonuse karburanti<sup>44</sup>, për bashkëshortin e subjektit janë përfshirë pagat nga punësimi<sup>45</sup>, gjithashtu janë përfshirë të ardhura nga interesat bankare<sup>46</sup>.

**Shpenzimet:** shpenzimet e jetesës për vitet 1995-1996 janë përlllogaritur si 80 % e të ardhurave nga pagat; në vitet 1997-1999 në shumën 5.000 lekë/muaj për person<sup>47</sup> në varësi të numrit të personave; për vitin 1997 një person, 1998 kur subjekti është martuar dhe viti 1999 për 2 persona. Pas vitit 2000, bazuar në standardin e ILDKPKI-së dhe sipas përbërjes familjare të subjektit: për vitet 2000-2002 për 3 persona dhe për vitin 2003 për 4 persona. Shpenzime të tjera si pagesa për blerje karburanti<sup>48</sup>, qira apartamenti sipas pyetësorit standard për apartamentin<sup>49</sup>, shpenzime mobilimi<sup>50</sup>, pagesë për shoqërinë “A.S” sh.p.k. dhe shpenzime nga llogaria e bashkëshortit<sup>51</sup>, depozitime të bashkëshortit në OTP Bank<sup>52</sup>, shpenzime udhëtimi sipas raportit nga sistemi *TIMS* dhe pyetësorit standard. Metodologjia e përlllogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11 të datës 22.5.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**Pasuritë** ku përfshihet apartamenti në Përmet, në bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortit të saj. Vlera e apartamentit është pasqyruar në analizë sipas shumave të paguara për vitet 2011, 2012 dhe 2015 të ballafaquara me deklaratën *Vetting* dhe DPV-të përkatëse. Blerja e automjetit<sup>53</sup> është analizuar në datën 2.11.2011. Likuiditetet janë trajtuar si pjesë e pasurive, në një zë të veçantë. Janë konsideruar gjendjet e llogarive bankare<sup>54</sup> në fund të çdo viti për çdo person të familjes, të ballafaquara me deklaratimet e subjektit ndër vite; gjendja e

<sup>43</sup> Vërtetim nr. \*\*\*, datë 27.12.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, për vitet 1995 – 2007 dhe 2011 – 2016; vërtetim page nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për periudhën 4.9.2007 – 21.2.2011.

<sup>44</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.4.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet në vitet 2011 – 2013.

<sup>45</sup> Vërtetim nga ISSh-ja, si i punësuar në DRT Gjirokastrë për periudhën 7.7.2004 – dhjetor 2016.

<sup>46</sup> Sipas lëvizjeve të llogarisë në “Raiffeisen Bank”, “Alpha Bank” dhe “Tirana Bank”.

<sup>47</sup> Metodologji e përdorur nga Komisioni në vendimin nr. 35, datë 12.7.2018 dhe e pranuar nga Kolegji në vendimin (JR) nr. 5, datë 18.2.2009, paragrafi 42 sipas të cilit: “... *trupit gjykues i Kolegjit e ka konsideruar të drejtë dhe objektive përlllogaritjen e Komisionit... për shpenzimet për konsum familjar të kryera nga familja\*\*\*.*”

<sup>48</sup> Sipas lëvizjeve të llogarisë në “Raiffeisen Bank” dhe “Tirana Bank”.

<sup>49</sup> Sipas lëvizjeve të llogarisë në “Raiffeisen Bank” nga llogaria e subjektit të shoqëria “V.” sh.p.k.

<sup>50</sup> Sipas pyetësorit standard dhe deklarimeve periodike të viteve 2014-2015.

<sup>51</sup> Sipas lëvizjeve të llogarisë në “Tirana Bank”.

<sup>52</sup> Sipas shkresës nr. \*\*\*prot., datë 26.12.2019, të DPPPP-së në dosjen e Komisionit.

<sup>53</sup> Çmimi sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.11.2011.

<sup>54</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, të “Raiffeisen Bank”; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2019, nga “Alpha Bank”; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, nga “Tirana Bank” në dosjen e Komisionit dhe deklarimet periodike në dosjen e ILDKPKI-së.

likuiditeteve *cash* është pasqyruar sipas deklarimeve të subjektit në DPV-të. Ndryshimi i likuiditeteve – pakësimi ose shtesa nga viti në vit – është pasuria e krijuar nga subjekti për çdo vit ushtrimor.

**Rezultati** është i përlogaritur për çdo vit, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total. Mundësia për kursime rezulton si shumatore e ardhura – (*shpenzime + pasuri neto*). Mundësia financiare është analizuar për çdo pasuri të krijuar në momentin e pagesës për pasurinë. Mundësia financiare është analizuar për çdo vit kalendarik. Pamundësia financiare totale është shumatorja e viteve me rezultat negativ (-).

### **Personat e tjerë të lidhur**

Është analizuar mundësia financiare për huadhënësit, bazuar në burimin e të ardhurave të deklaruara dhe të vëna në dispozicion nga subjekti.

### **Vlerësim përfundimtar për kriterin e pasurisë**

Gjatë hetimit administrativ, Komisioni kreu rivlerësimin e pasurisë së subjektit Silvana Pani, referuar deklaratës *Vetting*. Por, si Kushtetuta në pikën 4, të nenit Ç dhe nenit D të Aneksit të saj, ashtu edhe ligji nr. 84/2016, në nenet 30, 32 dhe 33 të tij, përveç se përcaktojnë në mënyrë të qartë detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për të deklaruar në një deklaratë të re me saktësi, vërtetësi dhe në mënyrë të plotë pasuritë në pronësi, zotërim apo përdorim të tyre dhe të personave të lidhur me ta, kanë parashikuar shtrirjen e procesit të rivlerësimit edhe në shqyrtimin e deklarimeve periodike të pasurisë të kryera në të shkuarën nga subjektet e rivlerësimit, me qëllim që të identifikohen subjektet që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

Pas shqyrtimit të deklaratave periodike vjetore dhe pas analizimit të tyre në mënyrë të detajuar si në këtë vendim, në përfundim të procesit të rivlerësimit u konstatua se subjekti Silvana Pani: (i) ka pasur në mënyrë të përsëritur pasaktësi në deklarime shoqëruar në disa raste me balanca negative të fondeve ndër vite; (ii) ka mospërputhje të përsëritura të deklarimeve periodike me akte të administruara gjatë hetimit administrativ; (iii) në mënyrë të përsëritur ka bërë prezent për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit fakte dhe rrethana të padeklaruara më parë gjatë plotësimit të deklaratave periodike vjetore; (iv) nuk ka deklaruar tri llogari bankare në emër të bashkëshortit në “Tirana Bank”, si dhe lëvizjet në këto llogari si shtesa e pakësime, në kundërshtim me germën “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, i ndryshuar.

Për shkak të pasojave dhe peshës specifike të analizuar rast pas rasti, pasaktësitë dhe pamjaftueshmëritë në deklaratat periodike vjetore, të cilat sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, mund përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit dhe, në rastin e subjektit Silvana Pani, janë konsideruar nga Komisioni të të njëjtës rëndësi me deklaratën *Vetting*<sup>55</sup>.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit u vërtetua se sipas përcaktimeve të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, subjekti: (1) ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim

---

<sup>55</sup> Shihni paragrafin 42 të vendimit nr. 9, datë 24.10.2018, dhe paragrafet 45/1 dhe 2 të vendimit nr. 2, datë 4.2.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

me ligjin; (2) ka mungesa burimesh financiare me të ardhura të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet për shkak të një balance negative prej -11.592.775 lekësh për të gjithë periudhën e rivlerësimit; (3) ka kryer fshehje të pasurisë; (4) është në kushtet e konfliktit të interesave.

Për sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet pikës 5, të nenit 33, të këtij ligji.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

DSIK-ja ka vënë në dispozicion të Komisionit raportin nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana P. Pani (Sevo), i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. 21, datë 16.1.2020, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (1) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (2) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës; (3) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e saj apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana P. Pani (Sevo).

Pavarësisht këtij konstatimi, Komisioni kërkoi përditësim të dhënash në lidhje me subjektin e rivlerësimit, znj. Silvana Pani, për të cilin me shkresën nr. 4743 prot., datë 9.5.2018, DSIK<sup>56</sup> informoi se ka kryer përditësim informacioni pa konstatuar të dhëna të reja.

Gjatë hetimit administrativ nuk ka pasur asnjë të dhënë nga cilido burim për veprimtari korruptive apo kontakte me persona të papërshtatshëm, në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Silvana Pani. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, në analizë të të gjitha fakteve dhe provave të administruara nga Komisioni, nuk u konstatuan elemente që çënojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, parashikuar nga neni DH i Aneksit të Kushtetutës.

## **C. RIVLERËSIMI PROFESIONAL**

Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani, bazuar në raportin me nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2018 për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme dhe protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2018, nga ku rezultuan gjetjet si më poshtë:

### **1. Për aftësitë profesionale**

#### *a) Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Silvana Pani, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në dokumentet ligjore të paraqitura prej saj dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për

<sup>56</sup> Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2020, nga DSIK-ja në dosjen e Komisionit.



mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste e analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen me akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

Prokurorja Silvana Pani shfaq aftësi për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime në ndjekje të procedimeve penale konkrete, në respektim të parashikimeve ligjore. Piketën elementët kyç të planit hetimor dhe i formalizon në urdhra të përgatitur menjëherë pas regjistrimit të procedimit penal. Përcakton versionet dhe objektin e ndjekjes penale. Në rastin e çështjeve me natyrë procedurale, përdor metodat e interpretimit për të nxjerrë thelbin e institutit procedural që është në diskutim. Ndërsa në rastin kur problematika lidhet me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi çdo elementi të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal sipas normës penale. I kushton rëndësi analizës së provave të administruara. Ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Në vlerësimet e punës për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se subjekti Silvana Pani është vlerësuar në mënyrë “shumë mirë”.

#### *b) Arsyetimi ligjor*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, ka aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor përgjithësisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej saj. Aktet e përpiluara prej saj konceptohen me tri pjesë në pjesën më të madhe të tyre. Përmbajtja e aktit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje çështjeve që parashtrihen për zgjidhje. Në tekstet e akteve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurorja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore dhe provave. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Në marrjen e vendimeve, prokurore Silvana Pani argumenton mbi baza analitike dhe logjike. Përdor metodat e deduksionit në analizën logjike të faktit dhe provat e administruara. Shprehet qartë. Aktet e përpiluara prej saj janë të kuptueshme, me strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar. Ushtron kompetencat ekskluzive të prokurorit në çdo rast kur ngre akuzë, në fazën e dhënies së deklarimeve të të pandehurit dhe i kushton rëndësi garantimit të të drejtave procedurale të pandehurit. Disponimet në çdo rast janë logjike, të rregullt në formë dhe të qartë në përmbajtje. Pjesët përbërëse të vendimeve të saj janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Respekton rregullat e mendimit të drejtë. Konkluzionet e pjesës arsyetuese bazohen në aktet ligjore dhe në parimet e rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë.

## **2. Për aftësitë organizative**

#### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Subjekti rivlerësimit, znj. Silvana Pani, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, ku gjatë periudhës tetor 2013 – mars 2016, ka ushtruar funksionin në pozicionin e Drejtueses së Prokurorisë. Ajo ka trajtuar gjithsej 224 çështje/praktika. Lidhur me efektivitetin në aspektet sasiore dhe kohore, analiza e të dhënave të tij bëhet në referencë të ligjit procedural penal,

Kushtetutës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ajo ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet.

Konstatohet se prokurorja Silvana Pani, për periudhën e rivlerësimit ka kryerat detyrat specifike që parashikon ligji organik për funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë. Përpos rolit të saj drejtues, prokurorja Silvana Pani, gjithashtu ka ushtruar ndjekje penale për një numër të konsiderueshëm materialesh hetimore. Në referencë të të dhënave statistikore dhe funksioneve të saj, konstatohet se prokurorja ka përballuar ngarkesë pune të dimensioneve të ndryshme profesionale. Ajo ka ushtruar kompetencat që ligji i njej prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes së policisë gjyqësore. Ka kryer detyrat e saj në pajtim me pikën 2 dhe 2. 1 të urdhrit nr. 147, datë 9.5.2008, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në Prokuroritë e shkallës së parë” të Prokurorit të Përgjithshëm.

Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, rezultoi se qëndrimi i saj, shprehet brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit konstatohet se nga mënyra se si është organizuar dhe funksionon Prokuroria, mbështetur në parashikimet ligjore procedurale penale, nuk ka ekzistuar ndonjë afat, brenda të cilit prokurori të detyrohet të arsyetojë aktet e tij, përveç faktit të dorëzimit të tyre brenda afateve procedurale penale. Subjekti i rivlerësimit konstatohet se ka zbatuar me rigorozitet këto afate gjatë ushtrimit të funksioneve me cilësinë e prokurorit, duke marrë masat e nevojshme për mirëadministrimin e drejtësisë.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurorja Silvana Pani, është efiçente dhe efektive.

#### *b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore/administrative/drejtuese*

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Silvana Pani, ka ushtruar detyrën në mënyrë të efektshme në aspektin e përfundimit të procedurave hetimore, lidhur me ligjshmërinë e veprimeve të policisë gjyqësore, kufizimet e lirisë së personave që dyshohen se kanë kryer një vepër penale, mbledhjes së provave të nevojshme dhe njoftimit të palëve menjëherë në lidhje me disponimin për vendimmarrjen.

Në kuadër të veprimtarisë organizative, subjekti i rivlerësimit, prokurorja Silvana Pani, për kryerjen e veprimeve hetimore dhe ndjekjen në dinamikë të çështjes, kujdeset të caktojë oficerë të policisë gjyqësore, të cilët kanë kryer referimin e veprës penale apo kanë marrë kontakt të parët me subjektin kallëzues, tregues i aftësisë për të menaxhuar detyrimet e saj në planifikimin e punës, për mënjanimin e transferimit të panevojshëm të çështjeve dhe organizimin me efektivitet të burimeve njerëzore.

#### *c) Aftësia për të administruar dosjet*

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht. Administrimi i shpërndarjes së materialeve, si pjesë e punës së saj në cilësinë e titullarit të organit të akuzës në zyrën e prokurorisë Përmet, në aftësitë administruese/drejtuese për tre vitet është vlerësuar “shumë mirë” nga Prokurori i Përgjithshëm.

### **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

*a) Etika në punë*

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet dhe urdhrat e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nga vlerësimet e punës së subjektit Silvana Pani, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se: për periudhen 2014 – 2016 subjekti Silvana Pani është vlerësuar “shumë mirë” për etikën profesionale.

*b) Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurorja Silvana Pani dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

*c) Paanësia*

Nga katër dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurores Silvana Pani. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej katër dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në katër dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, prokurorja Silvana Pani, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave. Subjekti shpreh përmbushjen e funksioneve, duke ruajtur standardet profesionale, të integritetit dhe kujdesit për kryerjen e hetimit të paanshëm, në respektim të parimit të barazisë së palëve, duke i njohur ata me provat në përputhje me ligjin, në funksion të procedimit të drejtë dhe të barabartë, duke garantuar parimin e prezumimit të pafajësisë. Prokurorja merr masat të garantojë paanshmërinë në aspektin subjektiv dhe objektiv, në mbrojtje të interesave të ligjshme të shtetasve.

#### **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

*a) Aftësitë e komunikimit*

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në dokumentet e dorëzuara prej saj, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

*b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Në dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit, prokurores Silvana Pani për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

*c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të jetë angazhuar në veprimtari të ndryshme nga ajo e prokurorit. Për sa i përket trajnimeve të kryera, subjekti i rivlerësimit, prokurorja Silvana Pani, rezulton të jetë angazhuar me pjesëmarrje në trajnimet e kryera nga Shkolla e Magjistraturës, në kuadrin e programit të trajnimit vazhdues, trajnime me tema të ndryshme, si: barazia gjinore dhe mosdiskriminimi; e drejta për kompensim dhe të drejta të tjera të viktimave në ligj dhe praktikë; përditësimet ligjore në fushën e dhunës në familje dhe roli i gjyqtarëve; prokurorëve dhe policisë; si dhe pjesëmarrje në trajnime të tjera profesionale si ekzekutimi i vendimeve penale dhe padia civile në procesin penal dhe përvoja evropiane.

**C.2** Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, konkretisht, informacioni i marrë nga:

**1.** Tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje si ato në raportin e Prokurorisë së Përgjithshme.

**2.** Pesë denoncime<sup>57</sup> nga publiku, të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe të administruara nga Komisioni. Pas analizimit të këtyre denoncimeve në raport me elementët e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, u konstatua se në denoncimet e shtetasve D. H. L. dhe A. H. nuk referoheshin shkelje ligjore të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk ishin vënë në dispozicion prova për të vërtetuar pretendimet e tyre.

Në lidhje me denoncimet e shtetasve J. J. dhe C. J., pas administrimit të dosjeve të procedimeve penale përkatëse nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet<sup>58</sup> u konstatua se pretendimet e denoncuesve, të cilat konsistonin në hetime jo të plota nuk qëndronin dhe se vendimmarrja e prokurores ishte bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Gjithashtu nuk u vërtetuan pretendimet për ndikim të njëanshëm të prokurores Silvana Pani, në cilësinë e drejtueses së prokurorisë.

Ndërsa në lidhje me denoncimin e shtetasit A. B., i cili ka ngritur pretendime për paaftësi dhe mungesë profesionalizmi, për disa prokurorë, përfshirë edhe prokuroren Silvana Pani, për pushimin e çështjes së tij të datës 30.5.2008, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me pretendimet e denoncuesit sa i takon vendimmarrjes së saj, duke i kërkuar gjithashtu të provojë me dokumente kryerjen e hetimeve të plota. Në lidhje me këte denoncim, subjekti, në parashtrimet e saj nuk ka dhënë sqarime.

**3.** Informacionin e marrë nga të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime, nga ku për subjektin e rivlerësimit ka rezultuar se:

**3.1** Po bëhen verifikime në kuadrin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2017, i cili është në fazën e hetimit dhe duke qenë në këtë fazë, nga Prokuroria e Përgjithshme nuk është dhënë një vlerësim. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i janë kërkuar sqarime mbi ecurinë e këtij procedimi, e cila në parashtrimet e saj nuk ka dhënë sqarime.

---

<sup>57</sup> Shihni denoncimin nga z. J. J., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2019; shihni denoncimin nga z. Dh. L., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 20.11.2018; shihni denoncimin nga z. A. H., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2018; shihni denoncimin nga z. C. A. J., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 11.1.2018; shihni denoncimin nga z. A. B., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2018, në dosjen e Komisionit.

<sup>58</sup> Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 29.7.2020, nga Prokuroria Përmet; shihni shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 29.7.2020, nga Prokuroria Përmet, në dosjen e Komisionit.

**3.2** Ka gjashtë praktika ankesash, të cilat janë trajtuar nga Prokuroria e Përgjithshme ose prokuroritë përkatëse. Në lidhje me kallëzimin penal të shtetasit K. J. të vitit 2006, sipas të cilit prokurorja Silvana Pani kishte shpërdoruar detyrën gjatë procesit penal ku shtetasi K. J. ishte akuzuar dhe dënuar për veprime ndaj vëllait të tij, A. J., në rezultatet e hetimit, duke qenë se nuk ka pasur informacion në lidhje me ecurinë e këtij kallëzimi, ky informacion iu kërkua subjektit të rivlerësimit. Në parashtrimet e saj, znj. Silvana Pani nuk ka dhënë sqarime.

Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të aftësive profesionale, u evidentua, se në mënyrë të pakuptueshme subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë sqarime në parashtrimet e saj për sa i është kërkuar me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, ndërsa në seancën dëgjimore, deklaroi se nuk ka qenë e qartë lidhur me çfarë i është kërkuar. Por, pavarësisht kësaj, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe referuar neneve 73, 74, 75, 76 dhe 77 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Silvana Pani: ka aftësi për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike; ka aftësi organizative; e ka zhvilluar veprimtarinë hetimore në përputhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore; dhe ka demonstruar cilësi personale dhe angazhim profesional, në përputhje me standardet e parashikuara në ligj. Mosdhënia e sqarimeve për çështjet e kërkuara, nuk mund të konsiderohet si shkak për vlerësim negativ të aftësive profesionale, por është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të rivlerësimit përfundimtar të çështjes, duke u vlerësuar në raport me të gjitha rrethanat e tjera që kanë çuar në marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Në përfundim të rivlerësimit profesional, Komisioni mori në konsideratë propozimin e relatores së çështjes dhe vlerësoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, ka arritur nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, duke u konsideruar “e aftë”.

### **III. SEANCA DËGJIMORE**

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Silvana Pani, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 9.6.2020, në sallën e konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegime dhe opinione lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim, për sa i përket figurës, ndershmërisë, pastërtisë dhe anës profesionale, subjekti deklaroi se e meriton të qëndrojë në detyrë, ndërsa sa i takon pjesës tjetër e lë në vlerësimin e Komisionit.

Në datën 5.10.2020 u zhvillua seanca në të cilën Komisioni shpalli vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, ka qenë përgjithësisht bashkëpunuese, ndonëse në disa raste ka qenë kontradiktore dhe e paqartë në shpjegimet e saj.

Me kalimin e barrës së provës, në disa raste lidhur me rivlerësimin e pasurisë, nuk ka dhënë sqarime për çfarë i është kërkuar. Po kështu, nuk ka dhënë sqarime për sa i është kërkuar në lidhje me rivlerësimin profesional, duke deklaruar në seancën dëgjimore se ka qenë në padijeni të fakteve dhe rrethanave, fakt për të cilin Komisioni çmon se subjekti ka pasur të gjitha mundësitë për të ardhur në dijeni të tyre dhe kthimin e përgjigjeve për sa i është kërkuar.

#### **IV. KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë bisedimeve për vlerësimin përfundimtar të çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit si dhe në qëndrimin e subjektit të rivlerësimit për çdo çështje rast pas rasti, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, ka bërë deklarime të pasakta e të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka perbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Vendimmarrja për këtë subjekt, u vlerësua të bazohet në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2014.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “c”, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

#### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani, me detyrë prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Përmet.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 5.10.2020.

#### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Roland ILIA**  
Kryesues

**Firdes SHULI**  
Anëtar/Relator

**Etleda ÇIFTJA**  
Anëtar

*Sekretare gjyqësore*  
*Anisa Duka*